


REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MIRËQËNIES
SOCIALE DHE RINISË




Studim kombëtar mbi fëmijët në situatë rruge në Shqipëri

*Nga lypja në rrugë, në udhën
e mbrojtjes dhe kujdesit*

unicef 

 Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra
Swiss Cooperation Office Albania
Zyra e Bashkëpunimit Zvicëran në Shqipëri

 Save the Children



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E MIRËQËNIES
SOCIALE DHE RINISË

*Nga lypja në rrugë, në udhën
e mbrojtjes dhe kujdesit*

Studim kombëtar mbi fëmijët në situatë rruge në Shqipëri

Përgatitur nga:
ARSIS
GFK Shqipëri
Ekspert ndërkombëtar

Një raport i komisionuar nga:
UNICEF
Save the Children

Financuar nga:
Zyra e Bashkëpunimit Zviceran në Shqipëri

Prill 2014



Raport Studimi

Të gjitha të drejtat e këtij publikimi janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të kopjohet në asnjë formë pa pëlqimin paraprak të UNICEF dhe Save the Children.

Të drejtat e autorit © UNICEF dhe Save the Children

Ekipi Kërkimor:

Sarah Di Giglio – Ekspert Ndërkombëtar

Zini Kore – Udhëheqës Studimi ARSIS

Enkeleda Karaj Bolduc – Ekspert i ARSIS

Jusilda Bocaj – Ekspert i GfK Albania

Ana Majko – Ekspert i ARSIS

Floriana Hima - UNICEF

Mirela Jonuzaj – Save the Children

Falenderime

Studimi Kombëtar mbi fëmijët në situatë rruge në Shqipëri është komisionuar nga UNICEF dhe Save the Children, me mbështetjen e Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë (MMSR). ARSIS, Organizatë Shoqërore për Përkrahjen e të Rinjve kreu studimin dhe përgatiti raportin në bashkëpunim me Institutin Kërkimor Growth for Knowledge (GfK) në Shqipëri dhe ekspertin ndërkombëtar Sarah Di Giglio.

Falenderimet u shkojnë të gjithë fëmijëve, prindërve, punonjësve, përfaqësuesve të institucioneve qeveritare, autoriteteve të qeverisë vendore, mësuesve, punonjësve socialë, OJF - ve dhe komuniteteve të cilët kontribuan për këtë studim dhe veçanërisht të gjithë atyre të cilët morën pjesë në intervistat dhe fokus grupet në të gjitha qytetet e Shqipërisë. Ky studim nuk do të ishte i mundur pa mbështetjen e tyre. Gjithashtu, falenderojmë të gjithë informatorët kyç të përfshirë në këtë studim, perspektiva dhe zëri i të cilëve ishte themelor për të siguruar saktësinë e gjetjeve tona.

Dëshirojmë të falënderojmë stafin e organizatave ARSIS, Fëmijët e Botës dhe të Shqipërisë /të Drejtat e Njeriut (FBSH/DN), Shoqata Kombëtare "Edukim për Jetën" (SHKEJ),¹ Qendra Drop in e Save the Children për Këshillim dhe Ndihmë për Fëmijët në Situatë Rruge,² për kontributin, bashkëpunimin dhe mbështetjen e tyre për të mundur këtë studim. Ne u jemi mirënjohës për punën e tyre në aspekte të ndryshme të zbatimit të studimit.

ARSIS shpreh mirënjohjen e saj për UNICEF dhe Save the Children të cilat ofruan mbështetjen financiare për të mundur ndër marrjen e këtij studimi të rëndësishëm.

Ne dëshirojmë të vëmë në pah mbështetjen e madhe të ekspertes ndërkombëtare që ndihmoi për të hartuar studimin dhe mbështetjen e saj përgjatë gjithë procesit, në shqyrtimin e drafteve të ndryshme, në dhënien e komenteve të çmuara dhe ndihmës në përgatitjen e këtij raporti përfundimtar.

1 Shoqata Kombëtare e Edukimit për Jetën
2 Në partneritet me Bashkinë e Tiranës dhe FBSH-DN

Tabela e përmbajtjes

Fjalorth.....	IX
Përmbledhje ekzekutive.....	X
Kreu I. Hyrje.....	13
I.1 Konteksti i Vendit.....	13
I.2 Objektivat e Studimit.....	14
I.3 Përkufizime.....	15
Kreu II. Metodologjia e studimit dhe grupi i të dhënave.....	19
II.1 Hartimi dhe fazat e studimit.....	19
II.1.1 Hartëzimi i vendndodhjes sipas kohës.....	20
II.1.2 Përlllogaritje e numërimit në pika.....	21
II.1.3 Intervistat fillestare.....	22
II.1.4 Diskutime të fokus grupeve.....	22
II.1.5 Pyetësorë të detajuar me informatorët kyç.....	24
II.1.6 Intervista të thelluara me informatorët kyç.....	24
II.1.7 Intervista ballë për ballë me fëmijët.....	24
II.1.8 Tabela teknike.....	25
II.1.9 Tavolina e rrumbullakët.....	25
II.2 Treguesit e kampionimit.....	25
II.3 Kufizimet dhe sfidat e studimit.....	26
Kreu III. Rezultatet e studimit.....	29
III.1 Shifra.....	29
III.2 Demografitë.....	30
III.2.1 Gjinia.....	30
III.2.2 Grup moshat.....	32
III.2.3 Përkatësia etnike.....	34
III.3 Profilet e fëmijëve në situatë rruge.....	39
III.3.1 Veprimtaritë e rrugës.....	39
III.3.2 Gjendja dhe rrethanat familjare.....	43
III.3.3 Faktori kohë - vendndodhje.....	46
III.3.4 Kushtet e rrugës dhe kushtet e jetesës.....	47
III.3.5 Migrimi dhe lëvizshmëria.....	49
III.3.6 Shkaqet rrënjësore.....	50

III.3.6.1 Shkaqet rrënjësore sipas aktorëve kryesorë.....	50
III.3.6.2 Shkaqet rrënjësore sipas përgjigjeve të fëmijëve.....	50
III.3.7 Faktorët e rreziqeve të lidhura me rrugën.....	51
III.3.7.1 Shëndeti fizik dhe mendor.....	51
III.3.7.2 Trafikimi dhe shfrytëzimi i fëmijës.....	52
III.3.7.3 Fëmijët në kontakt me ligjin.....	54
III.3.8 Arsimi dhe fëmijët në situatë rruge.....	55
III.3.9 Shkollimi dhe “puna”.....	57
III.3.10 Rezultatet shëndetësore.....	58
III.3.11 Akses në/dhe përdorim(i) të/i shërbimeve sociale.....	58
III.3.12 Përvojat e perceptuara, dëshirat për të ardhmen, dhe aspiratat e fëmijëve.....	60
Kreu IV. Përfundime dhe rekomandime.....	63
Favorizimi i parandalimit dhe ri-integrimit të fëmijëve duke hartuar strategji të reja, me mekanizma mbështetës e përmirësim të ofrimit të shërbimit në/për:.....	63
IV.1 Nivel qeveritar.....	64
IV.2 Autoritetet vendore.....	67
IV.3 Nivel arsimor.....	67
IV.4 Donatorët/Programet.....	68
Referenca.....	70
Shtojca.....	74
Shtojca A: Profilët dhe informacion mbi aktorët kryesorë/informatorët kyç.....	74
Shtojca B: Profilët kampion dhe tabelat e treguesve të vulnerabilitetit.....	75
Shtojca C: Udhëzimet etike.....	76
Shtojca D: Instrumentet.....	77
Shtojca E: Fazat e numërimit 1 & 2.....	97
Shtojca F: Vendndodhja e fëmijëve në situatë rruge në Tiranë.....	100
Shtojca G: Lista e punonjësve socialë dhe profesionistëve të tjerë të cilët zbatuan studimin në terren.....	101

Shkurtime

AR SIS	AR SIS - Organizatë Shoqërore për Përkrahjen e të Rinjve
FBSH-DN	Fëmijët e Botës dhe të Shqipërisë -Të Drejtat e Njeriut
BKTF	(Koalicioni) Bashkë për Kujdesin Tërësor të Fëmijëve
CRCA	Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri
NjMF	Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve
KDF	Konventa për të Drejtat e Fëmijëve
OShC	Organizata të Shoqërisë Civile
ONQ	Organizatë Ndër-qeveritare
ONM	Organizata Ndërkombëtare për Migrimin (IOM)
ILO	Organizata Botërore e Punës
INSTAT	Instituti i Statistikave
AZL	Agjencia e Zbatimit të Ligjit
MMSR	Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë
ASHMDF	Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës
OJQ	Organizatë Joqeveritare
MKR	Mekanizmi Kombëtar i Referimit
ZKKAT	Zyra e Koordinatorit Kombëtar të Luftës kundër – Trafikimit të Personave, Ministria e Punëve të Brendshme
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
SC DiC	Qendra “Drop in” e Save the Children
SHSSH	Shërbimi Social Shtetëror
PSV	Proçedura Standarde të Veprimit
SHKEJ	Shoqata Kombëtare e Edukimit për Jetën
TdH	Terre des Hommes
TeR	Termet e Referencës së Studimit mbi Fëmijët në Situatë Rruge
TLAS	Shërbimi Ligjor Falas Tiranë
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
WV	World Vision

Lista e Grafikëve

- Grafiku 1: Gjinia e fëmijëve në situatë rruge sipas qyteteve | Faza 1
 Grafiku 2: Gjinia e fëmijëve në situatë rruge sipas qyteteve | Faza 2
 Grafiku 3: Grup moshat e fëmijëve në situatë rruge | Fazat 1&2
 Grafiku 4: Grup moshat e fëmijëve në situatë rruge | Fazat 1&2
 Grafiku 5: Moshë e fëmijëve |djem| intervista fillestare | Fazat 1&2
 Grafiku 6: Moshë e fëmijëve |vajza| intervista fillestare | Fazat 1&2
 Grafiku 7: Përkatësia etnike e fëmijëve në situatë rruge | Intervista fillestare | Fazat 1&2
 Grafiku 8: Përkatësia etnike e fëmijëve në situatë rruge sipas gjinisë | Intervista fillestare | Fazat 1&2
 Grafiku 9: Përkatësia etnike e fëmijëve në situatë rruge sipas qyteteve | Faza 1
 Grafiku 10: Përkatësia etnike e fëmijëve në situatë rruge sipas qyteteve | Faza 2
 Grafiku 11: Përkatësia etnike e fëmijëve në situatë rruge sipas moshës | Intervista fillestare | Faza 1
 Grafiku 12: Përkatësia etnike e fëmijëve në situatë rruge sipas moshës | Intervista fillestare | Faza 2
 Grafiku 13: Aktivitetet e fëmijëve në rrugë | Fazat e numërimit 1&2
 Grafiku 14: Aktivitetet e rrugës sipas përkatësisë etnike | Intervista fillestare | Faza 1
 Grafiku 15: Aktivitetet e rrugës sipas përkatësisë etnike | Intervista fillestare | Faza 2
 Grafiku 16: Me kë qëndrojnë fëmijët në shtëpi | Intervista fillestare | Fazat 1&2
 Grafiku 17: Fëmijët në situatë rruge, vendet ku ata qëndrojnë | Intervista fillestare | Fazat 1&2
 Grafiku 18: Fëmijë në situatë rruge vetëm vs. të shoqëruar | Proçesi i numërimit | Fazat 1&2
 Grafiku 19: Frekuentimi i shkollës sipas moshës | Intervista fillestare | Faza 1
 Grafiku 20: Frekuentimi i shkollës sipas moshës | Intervista fillestare | Faza 2

Lista e Tabelave

- Tabela 1: Matricë që tregon elementët kyç të një ndryshimi modeli në studimin dhe punën me dhe për fëmijët në situatë rruge
 Tabela 2: Proçesi i studimit i cili detajon metodologjitë sasiore dhe cilësore
 Tabela 3: Numri i sektorëve të qytetit të vëzhguar në të dy valët
 Tabela 4: Numri i fokus grupeve të diskutimeve me fëmijët
 Tabela 5: Numri i fokus grupeve të diskutimeve me anëtarët e komunitetit
 Tabela 6: Kampion i fëmijëve në situatë rruge – të intervistuar
 Tabela 7: Përshkrime teknike të tabelës
 Tabela 8: Numri i fëmijëve në situatë rruge -- Faza 1
 Tabela 9: Numri i fëmijëve në situatë rruge -- Faza 2
 Tabela 10: Aktivitete të fëmijëve në situatë rruge
 Tabela 11: Shkaqet rrënjësore të bazuara në përgjigjet e aktorëve
 Tabela 12: Pasojat pozitive dhe negative të të qenit në situatë rruge

Foto 1: Harta gjeografike e Republikës së Shqipërisë

Fjalorth

Fëmijë

Për qëllimet e këtij dokumenti, një "fëmijë" përkufizohet çdo person nën moshën 18 vjeç, në përputhje me Konventën e OKB-së mbi të Drejtat e Fëmijës (KDF).

Fëmijë në situatë rruge

Fëmijët në situatë rruge janë nën moshën 18 vjeç dhe kanë njëfarë lidhje me rrugën, zakonisht duke jetuar dhe/ose punuar aty edhe në baza stinore ose kalimtare.

Pjesëmarrja e fëmijës

Çdo person nën moshën 18 vjeç i cili merr pjesë në një proces ose luan një rol në një proces në nivelin e tij/saj, në përputhje me kapacitetet e tyre në zhvillim - fëmijë dhe të rinj që mendojnë për veten e tyre, shprehin efektisht opinionet e tyre dhe ndër-veprojnë në një mënyrë pozitive me persona të tjerë; përfshirja e fëmijëve në vendime të cilat prekin jetët e tyre, jetën e komunitetit dhe shoqërisë në të cilën ata jetojnë në përgjithësi.

Mbrojtja e fëmijës

Mbrojtja e fëmijës është pjesë e mbrojtjes dhe promovimit të mirëqenies. Ajo i referohet aktivitetit të ndërmarrë për të mbrojtur fëmijë të veçantë, të cilët vuajnë apo ka të ngjarë të vuajnë një dëm të konsiderueshëm.

Politika e mbrojtjes së fëmijës

Një politikë e mbrojtjes së fëmijës është një deklaratë dhe angazhim i organizatave për të mbrojtur fëmijët nga abuzimi, shfrytëzimi dhe dhuna.

Qendër e tipit drop-in

Një strukturë që ofron shërbimet themelore për të plotësuar nevojat emocionale, fizike dhe të zhvillimit shoqëror të fëmijëve në gjendje të pambrojtur.

Programe të ndërhyrjes në terren

Programe të cilat ju përfaqesin fëmijëve në situatë rruge për t'i fuqizuar ata të shprehin nevojat dhe të drejtat e tyre dhe për t'i lidhur apo referuar ata nëpërmjet burimeve të nevojshme të disponueshme kur nevojitet.

Pëlqimi i informuar

"Të sigurohesh se fëmija e kupton se çfarë i kërkohet të bëjë" - duke u ofruar atyre të gjithë informacionin e rëndësishëm në një mënyrë të cilën ata e kuptojnë – "dhe se ata kanë të drejtën të mos thonë asgjë." Kur është e mundur, një pëlqim i shkruar duhet gjithashtu të merret nga prindërit ose kujdestarët (sipas së drejtës zakonore ose vendimit të gjykatës).³

Mirëbesimi

Mbajtja e të dhënave mbi fëmijët e përfshirë në studim në mënyrë të siguruar dhe dhënia e sigurive se ato mbeten anonime në çdo gjetje të studimit të bërë publike.

Puna sociale në rrugë

Puna në rrugë është një metodë ndërhyrjeje me synim për t'ju përfaqesur fëmijëve, të rinjve dhe të rriturve si dhe të gjithë njerëzve të një vendbanimi të gjendur në situatë rruge. Puna Sociale në rrugë i paraprin punës në komunitet dhe është një qasje e cila i paraprin mbështetjes individuale (mbështetje sociale dhe/ose menaxhim rasti).⁴

3 http://www.savethechildren.org.uk/sites/default/files/docs/children_and_participation_1.pdf

4 https://www.childwatch.uio.no/research/research-methodology/So_you_want_to_research_apr2004%5B1%5D.pdf

Udhërrëfyese ndërkombëtar mbi metodologjinë e punës në rrugë në botë - Dynamo International 2008, faqe 49

Përmbledhje mbi zbatimin

Studimi Kombëtar mbi Fëmijët në Situata Rruge në Shqipëri është realizuar në kuadër të Reformës së Shërbimeve Sociale nga Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë në bashkëpunim me UNICEF dhe Save the Children. ARSIS, GFK dhe një ekspert ndërkombëtar u përzgjedhën për të kryer këtë studim nga maj 2013 në shkurt 2014.

Ky është vlerësimi i parë sasior dhe cilësor i kryer në Shqipëri për fëmijët në situatë rruge, duke krijuar kështu të dhënat bazë për këtë fenomen. Qëllimi kryesor i studimit është t'i bëjë aktorët kyç të kuptojnë sa më thellësisht, shtrirë mbi të gjitha çështjet dhe shifrat rreth këtij grupi, për përcaktimin e axhendës së përgatitjes së politikave dhe rishikimin e saj si dhe për të planifikuar ndërhyrjet në të ardhmen. Ky studim është për t'u përfutur nga entet/agjensitë qeveritare të fushës si dhe organizatat e shoqërisë civile⁵ për të mbështetur zhvillimin e strategjive të reja që lidhen me fëmijët në situatë rruge. Gjithashtu studimi synon përmirësimin e ofrimit të shërbimit për këta fëmijë si dhe mekanizma të tjerë mbështetës të nevojshëm në parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijëve dhe familjeve të tyre.

Nga anketimi numerik, mbështetur në një numërim nëpërmjet vëzhgimit të fëmijëve nga mosha 0 deri në 18 vjeç me njëfarë lidhjeje me rrugën, të cilët jetojnë dhe/ose punojnë aty me baza stinore ose kalimtare, në gusht 2013 u identifikuan gjithsej 2014 fëmijë (Faza 1 e cila mbuloi 8 qarqe të Shqipërisë) dhe 2527 fëmijë gjithsej u identifikuan në Tetor 2013 (Faza 2, e cila i mbuloi të gjitha qarqet e Shqipërisë – 12 qarqe).

Në metodologjinë e studimit u zbatuan teknika të shumfishta me qëllim mbledhjen dhe kontrollimin e ndërthurur të informacionit prej numrit më të madh të burimeve përkatëse të informacionit, konsultimin dhe gjithëpërfshirjen e sa me shumë aktorëve të informuar, përfshirë edhe vetë fëmijët. Kjo përfshiu: intervistimin fillestar të 782 fëmijëve në të gjithë territorin e Shqipërisë; konsultimin e 111 fëmijëve nëpërmjet fokus grupeve në nivel vendor dhe kombëtar; intervista të përthelluara me 30 fëmijë si informatorë kyç; konsultimin e 40 anëtarëve të komunitetit dhe konsultimin me 60 informatorë kyç.

Duke marrë parasysh të gjitha burimet e informacionit, të cilat çuan në vlerësimin sasior dhe cilësor, studimi nxori në pah profilet themelore të fëmijëve në situatë rruge në aspektet e moshës, gjinisë, grupit etnik si dhe aktiviteteve të kryera dhe se si ato kryheshin. U vijua me kuptimin e rrënjëve të shkaqeve dhe vështrimin e disa aspekteve të rëndësishme të lidhura me lëvizshmërinë, familjet, shëndetin, arsimin dhe kuadrin e shërbimeve sociale.

Gjetjet kryesore demografike treguan se shumica e fëmijëve në situatë rruge janë djem të moshës 10 – 17 vjeç: në të dy fazat e numërimit, u vërejt se numri i djemve ishte dyfish më i madh sesa ai i vajzave (70.1% ose 1476 djem dhe 29.9% ose 538 vajza për Fazën 1; 74% - 1882 djem dhe 26% - 645 vajza në Fazën 2). Sidoqoftë për fëmijët më të vegjël shihet një shpërndarje më e barabartë ndërmjet gjinive. Rreth një e treta e fëmijëve në situatë rruge janë adoleshentë të moshës 15 – 17 vjeç (mesatarisht 29.5% ose 745 fëmijë), ndërkohë që fëmijët ndërmjet moshës 4-14 vjeç ishin 66.5% (mesatarisht 1680) dhe kishte një numër domethënës foshnjash të moshave nga 0–3 vjeç (102 fëmijë ose mesatarisht 4%). Një numër i konsiderueshëm fëmijësh të vegjël (0-5 vjeç) shoqërojnë nënat e tyre gjatë lypjes (Faza 1: 11.66% ose 235 fëmijë; Faza 2: 13.9% ose 381 fëmijë).

Mbështetur në përgjigjet gjatë intervistave fillestare, një e katërta e fëmijëve të identifikuar i përkisnin shumicës shqiptare, ndërkohë që 74.3% (581 nga 782 fëmijë) i përkisnin komuniteteve Rome dhe Egjiptiane. Këto të dhëna kanë një kuptim të dyfishtë: së pari, numri i fëmijëve shqiptarë në situatë rruge është më i lartë sesa pritej dhe së dyti, duke qenë se pakicat etnike apo grupet gjuhësore përbëjnë jo më shumë se 1% të popullsisë së përgjithëshme të Shqipërisë, ky studim konfirmon se përkimi i fëmijëve në situatë rruge nga këto grupe të pakicave etnike ka një mospërputhje të lartë përpjestimore.

Fëmijët janë të përfshirë në aktivitete të ndryshme të lidhura me rrugën. Më të zakonshmet janë

5 Këto janë organizata jo – fitimprurëse, përfshirë organizata jo – qeveritare dhe ndërqeveritare, të cilat për lehtësi reference do të përmenden në dokument ose si "shoqëri civile" ose si OJQ.

shitja e sendeve të ndryshme (38% Faza 1 - 25% Faza 2) të tilla si cigare, çakmakë, ujë, produkte bujqësore dhe artikuj ushqimorë, lule, stilolapsa, lapsa, aromatikë makine ose aksesore të tjerë, si dhe lypja për para (35% Faza 1 - 21% Faza 2), riciklim i materialeve plastike dhe metalike (8% Faza 1 - 20% Faza 2), dhe punë (12% Faza 1 - 15% Faza 2). Punët informale përfshijnë ngarkimin dhe shkarkimin e kamionëve të mallrave, puna në bujqësi, pastrimi i rrugëve, pastrimi i varrezave, përkujdesja për shezllonët në plazhe, puna në hyrjet e minierave si dhe performanca në rrugë. Trendi në punët jozyrtare është drejt një diversiteti në rritje të aktiviteteve dhe këto punë shkojnë përtej infrastrukturës urbane më shumë sesa besohet më parë.

Dy fazat e numërimit dhe intervistave fillestare të fëmijëve konfirmuan prirjet e vëna re në përvojën në terren të ofruesve të shërbimeve, të cilët kanë parë fëmijë më aktivë në zonat turistike gjatë verës, të tilla si Durrësi. Përfundime të tjera më të rëndësishme të lidhura me stinët e ndryshme tregojnë se fëmijët e shumicës shqiptare janë më të përfshirë në shitjen e sendeve gjatë verës dhe në punën informale në dimër. Shumica e fëmijëve të identifikuar se lypin janë nga komunitetet Rome dhe Egjiptiane.

Studimi gjithashtu nxori në pah një fenomen të ri të hasur gjatë fazës së dytë të numërimit lidhur me kultivimin e marijuanës në Lazarat (Gjirokastrë), i cili përfshinte 312 fëmijë. Edhe fëmijët nga rajonet e largëta e përmendën këtë si një mundësi që ofronte fitime të larta, duke sugjeruar se fëmijët dhe familjet e tyre mund të lëviznin në atë zonë. Lëvizshmëria u konfirmua si një veçori e fëmijëve në situatë rruge, por më specifikisht familjeve të tyre, duke qenë se fëmijët më të vegjël kishin ndjenjën se i përkisnin vetëm një qyteti, duke mos mbajtur mend migrimin e mëparshëm të familjes së tyre.

Ky studim e bazoi mbledhjen e të dhënave në një përkufizim përfshirës të fëmijëve në situatë rruge të përshtatur me kontekstin Shqiptar. Gjithsesi nga intervistat me fëmijë në Fazën 1 ishte e mundur t'i gruponim ata sipas përkufizimeve të UNICEF: Fëmijë "të" Rrugës (4.3% ose 19 fëmijë) – ata që qëndrojnë në rrugë gjatë ditës dhe gjithashtu flenë në rrugë, ka gjasa prej humbjes apo mungesës së prindërve, alkoolizmit, dhunës në familje, shkurrëzimit dhe/ose rimartësës së prindërve; Fëmijë "në" Rrugë (79% ose 347 fëmijë) të cilët qëndrojnë kryesisht në rrugë gjatë ditës dhe kthehen në shtëpitë e tyre ose në qendrat rezidenciale gjatë natës; dhe Fëmijë të Familjeve në Rrugë (16.7% ose 73 fëmijë) – të cilët jetojnë me familjet e tyre në rrugë.

Janë shumë të paktë fëmijët në situatë rruge të cilët jetojnë jashtë kontekstit familjar. Kjo u konfirmua nga diskutimet në fokus-grupet, të cilët së bashku me të dhënat fillestare treguan se 84% (657) e fëmijëve shqiptarë në situatë rruge e kanë një "shtëpi", me të dy prindërit të gjallë dhe që jetojnë me ta. Kjo është edhe më e domethënëse për politikat tërësore të orientuara ndaj familjes së një natyre social – ekonomike, duke konsideruar se gjatë diskutimeve mbi arsyet e fëmijëve të gjendur në kontakt me rrugën 96% (750 e rreth 782 intervistave fillestare) të fëmijëve cituan se fitimi i të ardhurave për familjet e tyre është arsyeja kryesore të të qenit në rrugë. Për më tepër, 30% (234) thanë se ata nisën të punonin në rrugë të detyruar nga prindërit e tyre dhe 4% (32) pretenduan presionin nga të rritur të tjerë.

Duke marrë detyrimin si një tregues, megjithëse nuk është një mjet thelbësor për trafikimin apo shfrytëzimin e fëmijëve (sipas Protokollit të Palermos), del përfundimi se mbi një e treta e fëmijëve në situatë rruge janë në rrezik trafikimi. Në fakt, një nga aktorët ofrues shërbimi i ka referuar Mekanizmit Kombëtar të Referimit (MKR) mbi Anti – Trafikimin 31 raste të trafikimit të fëmijëve në situatë rruge, duke përfshirë shfrytëzimin seksual dhe lypjen në Shqipëri dhe Kosovë. Duke marrë parasysh mungesën e informacionit mbi trafikimin e brendshëm dhe në veçanti, mbi shfrytëzimin seksual të fëmijëve brenda Shqipërisë, kjo është një fushë e cila kërkon një studim më të thellë dhe vëmendje për të adresuar këto shqetësime serioze të mbrojtjes së fëmijës.

Arsimi është një fushë që ka nevojë për veprim duke pasur parasysh shifrat alarmuese të pengesave të cilat dhunojnë të drejtat e fëmijës dhe dëshirën e fortë të shprehur nga vetë fëmijët për të shkuar në shkollë dhe përmirësuar mundësitë e tyre. Nga intervistat fillestare shumica e fëmijëve në situatë rruge në Shqipëri u identifikua në një moshë për arsimin themelor të detyrueshëm (deri në 15 vjeç), pra 83.8% (655 fëmijë), gjithsesi rreth 62% (485) e fëmijëve nuk ishin aktualisht

të regjistruar në shkollë ose ishin të regjistruar por që nuk e frekuentonin. 21% (167) e fëmijëve nuk kanë qenë kurrë në shkollë. Ndërmjet statistikave zyrtare dhe përfundimeve të studimit ka një kontrast të konsiderueshëm.

Rekomandimet për të zgjidhur këto çështje janë fokusuar në adresimin e faktorëve të rrezikut të cilat dalin nga mungesa e qëndrueshmërisë së fëmijës, e cila, përveç regjistrimit në shkollë, nënkupton mungesë akses në shumë shërbime themelore të nevojshme. Ndërkohë që mungesa e regjistrimit në një qytet për shkak të lëvizshmërisë prek aksesin në shërbime, studimet e rastit kanë treguar gjithashtu sesi akses në shërbime preket nga diskriminimi brenda sistemit shëndetësor dhe mund të çojë deri në vdekshmërinë e fëmijëve.

Në përgjithësi, aktorët kyç konsoliduan një kuptueshmëri të përbashkët mbi faktorët social – ekonomikë që qëndrojnë pas fenomenit të fëmijëve në situatë rruge, por gjithashtu përmendën faktorë të tjerë kontribuues të cilët përfshijnë: urbanizimin e shpejtë të kohëve të fundit, ndryshimet në formimin dhe dinamikën e familjes si dhe cilësinë e dobët të sistemit të tanishëm të arsimit dhe shërbimeve sociale. Studimet e rastit tregojnë se si dështimet në sistem nënkuptojnë se fëmijët që jetojnë në situata kritike kanë më shumë gjasa të hyjnë në sistemin e mirëqenies sociale pasi ato futen në konflikt me ligjin, sesa nëpërmjet ndërhyrjeve direkte të aktorëve institucionalë përgjegjës për mirëqenien e tyre. Në fund, studimi detajon rekomandime për sistemin e shërbimeve sociale, përfshirë përmirësimin e qasjeve aktuale për mbrojtje efektive duke i parë fëmijët si pjesë e ndryshimit dhe jo si një problem.

Rezultatet e këtij studimi pritet të luajnë një rol të rëndësishëm në Reformën Kombëtare të Shërbimeve Shoqërore të ndërmarrë nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe do të përdoren për finalizimin e Planit Kombëtar Shqiptar të Veprimit dhe Udhëzimet e Proçedurave të Punës për fëmijët në situatë rruge. Rezultatet e studimit do të shërbejnë si një bazë fillestare për projekte të tjera kërkimi në të ardhmen mbi fëmijët në situatë rruge në Shqipëri si dhe informuar hartimin e ndërhyrjeve në të gjithë vendin në të mirë të tyre.

Kreu I: Hyrje

I.1 Konteksti i vendit



Foto 1: Harta gjeografike e Shqipërisë

Qëllimi është të sigurojë se mbrojtja sociale funksionon gjithashtu edhe për anëtarët dhe grupet më të pambrojtura në shoqëri. Ndërkohë, ndërhyrjet nga organizatat e shoqërisë civile plotësojnë një pjesë të boshllëkut. Shoqëria civile ka ndihmuar në zhvillimin e programeve dhe modeleve të cilat mbrojnë fëmijët duke reduktuar rrezikun dhe duke ofruar shërbime miqësore ndaj fëmijëve. Megjithatë bashkërendimi ndërmjet niveleve qendrore, rajonale dhe vendore e OJQ - ve është përmirësuar, ndarja e përgjegjësive ndërmjet partnerëve nuk është përcaktuar apo përkrahur qartë. Grupet e disavantazuara si fëmijët në situatë rruge kanë akses më të vogël në shërbimet mjaft të nevojshme, dhe vazhdojnë të qëndrojnë jashtë kufijve të shoqërisë. Si rezultat i kësaj situatë preken

Shqipëria është një vend i vogël i ndodhur në Evropën Juglindore. Ajo ka një popullsi prej rreth 2.8 milionë banorësh, nga të cilët një e treta janë fëmijë.⁶

Fenomeni i fëmijëve në situatë rruge ka prekur shoqërinë shqiptare për 23 vitet e fundit.⁷ Përpara tranzicionit të vitit 1990 në Shqipëri nga një vend komunist në demokraci, nuk ishte e pranueshme që fëmijët të punonin në rrugë dhe të angazhoheshin në lypje, pastrim xhamash të makinave, ndihmë në parkimin e makinave apo tregti. Tranzicioni i eliminoi këto kufizime, duke krijuar një zonë gri ku fëmijët mund të përfshiheshin në aktivitetet e rrugës.

Megjithatë institucionet shtetërore janë përpjekur të përmirësojnë efikasitetin e sistemit të mbrojtjes sociale dhe cilësinë e shërbimeve sociale për grupet e pambrojtura, nuk ekzistojnë mekanizma shtetërorë për të identifikuar, mbrojtur dhe rritur rehabilitimin e këtyre fëmijëve.

Situata duket se nuk ka fund dhe se ka dalë jashtë kontrollit. Kjo është për shkak të faktorëve të shumfishtë, përfshirë mungesën e strukturave dhe mekanizmave funksionalë nga organet e politikave dhe të vendimmarrjes, autoritetin e kufizuar të OJQ-ve dhe boshllëqeve në kuadrin legjislativ. Aktorët nuk kanë koordinim dhe zbatim të aktiviteteve parandaluese dhe kjo pengon ecurinë ndaj eliminimit të këtij fenomeni.

MMSR po vijon të reformojë sistemet e kujdesit social dhe të shërbimeve sociale.

6 <http://www.instat.gov.al/en/census/census-2011.aspx> - INSTAT, Census 2011

7 Alma Maksutaj & Altin Hazizaj, Puna e Fëmijëve dhe Fëmijët e Rrugës në Shqipëri - Një studim mbi shfrytëzimin ekonomik dhe punën e detyruar të fëmijëve në Shqipëri, CRCA, Nëntor 2005

kushtet e tyre fizike, shëndeti, dhe zhvillimi personal.

Arritja e ndryshimeve të qëndrueshme, sfidimi i pabarazive dhe arritja e segmenteve më të "marxhinalizuara" të popullsisë vazhdon të jetë një sfidë kyçe për Shqipërinë në përpjekjet e saj për të arritur objektivat e saj për të drejtat e njeriut. Kuvendi i Shqipërisë miratoi një ligj për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës në vitin 2010 dhe megjithëse disa mekanizma të krijuar nga legjislati nisën të funksionojnë (p.sh. Agjencia Kombëtare për Mbrojtjen e Fëmijës, Njësitë për të Drejtat e Fëmijës dhe Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijës), shumica nuk janë ende plotësisht funksionale dhe nuk mund të mbulojnë të gjitha nevojat vendore.

Përlogaritjet e partnerëve të ndryshëm qeveritarë dhe joqeveritarë mbi numrin e fëmijëve në situatë rruge variojnë nga 1,500 në 3,000 në nivel kombëtar. Statistikat e besueshme zyrtare mungojnë për një sërë arsyesh, duke përfshirë:

- Fëmijët numërohen vetëm nën këndvështrimin e punës së fëmijëve;
- Fëmijët shihen kryesisht si anëtarë të komunitetit Rom ose Egjiptian;
- Ofruesit e shërbimeve sociale kanë vështirësi për të ndarë fëmijët në situatë rruge nga shumica e përgjithshme e rasteve për trajtim;
- Vështirësia për të ndarë fëmijët në situatë rruge në sisteme të dhënash të lidhura me fëmijët në konflikt me ligjin;
- Grupe të fëmijëve në situatë rruge të cilat nuk ishin studiuar më parë, të tillë si fëmijët e vendosur në kujdes rezidencial por të ende janë të lidhur me rrugën;
- Mungesa e informacionit mbi fëmijët të cilët janë në rrezik të lartë për të qenë në situatë rruge, të tillë si fëmijët e pashoqëruar të identifikuar në kufi.

Përtej fokusimit mbi grupe të vogla apo kategori specifike fëmijësh, ndërhyrjet e politikës rrallë i identifikojnë fëmijët në situatë rruge si të lidhur me varfërinë - ose një strategji mbijetese - dhe si pasojë nuk i përfshijnë ata në kuadrin e përgjithshëm të mbrojtjes.

1.2 Objektivat e studimit

Mangësitë e sipërpërmendura kanë çuar në këtë studim mbarëkombëtar. Projekti kombinon mbledhjen sistematike të të dhënave të drejtuar nga vëzhgimi me ato të analizave të rasteve të studimit, intervista dhe fokus grupe. Qëllimi ishte përvijimi i pamjes më të saktë të mundshme të fenomenit të fëmijëve në situatë rruge në Shqipëri dhe ofrimi i rekomandimeve të bazuara në fakte. Ky studim ofron një analizë të thellë për të kuptuar më mirë situatën e fëmijëve në situatë rruge në të gjithë vendin dhe rekomandime të bazuara mbi fakte për ndërhyrjet e përshtatshme për fëmijët në situatë rruge në Shqipëri. Ky studim do të ndahet me strukturat përkatëse të qeverisë për të mbështetur hartimin e strategjive të reja, përmirësuar ofrimin e shërbimeve dhe ndihmuar mekanizmat e tjerë mbështetës të nevojshëm për këta fëmijë dhe familjet e tyre. Ky studim do të shërbejë gjithashtu për të informuar të gjithë aktorët të tillë si donatorët dhe OJQ-të për hartimin e ndërhyrjeve të tyre të ardhshme për të mbështetur qeverinë në këtë drejtim.

Nëpërmjet analizave sasimore dhe cilësore, ky studim synon të kuptojë përmasat e fenomenit të fëmijëve në situatë rruge në Shqipëri dhe të identifikojë se cilat janë pjesët e sistemit të mbrojtjes së fëmijë/familjes të cilat duhet të rifuqizohen. Ai ofron të dhëna të vlefshme dhe të besueshme mbi përhapjen, karakteristikat dhe nevojat e fëmijëve në situatë rruge në Shqipëri. Ai rekomandon gjithashtu programet përkatëse dhe të përshtatshme për të zvogëluar numrin e fëmijëve të rrugës dhe për të adresuar nevojat e tyre.

Ky studim u krye në nivel kombëtar, duke përdorur të gjitha rrugët e mundshme për mbledhjen e të dhënave në nivele të tjera. Kjo përfshiu një përpjekje të koordinuar me institucionet për të mbledhur të dhëna nga të gjitha burimet e mundshme në të gjithë Shqipërinë në nivel vendor, qarku, dhe kombëtar.

Ky studim përlogarit numrin e fëmijëve në situatë rruge në 12 qarqet administrative të Shqipërisë: Berat, Dibër, Durrës, Elbasan, Fier, Gjirokastrë, Korçë, Kukës, Lezhë, Shkodër, Tiranë dhe Vlorë.

Nga literatura dhe konsultimet fillestare me aktorët kyç, ishte e qartë se gjatë kohës së studimit, një numër i madh fëmijësh nuk ishin të pranishëm në Shqipëri. Kjo vinte për shkak të lëvizjes konstante të këtyre fëmijëve brenda dhe jashtë në vendet fqinje. Ndërkohë që ky studim nuk synonte vlerësime sasiore të numrit të fëmijëve në situatë rruge jashtë vendit gjatë periudhës së studimit, u mblodhën disa të dhëna nga OJQ-të të cilat punonin në këtë sektor dhe Policia e Kufirit. Në këtë mënyrë, ky studim adreson fenomenin e mundshëm të trafikimit dhe shfrytëzimit e fëmijëve drejt Kosovës dhe Greqisë si dhe çështje kritike në parandalimin dhe mbrojtjen ndaj zhvendosjes së detyruar të fëmijëve në vendet e Evropës Perëndimore, duke qenë se disa vajza shqiptare janë subjekt i trafikimit seksual ose punës së detyruar pas martesave me shkuasi. Studimi përmban të dhëna të besueshme për fëmijët në situatë rruge në fushat e mëposhtme:

- Karakteristikat e fëmijëve në situatë rruge (përfshirë grupe të mbivendosura të cilat përbëjnë fëmijët në situatë rruge dhe grupe të cilat nuk janë studiuar më parë në thellësi);
- Shifra të besueshme dhe mbledhje të strukturuar të të dhënave;
- Karakteristikat demografike;
- Sfondin familjar dhe rrethanat;
- Kushtet e jetesës dhe kushtet e rrugës;
- Statusin arsimor dhe administrativ;
- Problemet shëndetësore dhe shërbimet sociale;
- Njohja dhe përdorimi i shërbimeve; dhe
- Gjenerimi i të ardhurave dhe cilësia e jetës.

1.3 Përkufizime

Deri tani, fëmijët në situatë rruge në Shqipëri janë përfaqësuar zakonisht si me origjinë Rome apo Egjiptiane, të moshës nga 5 - 14 vjeç dhe kryesisht të martuar në një moshë të re. Për më tepër, ata përfaqësohen si fëmijë që vijnë nga familje ku prindërit ose nuk janë të aftë, ose nuk kanë dëshirë të angazhohen në një punësim formal, ose janë të varur nga alkooli dhe i rezistojnë ndryshimit. Këta fëmijë shihen ose si viktimë, ose si kriminelë.⁸ Këto stereotipe nuk arrijnë të japin një pasqyrë të qartë se kush janë fëmijët në situatë rruge dhe gamën e aktiviteteve në të cilat ata janë të përfshirë.

Fëmijët në situatë rruge në Shqipëri janë adresuar nga publikime të ndryshme. Këto publikime janë fokusuar veçanërisht në: fëmijët në situatë rruge,⁹ fëmijët e përfshirë në aktivitete përkatëse si lypja apo aktivitetet e paligjshme,¹⁰ dhe në grupet e tjera përkatëse të synuara.¹¹ Gjithsesi, fëmijët në situatë rruge përbëhen nga këto dhe grupe të tjera të mbivendosura, të cilat më parë nuk janë studiuar në thellësi.

Shembuj të grupeve të cilat nuk janë studuar më parë përfshijnë:

- Fëmijë të cilët nuk janë nga një grup minoritar por janë të angazhuar për shembull në tregtinë e rrugës apo në larjen e makinave;

8 Të drejtat njerëzore OKB/ UNICEF/Konsorciumi për Fëmijët e Rrugës /AVIVA: Mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të fëmijëve të cilët punojnë dhe/ose jetojnë në rrugë, 2012

9 Save the Children & CRCA: Legjislati dhe shërbimet publike për fëmijët në situatë rruge, Save the Children 2011

10 EcorysHolandë nga Ecpat Austria, Save the Children Europe Group, Salvati Copiii (Save the Children Rumani), Save the Children Danimarkë, Save the Children Itali, Terres des Hommes: Raport për Studimin mbi Tipologjinë dhe Përgjigjet e Politikave për Lypjen e Fëmijëve në BE. Projekt i Financuar nga Komisioni Evropian, 2012

11 UNICEF & MMSR: "Hartëzimi i Shërbimeve për Fëmijët Romë në Shqipëri", UNICEF, 2012, www.sidalbania.org

- Fëmijët, meshkuj dhe femra, të cilët shfrytëzohen seksualisht në rrugë dhe nuk janë të mbrojtur nga legjislacioni shqiptar nga MKR për Viktimat e Trafikimit apo jurisprudenca dhe për të cilët, shërbimet e pakta të disponueshme nuk janë domosdoshmërisht të përshtatshme;
- Fëmijët në situatë rruge përgjegjës për fëmijë të tjerë në situatë rruge, veçanërisht vajzat e detyruara për martesë në moshë të re të cilat i marrin fëmijët e tyre në rrugë;
- Fëmijët të cilët jetojnë në jetimore apo institucione të përkujdesjes rezidenciale të cilët janë në rrezik për t'u bërë të pastrehë kur largohen nga kujdesi i Shtetit pasi mbushin moshën 16 vjeç.

Termi “fëmijë rruge” u përcaktua për herë të parë nga Komisioni për të Drejtat e Njeriut në vitet 1990 si “çdo vajzë apo djalë [...] për të cilin rruga [...] është bërë vendqëndrimi dhe/ose burimi i jetesës së përhershme, dhe i cili/e cila nuk mbrohet, mbikqyret apo drejtohet në mënyrë të përshtatshme nga të rriturit përgjegjës”.¹² Ky përkufizim përfshinte tre kategori të fëmijëve të rrugës (i njohur si “Përkufizimet e hershme të UNICEF - it”):

- Fëmijë “të” rrugës (fëmijë të cilët jetojnë në rrugë), të cilët flenë në hapësira publike pa familjet e tyre;
- Fëmijë “në” rrugë (fëmijë të cilët punojnë në rrugë) të cilët punojnë në rrugë gjatë ditës dhe kthehen në familjet e tyre në shtëpi për të fjetur;
- “Fëmijë me familje në rrugë” të cilët jetojnë me familjen e tyre në rrugë.¹³

Termi “fëmijë rruge” ka evoluar me kalimin e viteve. Kjo ka ndodhur për shkak të mbivendosjes së kategorive të mësipërme, si dhe si një përgjigje e fenomenit të fëmijëve të cilët largohen në vende më të pasura dhe lëvizjes së fëmijëve ndërmjet rrugëve, strehëzave dhe shtëpive për shkak të sezoneve apo problemeve familjare. Për më tepër, ngjyresa negative janë shoqëruar me terminologjinë “fëmijë rruge”. Kjo u zëvendësua duke deklaruar qartë se problemi ishte “situata” në të cilën ndodhen fëmijët dhe jo “fëmijët” vetë, prandaj rezoluta e Këshillit të të Drejtave të Njeriut 16/12 në vitin 2011¹⁴ i referohet fëmijëve të cilët punojnë dhe/ose jetojnë në rrugë si “fëmijë në kushte rruge” (jo si “fëmijë rruge”)/ më pas, Komiteti mbi të Drejtat e Fëmijës miratoi edhe këtë terminologji.

Ekziston një debat global mbi përkufizimin e një “fëmije në situatë rruge”¹⁵ dhe termi ka evoluar në vitet e fundit. Shqipëria ka një literaturë të kufizuar vendore e cila përpiket të krijojë një përkufizim të qëndrueshëm. Gama e gjerë e përkufizimeve për fëmijët në situatë rruge ka çuar në rritje tensioni ndërmjet politikë-bërjes, ndërhyrjeve dhe studimit. Megjithëse disa përkufizime dhe qasje janë më popullore se të tjerat, është e rëndësishme të kuptohen idetë dhe realitetet e reja të lidhura me kontekstin e çdo vendi.

Në Shqipëri është e qartë se ka mungesë konsensusi ndërmjet informatorëve dhe aktorëve kyç mbi përkufizimin e fëmijëve në situatë rruge. Pra, duke e lënë mënjanë debatin ndërkombëtar mbi përkufizimet, nuk mund të injorohet se në kontekstin e Shqipërisë, etiketa “fëmijë rruge” është një kategori e ndërtuar sociale e cila në realitet nuk përfaqëson një popullsi të përcaktuar qartë, homogjene apo si fenomen.¹⁶ Për më tepër, përkufizimet dhe terminologjitë e kundërshtuara e kanë vështirësuar përlogaritjen e qartë të shkallës së këtij fenomeni.¹⁷

Në Shqipëri ekziston një diplomë e Punës Sociale në institucionet tretësore, por nuk ka asnjë kurs të plotë mbi Punën Sociale në Rrugë apo fëmijët dhe familjet në situatë rruge: ajo është e kufizuar në një pjesë të vogël të kursit të përgjithshëm të Punës Sociale. Kjo nënkupton mungesë të personave të kualifikuar për të ndërhyrë, e cila së bashku me mungesën e përkufizimeve/treguesve për fëmijët në situatë rruge në legjislacionin e Shqipërisë,¹⁸ rezultojnë në fëmijë në situatë rruge të cilët shpesh

12 UN OHCHR, Mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të fëmijëve të cilët punojnë dhe/ose jetojnë në rrugë, 2011 <http://www.ohchr.org/Documents/Issues/Children/Study/OHCHRBrochureStreetChildren.pdf> fq.8

13 <http://streetchildren.org/content.asp?pageID=31>

14 http://ap.ohchr.org/documents/dfaqe_e.aspx?si=A/HRC/RES/16/12

15 Panter Brick, Catherine; “Fëmijët e Rrugës, të Drejtat Njerëzore dhe Shëndeti Publik” në volumnin e Fëmijëve, të Rinjve dhe Mjedisëve 13 Nr.1 Departamenti i Antropologjisë, Publikim i Universitetit Durham, 2003

16 <http://www.ohchr.org/Documents/Issues/Children/Study/OHCHRBrochureStreetChildren.pdf> fq.9

17 <http://www.ohchr.org/Documents/Issues/Children/Study/OHCHRBrochureStreetChildren.pdf> fq.10

18 Këshilli i Ministrave – Vendim (12.04.2012) Nr. 267, mbi treguesit për Sistemin e Mbrojtjes së Fëmijëve në Shqipëri

zbulohen dhe vlerësohen vetëm në termat e rrezikut të lartë apo situatave të emergjencës.

Në fund, kjo situatë e ndërhyrjes së papërshtatshme përkeqësohet nga mungesa e informacionit apo përdorimi i terminologjisë së zakonshme në qarqet akademike, veçanërisht në studime. Ajo ka krijuar një boshllëk në bërjen e politikave dhe në studim, duke penguar kalimin nga një qasje tradicionale në një qasje të re, më të përqendruar tek fëmijët, e cila trajton fëmijët në situatë rruge (shih tabelën 1).¹⁹ Ky hendek përforcon perspektivat e vjetra të cilat i shikojnë fëmijët në situatë rruge si viktimë dhe si të mbijetuar dhe nuk i pranon ata si aktorë të aftë socialë, siç u cilësuan nga Tavolina e Rrumbullakët me aktorët kombëtarë, e cila u mbajt për qëllimet e këtij studimi.

Tabela 1: Matricë që tregon elementët kyç të një ndryshimi modeli në studimin dhe punën me dhe për fëmijët në situatë rruge

Zhvendosja nga idetë që:	Nëpërmjet ideve të:	Për pasojat e mëposhtme:		
		Teoria	Studimi	Praktika
Fëmijët në situatë rruge janë viktimë të pastreha dhe të braktisura	Hapësirës	Fëmijët në situatë rruge krijojnë kuptime për përdorimin e hapësirave të rrugës dhe formojnë rrjete mbështetëse	Për studimin e jetëve të fëmijëve në situatë rruge nevojitet një shumëllojshmëri metodash të shumëfishta	Përdorimi i rrugës si një hapësirë për programim; të ndërtuar mbi pika të forta dhe rrjetet ekzistuese
Jetët e fëmijëve në situatë rruge janë kaotike; ata do të bëhen keqbërës	Kohës	Fëmijët në situatë rruge kanë karriera të cilat ndryshojnë në rrugë dhe moshë e tyre në rritje është një faktor i rëndësishëm.	Studimet e përsëritura janë jetike	Programim afat - gjatë i ndjeshëm ndaj moshës, me ndjekje për të siguruar zhvillimin e potencialit.
Të rriturit e dinë më mirë; të rriturit kontrollojnë dhe mbikëqyrja është e nevojshme për të siguruar mirëqenien e fëmijëve.	Ndërtimi social i kuptimit	Fëmijët janë agjentë aktivë në jetët e tyre; ata ndërtojnë kuptimin dhe janë subjekt i të drejtave.	Studimi pjesëmarrës i përqendruar tek fëmijët nuk është vetëm një domosdoshmëri, ai është gjithashtu një e drejtë e fëmijës	Përdorimi i një qasjeje të përqendruar tek fëmijët e të bazuar në të drejta; fëmijët duhet të përfshihen si partnerë në të gjitha aspektet e programimit

Një nga sfidat më të mëdha të këtij studimi ishte puna për përkufizimin e përbashkët të fëmijëve në situatë rruge dhe krijimi i një kuptimi të bashkuar mbi këtë përkufizim të përbashkët. Kjo u bë për të adresuar problemet e të gjithë fëmijëve në situatë rruge si dhe për të kryer një vlerësim gjithëpërfshirës të ndërhyrjeve të deritanishme.

Në këtë studim, përkufizimi i fëmijëve në situatë rruge është fëmijë nën moshën 18 vjeç të cilët kanë njëfarë lidhjeje me rrugën, zakonisht prej të jetuarit dhe/ose të punuarit aty, në baza stinore apo kalimtare.

19 Ennew, Judith dhe Jill Swart-Kruger. "Hyrye: Shtëpitë, Vendet dhe Hapësirat në Ndërtim për Fëmijët dhe të Rinjtë e Rrugës" Fëmijët, Rinia dhe Mjediset 13(1), Pranverë 2003

Ky përkufizim i fëmijëve në situatë rruge përfshin:

- Fëmijë në situata lypjeje, të cilët janë vetëm ose me të tjerë, përfshirë mbajtjen në krahë, të cilët mund të jenë duke ofruar sende apo shërbime për një tarifë simbolike;
- Fëmijët të cilët punojnë në mënyrë informale në rrugë, në aktivitete të tilla si mbledhja e sendeve plastike apo metalike për riciklim apo si tregtarë rruge;
- Fëmijë në rrugë të cilët ose i shesin sende publikut në vende si semaforët, baret/kafenetë ose në vende të caktuara në anë të rrugës, ose shesin shërbime të tilla si parkimi, mbajtja e valixheve (hamall) ose lustrimi i këpucëve;²⁰
- Fëmijë të përfshirë në aktivitete seksuale për përfitime ekonomike;
- Fëmijë në konflikt me ligjin të cilët janë të përfshirë në krime rruge të tilla si transportimi apo shitja e drogës.

Kjo gamë aktiviteteve dhe situatash, e identifikuar nga puna e vazhdueshme në terren, është përdorur për të përcaktuar se kur një fëmijë konsiderohet të jetë në një "situatë rruge" në kontekstin shqiptar. Ky fenomen vijon të zhvillohet duke ndryshuar nevojat dhe pambrojtshmërinë e fëmijëve dhe familjeve të tyre dhe është e rëndësishme të sigurohet se fëmijët do të përfshihen në mënyrë të drejtpërdrejtë në studimet e ardhshme për të mbështetur bërësit e politikave dhe ofruesit e shërbimeve për të përcaktuar kufijtë e tyre të ndërhyrjes.


20 Megjithëse në të shkuarën fëmijët ishin të përfshirë në këtë lloj aktiviteti rruge, vlerësimi në të dyja fazat e numërimit (verë dhe vjeshtë) nuk gjeti asnjë fëmijë të përfshirë në pastrimin e këpucëve.

Kreu II: Metodologjia e studimit dhe grupimi i të dhënave

II.1 Hartimi dhe fazat e studimit

Studimi u krye në nivel kombëtar me qëllim për të mbledhur informacion nga sa më shumë burime të besueshme të mundura, të verifikojë këto të dhëna dhe të sigurojë përkatësinë ndaj aktorëve të ndryshëm. Pasqyra e mëposhtme është një paraqitje grafike e metodologjisë së studimit dhe fazave përkatëse në studimin numerik dhe atë cilësor, duke treguar shumëllojshmërinë e burimeve dhe teknikave të përdorura. Studimi shifror përfshiu studimin në zyrë, vëzhgimin dhe numërimin e personave në terren (anketim në terren), më pas diskutimet mbi rastet e studimit dhe të dhënat zyrtare në një tabelë teknike –me shumë agjensi, ndërkohë që studimi cilësor u hartua në të njëjtin studim në zyrë për të ndërmarrë intervistat fillestare të fëmijëve në situatë rruge dhe pyetësorët e mbyllur me informatorët kyç, për tu thelluar më tej duke konsultuar fëmijët dhe komunitetet në fokus grupe, e më pas në intervista gjysmë - të strukturuar, të thella me aktorët dhe fëmijët, idealisht të lehtësuara nga përfshirja e bashkëmoshatarëve. Procesi i studimit dhe analizës u nda në tryezat e rrumbullakëta teknike me ofruesit e shërbimeve dhe aktorët kyç dhe përfundimet e nxjerra do të ndahen me fëmijët dhe komunitetet e përfshira.

Tabela 2: Procesi i studimit i cili detajon metodologjitë sasiore dhe cilësore



Përlllogaritja e numrit të fëmijëve në situatë rruge në Shqipëri ishte një përpjekje komplekse. Metodologjia e përdorur e studimit kombinoi analiza të shkencave sociale dhe teknika të kapjes - rikapjes. Të dyja këto teknika patën të meta për shkak të natyrës të pakapshme dhe të lëvizshme të fëmijëve të anketuar.²¹ Përveç kësaj, metodologjia u hartua mbi qasjet teorike të përdorura në studime

21 Sarah Thomas de Benitez, Raport mbi Gjendjen e Fëmijëve të Rrugës në Botë: Studim, Publikuar nga Konsorciumi për Fëmijët e Rrugës në 2011, fq. 5

të tjera si Karakteristikat e Fëmijëve të Rrugës në Tiranë, Shqipëri (Eorld Vizion, 2008)²² dhe Fëmijët Urbanë të Rrugës në Gjeorgji (Save the Children-UNICEF, 2009).²³ Ky i fundit është marrë si referencë për shkak të objektivit të ngjashëm në dhënien e përlllogaritjeve numerike për fenomenin në një vend me masë popullore të përafërt me Shqipërinë.

Metodologjitë e përdorura në studim janë:

- Hartëzimi i vendndodhjeve në Kohë;
- Procesi i numërimit (në dy faza);
- Konsultimi i fëmijëve dhe informatorëve kyç nëpërmjet intervistave ballë për ballë;
- Pyetësorëve të mbyllur me informatorët kyç; dhe
- Diskutimeve në fokus grupe me fëmijët dhe anëtarët e komunitetit.

Subjektet e studimit u qasën nëpërmjet kampionimit top - bore ose kampionimit të drejtuar nga intervistat, duke përfshirë rekrutimin nga bashkëmoshatarët. Gjatë të gjithë procesit në punën me fëmijët u përdorën standardet më të larta etike ndërkombëtare të mbledhjes së të dhënave.

I gjithë stafi i përfshirë në kryerjen e intervistave, përfshirë përkthyesit apo ndërmjetësit kulturorë, u trajnuan mbi parimet e të drejtave të njeriut dhe metodologjinë e studimit të të drejtave të njeriut. Ata u trajnuan dhe u bënë përgjegjës mbi udhëzimet etike duke pasqyruar një përjasje studimi të mbështetur mbi të drejtat e fëmijës (shih Shtojcën C).²⁴Fëmijët u panë si subjekt i këtij studimi dhe jo si një objekt i cili duhet analizuar dhe kategorizuar. Përfshirja e tyre në zhvillimin e pyetjeve të studimit ishte vullnetare, duke respektuar plotësisht dëshirën e tyre për të marrë pjesë dhe u provua se ishte thelbësore për studimin. Fëmijët u informuan plotësisht mbi personat që po kryenin studimin, qëllimin e studimit dhe se si do të përdorej informacioni i mbledhur.

II.1.1 Hartëzimi i vendndodhjes sipas kohës

Hartëzimi i vendndodhjes sipas kohës u krye në datat 13 dhe 14 korrik 2013 dhe 6 dhe 7 tetor 2013. Qëllimi i kësaj faze ishte të identifikonte pikat fokale dhe periudhat kohore me numrin më të lartë të fëmijëve në të gjithë territorin. Arsyeja pse hartëzimi i vendndodhjes sipas kohës u përsërit në vjeshtë ishte për të krijuar hartën e situatës jashtë periudhës së verës si dhe për të pasur një përlllogaritje më të saktë të numrit të përgjithshëm të fëmijëve në situatë rruge. I gjithë procesi ndihmoi për të mbledhur të dhëna për analiza të mëtejshme, krijimin e një kuptueshmërie më të thellë të karakteristikave të qytetit dhe përgatitjen e terrenit për fazën e mëtejshme.

Vëzhgimet u bënë nga një automjet i cili lëvizte ngadalë duke mundësuar një numërim fillestar të fëmijëve dhe vendndodhjeve të tyre. Kjo ndihmoi për të kufizuar zonën gjeografike brenda qyteteve të përzgjedhura për Fazën e Procesit të Numërimit, të ndërmarrë nga ekupe të mirë – trajnuara të cilët numëruan fëmijët në situatë rruge në intervale të rregullta për një periudhë 2 – 3 ditore. Ata ishin të trajnuar për të vëzhguar në mënyrë të rezervuar dhe të mos largoheshin nga makinat me përjashtim të rasteve ku terreni nuk ofronte akses për makinat si parqet publike, varrezat, qendrat e qytetit në jug të Shqipërisë, tregjet e hapura etj.

Ekipi i përfshirë në këtë proces ndoqi një sesion një ditor trajnimi i cili mbuloi një gamë temash të tilla si parimet themelore të etikës, procedurat për fazat e studimit dhe parimet themelore të vëzhgimit. Ata u trajnuan gjithashtu për të kuptuar plotësisht karakteristikat e një fëmije në situatë rruge nëpërmjet një liste të parapërgatitur të karakteristikave. Një fletë vëzhgimi me një listë karakteristikash u përgatit nga organizata drejtuese dhe më pas u rishikua nga vëzhguesit. Ekipi u trajnuar në mbledhjen e informacionit në këtë fazë dhe mbi rëndësinë e veçimit nga fazat e tjera në mënyrë që të krijohet një marrëdhënie

22 Tonya R. Thurman, Lisa Johnston, Bridget Lavin, Elizabeth Bunde, Nancy Mock (Universiteti Tulane, SHBA), Karakteristikat e Fëmijëve të Rrugës në Tiranë, Shqipëri. Një studim sasior, publikuar nga World Vision Shqipëri 2008
 23 Katarzyna Wargan, Larry Dershem, Mos më Quaj një Fëmijë Rruge - Përlllogaritje dhe Karakteristika të Fëmijëve Urbanë të Rrugës në Gjeorgji, Save the Children dhe UNICEF 2009
 24 Dr. Zosa De Sas Kropiwnicki, Procesi i Studimit: Një grup instrumentesh për kërkim të përqendruar tek fëmijët për parandalimin e trafikimit, Korrik 2007

besimi me fëmijët. Ata ishin ashtu të përgatitur të reagonin në mënyrë me ndjeshmëri ndaj pyetjeve të ndryshme të cilat mund të dilnin gjatë procesit, t'u përgjigjeshin atyre në mënyrën e përshtatshme dhe të vlerësonin situatat ku ata mund të kishin nevojë për ndihmë të menjëhershme. Atyre iu ofrua informacioni themeltar mbi shërbimet e ndryshme ku fëmijët mund të referoheshin, nëse kjo ishte e nevojshme.

“Rruga” është një koncept i gjerë dhe i referohet vendeve mjaft të njohura nga fëmijët; vendet ku ata shpenzojnë shumicën e kohës së tyre gjatë ditës apo natës. Gjatë kësaj faze pati pak zona të brendshme ku fëmijët nuk u vëzhguan, përfshirë kafenetë, restorantet, bizneset e vogla të zotëruara nga familjet e tyre.

II.1.2 Procesi i numërimit

Faza e procesit të numërimit u ndërmor menjëherë pas fazës Hartëzimit të Vendndodhjes sipas Kohës dhe përdori informacionin e disponueshëm të zotëruar nga ofruesit e shërbimeve dhe të dhënat e mbledhura nga Faza e parë, përfshirë kohën më të mirë për të identifikuar fëmijët. Ky proces u ndërmor në intervale të rregullta për tre ditë në vazhdim. Procesi i Numërimit u ndërmor njëkohësisht në të gjitha qytetet (në vend-ndodhjet e përzgjedhura) për të reduktuar gabimet dhe rritur besueshmërinë.

Procesi i numërimit (Faza 1) u ndërmor në gusht 2013 në 8 qarqe, ndërkohë që Faza 2 u ndërmor në 12 qarqe në muajin tetor 2013 (shih Tabelën 2).

Tabela 3: Numri i sektorëve të qytetit të vëzhguar në të dy fazat, sipas qarqeve.

Nr.	Faza 1	Faza 2
1	Tiranë Qyteti i Kavajës	Tiranë Qyteti i Tiranës / Qyteti i Kavajës / Rrogozhina / Zonat e Kamzës / Vora
2	Durrës Zonat e plazhit të Golemit Gjiri i Lalzit	Durrës Qyteti i Durrësit / Qyteti i Krujës / Fushë Kruja Zonat e Shijakut / Manza / Sukth
3	Vlora Qytetet e Sarandës/Vlora / Zonat e Borshit/Dhërmiut/Drimadhës/Ksamilit/Himarës	Vlora Qytetet e Sarandës/ Vlora / Delvina /Zonat e Ksamilit/Vrionit/Himarës
4	Dibër Qytetet e Peshkopisë / Burrelit / Bulqizës / Milotit / Zonat e Klosit	Dibër Qytetet e Peshkopisë / Burrelit / Bulqizës / Klosit / Zona e Sucit / Shupenzës
5	Elbasan Qyteti i Elbasanit / Peqini / Cërriku / Zona e Paper	Elbasan Qyteti i Elbasanit / Qytetet e Gramshit / Librazhdit / Peqinit / Belshit / Përrenjasit / Cërrikut / Zona e Paper
6	Fier Qyteti i Fierit / Zona e Plazhit të Divjakës / Plazhit të Semanit	Fier Qyteti i Fierit / Lushnja / Ballshi / Patosi / Rroskavec / Zona e Semanit
7	Shkodër Qyteti i Shkodrës / Lezhës / Zona e Talës / Shëngjini / Velipoja / Pike kalimi Kufitar i Murriqanit	Shkodër Qyteti i Shkodrës / Qyteti i Malësisë së Madhe / Pika / Fushë arrëz / zona e Talës / pike kalimi kufitar i Murriqanit
8	Korçë Qyteti i Pogradecit	Korçë Qyteti i Korçës / Qyteti i Pogradecit / Devollit / Kolonjës / Zona e Bilishtit / Leskovikut / Maliqit / Pika doganore Qaf Thanë, Tushemisht, Kapshticë
9		Lezha Qyteti i Lezhës / Mirditës / Rrëshenit / Rubikut / Kurbinit / Laçit / Mamurrasit / Milotit
10		Kukës Qyteti i Kukësit / Bajram Curri / Kruma
11		Gjirokastrë Qyteti i Gjirokastrës / Qyteti i Tepelenës / Përmeti / Zona e Këlcyrës / Memaliaj, Kakavijë
12		Berat Qyteti i Beratit / Qyteti i Kuçovës / Skraparit / Çorovodës / Poliçanit / Zona e Urës Vajgurore.

Çdo qytet pati një ekip vëzhguesish të përbërë nga përfaqësues të katër organizatave të cilat punojnë me fëmijët në situatë rruge në Tiranë²⁵ dhe Njësia e Mbrojtjes së Fëmijës. Çdo ekip u nda në ekipe më të vogla për të mbuluar të gjitha fushat me interes njëkohësisht.

Gjatë Fazës 1 (6-12 gusht), 18 pjesëtarë të stafit u caktuan për të mbuluar të gjithë nën - seksionet (zonat tregtare, ndërtesat dhe vendet e kulteve fetare, sheshet kryesore, vendbanimet e Romëve, pikat kufitare të kalimit, autostradat, segmentet rrugore kombëtare/autostradat kombëtare, etj.) dhe identifikuan zonat bregdetare dhe ato zona me një përqindje të lartë të popullsisë myslimane (për shkak të festimit të Ramazanit).

Gjatë fazë 2 (18-24 tetor), 29 pjesëtarë të stafit u caktuan për të mbuluar zonat me interes në të gjithë territorin shqiptar (12 qarqe).

Stafi i përfshirë në fazat e studimit ndihmoi për të hartuar draftin e parë të intervistës fillestare, identifikuar temat dhe problemet e rëndësishme si dhe pyetjet e reja të cilat ishin rëndësishme për qëllimin e studimit. I gjithë informacioni mbledhur gjatë pilotimit të pyetjeve të thjeshta dhe themelore për fëmijët e hasur në rrugë, ndihmoi në hartimin e intervistave të thelluara. Informacioni i mbledhur në të dy fazat ndihmoi organizatat të cilat punojnë me fëmijët në situata rruge për të plotësuar mangësitë që ato kishin në të dhënat kryesore. Ai gjithashtu ndihmoi për të identifikuar prirjet e reja dhe informacione të panjohura më parë për ekipin i cili kreu studimin.

Faza e dytë e numërimit zbuloi disa situata të cilat ishin të panjohura më parë në qytete të tilla si Gjirokastër, Kavajë dhe Shkodër, për shembull:

- Disa komunitete Rome kanë migruar nga një qytet në tjetrin (punonjësit sezonal, p.sh. në Gjirokastër më shumë se 150 familje kanë krijuar një komunitet të ri nga 'Ura e Lumit deri në NSHN, pranë lumit Drino në mënyrë që të punojnë në Lazarat për Kultivimin e kanabisit).
- Elemente të reja pune në disa zona (puna në segmente të rrugëve kombëtare/autostrada kombëtare të tilla si: Levan-Tepelenë, Tiranë-Fushë-Krujë, Burrel-Klos).
- Komunitete të tjera vulnerabël (p.sh. në Shkodër familjet janë detyruar të lëvizin për të shmangur sulmet për shkak të gjakmarrjes duke krijuar një vendbanim të ri).

II.1.3 Intervistat fillestare

Pas fazës së vëzhgimit, me fëmijët u zhvillua një intervistë e thjeshtë në të cilën të gjithë aktorët e përfshirë në proces u konsultuan për të kontrolluar të gjithë informacionin themelor.

Gjatë fazës së parë u përzgjedh një kampion përfaqësues prej 442 fëmijësh nga 2,014 fëmijësh të numëruar gjithsej dhe qëllimi ishte vëzhgimi i aktiviteteve në të cilat ata ishin të përfshirë në qytete të ndryshme. Një fokus i veçantë iu dha vëzhgimit për të parë nëse fëmijët ishin të shoqëruar apo vetëm.

Faza e dytë e procesit të numërimit gjeti 2,527 fëmijë në situatë rruge dhe prej tyre, 340 fëmijë u përzgjedhën në mënyrë të rastësishme për intervistën fillestare (Shih Shtojcën C).

Ekipi ishte i mirë - trajnuar për t'iu përgjigjur pyetjeve mbi studimin hapur dhe me një gjuhë miqësore ndaj fëmijëve, duke ndjekur udhëzimet etike (referoju Shtojcës C). Ata ishin të aftë t'i referonin fëmijët në shërbimet vendore dhe OJQ-të e fushës kur ata kishin nevojë për mbështetje. Fëmijët u përfshinë përgjatë të gjithë procesit, duke mbajtur parasysh politikën dhe procedurat e Mbrojtjes së Fëmijës për të siguruar mirëqenien e tyre.

II.1.4 Diskutime në fokus-grupe

Diskutime në fokus-grupe u kryen me fëmijë në situatë rruge dhe anëtarë të komunitetit në 6 qytete të ndryshme të Shqipërisë (shih Tabelën 4 dhe Tabelën 5). Gjithsej u kryen 16 fokus grupe ku u përfshinë 111 fëmijë në situatë rruge dhe 39 anëtarë të komunitetit. Diskutimet e fokus-grupeve

25 ARSIS, Organizatë Shoqërore për Përkrahjen e të rinjve; b) Fëmijët e Botës dhe të Shqipërisë – te Drejtat e Njeriut (FBSh/DN); c) Save the Children – Qendra Drop - in për fëmijët në situatë rruge d) Shoqata Kombëtare e Arsimit për Jetën (SHKEJ).

u drejtuan nga moderatorë apo lehtësues të trajnuar, në prani të punonjësve socialë të lidhur me grupet e përfshira.

Diskutimet e fokus-grupeve u përzgjedhën si një metodologji për të siguruar se disa pikëpamje mund të dëgjohen në të njëjtën kohë duke pasur parasysh kufizimet kohore të të gjithë palëve të përfshira. Diskutimet e fokus-grupeve u kryen në bashkëpunim me aktorët vendorë në qendrat dropin, qendrat ditore, qendrat e komunitetit, kafenetë pranë shkollave apo bar-kafetë e komuniteteve. Fëmijët të cilët morën pjesë në fokus grupe u përzgjedhën në bazë të moshës dhe gatishmërisë për të marrë pjesë. Si pasojë, për të qenë përfshirës, në disa kontekste u përfshinë edhe disa fëmijë të cilët nuk ishin në situatë rruge. Në Elbasan, në diskutimet e fokus grupit mori pjesë edhe një vajzë-nënë 17 vjeçare me një fëmijë 2 vjeçar.

Qëllimi i fazës së diskutimeve në fokus grupe ishte të mblidhte informacion më të saktë mbi problemet kyçe të cilat hasin fëmijët në situatë rruge në përputhje me shkallën e pjekurisë dhe aftësitë e tyre.²⁶ Në rang kombëtar, 111 fëmijët e konsultuar ishin të moshave midis 6 dhe 17 vjeç. Format i diskutimeve të fokus grupeve ishte hartuar në mënyrë të përshtatshme në mënyrë që të gjithë fëmijët të ishin të aftë të merrnin pjesë dhe të kishin një mundësi të barabartë për të ndarë opinionet e tyre. Ato u bazuan në role, lojëra dhe vizatime në mënyrë që të gjithë fëmijët që morën pjesë të mos dalloheshin nga mosha dhe/ose gjinia. Fokus grupet zgjatën maksimalisht 40 minuta dhe u mbështetën nga punonjësit e ARSIS. Pyetjet kyçe u ndanë me lehtësuesit së bashku me udhëzimet e përgjithshme se si duhet të drejtoheshin fokus grupet me fëmijët (Shih Shtojcën 3).

Tabela 4: Numri i diskutimeve të fokus grupeve me fëmijët

Numri i fokus grupeve	Grupi	Qyteti
3	Fëmijë, 5-11 vjeç	Tiranë
3	Fëmijë, 12-17 vjeç	Tiranë
1	Fëmijë, 6-11 vjeç	Durrës
1	Fëmijë, 12-17 vjeç	Durrës
1	Fëmijë, 6-11 vjeç	Shkodër
1	Fëmijë, 12-17 vjeç	Elbasan
1	Fëmijë 12-17 vjeç	Korçë
1	Fëmijë, 6-11 vjeç	Gjirokastrë
Gjithsej Nr. 12		

Tabela 5: Numri i diskutimeve të fokus grupeve me anëtarët e komunitetit

Numri i fokus grupeve	Grupi	Qyteti
1	Anëtarë Komuniteti	Tiranë
1	Anëtarë Komuniteti	Durrës
1	Anëtarë Komuniteti	Shkodër
1	Anëtarë Komuniteti	Gjirokastrë
Gjithsej Nr. 4		

Informacioni i mbledhur gjatë intervistave me fëmijët dhe fokus grupet u analizua në bazë të transkripteve, shënimeve dhe vëzhgimeve të studiuesit i cili kreu intervistat dhe fokus-grupet.

²⁶ Neni 12 i UNCRC i ofron një fëmije i cili është i aftë të hartojë një opinion të drejtë për t'u shprehur në mënyrë të lirë për të gjitha çështjet që prekin atë dhe këtyre opinionëve duhet t'u jepet rëndësia e duhur në përputhje me moshën dhe pjekurinë e fëmijës.

Diskutimet e fokus grupeve shërbyen gjithashtu si një urë në procesin e përzgjedhjeve të fëmijëve të cilët do të intervistoheshin në fazën pasardhëse.

II.1.5 Pyetësorë të mbyllur me informatorë kyç

Pyetësorët iu dërguan me postë dhe/ose me email aktorëve kyç në institucionet kyçe publike dhe organizatave të shoqërisë civile. Në total, 60 informatorëve të nivelit vendor dhe 20 informatorëve të nivelit kombëtar iu kërkua të jepnin opinionin e tyre të informuar mbi fenomenin e tanishëm të fëmijëve në situatë rruge dhe të listonin problemet kryesore dhe strategjitë e ndërhyrjes sipas rëndësisë. (Shih Shtojcën 6).

II.1.6 Intervista në thellësi me Informatorët kyç

Me 36 informatorë kyç të nivelit lokal dhe 10 të nivelit kombëtar u kryen intervista gjysmë të strukturuar, të bazuara në problemet kyçe të studimit dhe strategjitë e identifikuara nëpërmjet pyetësorëve të mbyllur. Puna e të gjithë informatorëve kyç ishte e lidhur drejtëpërdrejt ose tërthorazi me fëmijët në situatë rruge (Shih Shtojcën 5).

Informatorët kyç ishin përfaqësues të institucioneve publike dhe qeveritare, duke përfshirë Ministrinë e Punëve të Brendshme, Ministrinë e Arsimit, MMSR - në, Agjencinë Shtetërore për Mbrojtjen e të drejtave të Fëmijëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë - Seksioni i mbrojtjes së Fëmijëve dhe i dhunës në familje, Shërbimi Social Shtetëror, Zyrën e Koordinatorit Kombëtar të Luftës kundër – Trafikimit të Personave si dhe organizata të shoqërisë civile. Hyrjes sipas rëndësisë. (Shih Shtojcën 6).

II.1.7 Intervistat ballë për ballë me fëmijët

Qëllimi i kësaj faze ishte sigurimi i një kuptueshmërie më të thellë të situatës së fëmijëve në situatë rruge, të kontribuohet për profilet e fëmijëve në situatë rruge dhe të identifikonte çështje të mëtejshme kyçe për studimin. Për më tepër, ajo do të formonte themelin për rastet e studimit. Të gjithë aktorët kyç të përfshirë në studim u konsultuan mbi draftin e pyetjeve të intervistës fillestare. Kjo u bë për shkak të njohurive të tyre në punën me fëmijët në situatë rruge dhe sepse ata mund ta bënë procesin e intervistës më të lehtë nëpërmjet marrëdhënies së tyre të besimit me fëmijët e cila do të mungonte në fillim dhe duhej të ndërtohej. Përfshirja e tyre siguroi mbledhjen e informacionit të saktë.

Intervista përfundimtare përfshinte 50 pyetjet që mbulonin të gjitha çështjet kyçe të studimit (Shih Shtojcën 7).

Fëmijët e përfshirë në procesin e intervistimit u përshinë gjithashtu në diskutimet në fokus-grupe dhe u përzgjedhën nga specialistët (ARSIS). Kjo përzgjedhje paraprake u bë për të siguruar se në këtë fazë intervistimi do të përshihej kampioni më përfaqësues i fëmijëve në situatë rruge. Intervistat gjysmë të strukturuar me një kampion prej 30 fëmijësh nga i gjithë vendi ndihmuan për një analizë më të thellë të situatave të jetës të fëmijëve (shih Pasqyrën 4).

Format e pëlqimit për fëmijët pjesëmarrës/të intervistuar dhe prindërit ose kujdestarët e fëmijëve pjesëmarrës u përgatitën në përputhje me format e organizatës drejtuese. Udhëzimet etike u ndanë me studiuesit në formën e një liste kontrolli për t'u siguruar se kushtet në të cilat ata punojnë, veçanërisht mënyra e punës me fëmijët, u respektuan që në fillim. Studiuesit e trajnuar ndoqën politikën e organizatës drejtuese për mbrojtjen e fëmijëve. Të gjithë pjesëmarrësit u informuan (verbalisht dhe me shkrim) mbi qëllimin e studimit dhe udhëzimet etike që studiuesit do të ndiqnin në mbledhjen e dhe shqyrtimin e të dhënave.

Paketa Statistikore për Shkencëtarët Socialë 8.0 (SPSS 8.0) u përdor në gjenerimin e shpërndarjes së frekuencës, kombinimin e tabulimeve, mjetet dhe disa analiza faktorësh.

Tabela 6: Kampion i fëmijëve në situatë rruge – të intervistuar

Qyteti	Shpeshhtësia	Përqindja
Durrës	1	3.1 %
Elbasan	2	6.6 %
Gjirokastrë	1	3.4 %
Korçë	2	6.6 %
Sarandë	3	10.0 %
Shkodër	3	10.0 %
Tiranë	18	60.0 %
Gjithsej	30	100 %

II.1.8 Tryezat teknike

Tryezat teknike u kryen gjatë muajit tetor 2013 në tre qytete: Shkodër, Tiranë dhe Fier (shih Pasqyrën 7). Organizata e cila drejtohe studimin (ARSIS) bashkëpunoi ngushtë me partnerët vendorë (përfaqësues të bashkive përkatëse) për të siguruar një qasje përfshirëse dhe një nivel të lartë pjesëmarrjeje të aktorëve të ndryshëm të përfshirë në punën me fëmijët në situatë rruge. Tryezat teknike bashkuan përfaqësues të NjMF-ve, OJQ-ve dhe institucioneve të tjera të tillë si përfaqësues të strukturave të zbatimit të ligjit, Drejtoritë Arsimore Rajonale, shërbimeve sociale etj.

Qëllimi i tryezave teknike ishte të mblidhte të dhënat e nevojshme nga informatorët kyç të cilët merren drejtpërdrejt ose tërthorazi me fëmijët në situatë rruge. Kjo përfshiu diskutimin e përkufizimit të fëmijëve në situatë rruge, analizimin e sistemit, ndarjen e eksperiencave të menaxhimit të rastit për shërbimet e tyre si dhe rolin e çdo aktori në sistem për të përkrahur më mirë nevojat e fëmijëve në situatë rruge.

Tabela 7: Përshkrime të tryezave teknike

Nr.	Tryeza Teknike/Qytet	Data	Nr. i pjesëmarrësve	Vendi
1	Fier	16.10.2013	20	Salla e mbledhjeve në Bashki
2	Shkodër	24.10.2013	8	Hotel "Palma"
3	Tiranë	25.10.2013	15	Salla e mbledhjeve UNICEF

II.1.9 Tryeza e rumbullakët

Në janar të vitit 2014 u organizuar një tryezë e rumbullakët me informatorët kyç dhe përfaqësuesit institucionalë. Tavolina e rumbullakët u krijoi personave të përfshirë në analizën cilësore një mundësi për të pasur një vështrim të përgjithshme të informacionit të përftuar deri në atë fazë si dhe një mundësi për të plotësuar profilet përfundimtare të fëmijëve në situatë rruge, çështjet kryesore për t'u adresuar dhe hartimin e rekomandimeve të orientuara drejt veprimit.

II.2 Treguesit e kampioneve të anketimit

Për të mbledhur të dhënat e këtij studimi për fëmijët në situatë rruge u përdor intervista ballë për ballë. Kjo ishte metoda parësore e mbledhjeve të të dhënave për arsyet në vijim:

- Fëmijët ishin kryesisht analfabetë dhe për këtë arsye nuk kishin mundësi të lexonin dhe t'u përgjigjeshin pyetjeve me shkrim;

- Duke përdorur këtë metodë ishte më e lehtë t'iu shpjegohej fëmijëve kuptimi i intervistave dhe shpjegimi i çdo keqkuptimi që mund të lindte;
- Ishte më e lehtë të kontrollohej procesi në tërësi dhe mjedisi në të cilin bëheshin pyetjet dhe përgjigjet, duke u dhënë kështu fëmijëve më shumë hapësirë për të qenë spontanë. Ishte gjithashtu e mundur të mbaheshin shënime mbi reagimet e ndryshme të fëmijëve gjatë procesit të intervistimit; dhe
- Rendi i pyetjeve të intervistës është veçanërisht i rëndësishëm në krahasim me një pyetësor dhe mundëson krijimin e një afati kohor për secilin fëmijë.

Për mbledhjen e të dhënave të kampionit u përdor qasja e vëzhgimit të kritereve të profilit. Për këtë studim u krijua një tufë treguesish për profilet e fëmijëve në situatë rruge dhe punën në terren të kryer për vëzhgimin dhe mbledhjen e të dhënave për fëmijë të cilat përputhen me treguesit e përcaktuar (Shih Shtojcën B).

Në vijim gjenden treguesit e përcaktuar të cilët u ndanë me personat që kryen vëzhgimin në rrugë për të identifikuar fëmijët në një situatë rruge:

Karakteristikat fizike:

- Pa këpucë,
- Rroba të ndotura apo të grisura,
- Rroba të papërshtatshme për përmasat e fëmijës apo për periudhën e vitit/stinën,
- Pamje e pisët, e pashëndetshme apo e vrarë, p.sh. vraga në fytyrë apo trup, mungesë dhëmbësh, kokë të rruar.

Sjellja

- Një grup fëmijësh në një vend të papërshtatshëm,
- Një fëmijë i cili është vetëm ose me prindërit e tij/saj dhe është angazhuar në aktivitete të zakonshme për fëmijët në situatë rruge, p.sh. lypja, shitja e artikujve, mbledhja e materialeve të riciklimit, angazhimi në punë fizike si larja e makinave ose kërkimi në plehra etj.
- Lojërat në vende të papërshtatshme,
- Angazhimi në sjellje kundër - shoqërore të tilla si zëniet, sharjet, të qenit këmbëngulës dhe të bezdisshëm me të huajt,
- Fjetja në rrugë apo jashtë,
- Një fëmijë që shfaq shenja të abuzimit me alkool ose drogë.

Përtej përjasjes së shprehur më lart për identifikimin e fëmijëve në situatë rruge, ekipi i studimit ishte në gjendje të përshtatej me realitetet dhe çështjet e reja të cilat shfaqeshin gjatë kryerjes së studimit. Për shembull kur një fëmijë apo një grup fëmijësh nuk dëshironin të përfshiheshin, apo kur ata refuzonin të përfshiheshin nëse shokët e tyre nuk përfshiheshin. Kampionimi duhet të përshtatej sipas përvojës specifike të punës në terren. Fazat e mëparshme (Hartëzimi i Vendndodhjes sipas Kohës dhe Procesit të Numërimit) ndihmuan në realizimin e këtij procesi.

II.3 Kufizimet dhe sfidat e studimit

Gjatë zbatimit të projektit të studimit u vërejtën kufizimet dhe sfidat e mëposhtme:

- Analiza empirike e fenomenit të fëmijëve në situatë rruge në Shqipëri u ndikua nga ngjarjet politike të cilat drejtojnë politikat dhe veprimet në të gjitha nivelet e qeverisjes gjatë verës. Për shembull, studimi ishte programuar në kohën e duhur për të mbështetur reformën

e sistemit të kujdesit social në Shqipëri. Megjithatë duket se njëkohësisht ky studim u ndërmor shumë herët për të siguruar veprim dhe ndryshim të menjëhershëm të praktikave të tanishme. Ndikimi i studimit do të jetë një sfidë për shkak të kuadrit aktual të ndryshimeve në Shqipëri, për shembull ndikimi i iniciativave të fundit të politikave si krijimi i NjMF - ve ka ende të nevojë të vlerësohet plotësisht.

- Numërimi i dyfishtë në të dy Proceset e Numërimit ishte një sfidë për shkak të lëvizshmërisë së fëmijëve gjatë momenteve të ndryshme të ditës dhe natës si dhe periudhës së vitit/stinëve.
- Gjatë dy viteve të fundit për fëmijët në situatë rruge janë kryer disa studime dhe ishte një sfidë sigurimi i pjesëmarrjes së disa fëmijëve pasi ata po intervistoheshin përsëri pa parë asnjë rezultat nga pjesëmarrja e tyre në studimet e mëparshme.
- Në disa qytete, për studiuesit ishte e vështirë të krijonin një marrëdhënie besimi me fëmijët në një afat kohor të shkurtër, veçanërisht nëse në këto vende nuk kishte asnjë shërbim për fëmijët në situatë rruge. Si rezultat, disa fëmijë refuzuan të intervistoheshin. Profesionistët e përfshirë në Fazat e para të studimit i tejkaluan këto sfida dhe mundën të mblidhnin të dhëna të rëndësishme. Ata ishin të aftë të ftonin fëmijët lirshëm dhe t'i ofronin atyre informacionin e përshtatshëm për moshën, për çfarë ishte ky studim, si do të shpërndahej, dhe si do të ruheshin të dhënat e tyre.
- Nga përvoja në terren e ofruesve të shërbimeve të përfshirë në këtë studim, për arsye të ndryshme fëmijët nuk thonë gjithmonë të vërtetën në disa situata të caktuara, veçanërisht kur nuk është ndërtuar një marrëdhënie besimi.
- Pas disa diskutimeve, ekipi vendosi se në studim do të përfshiheshin vetëm fëmijët të cilët ishin fizikisht në rrugë dhe të cilët plotësuan kriteret e vëzhgimit të përmendura më sipër.

Fëmijë në vendbanimin Rom tek Liqeni Artificial Tiranë, Shkurt 2014 (foto Mersina Xhemajli)



Fëmijët të cilët dukej se po punonin brenda vendeve të tilla si bare, kafene, restorante, apo ishin në institucione të kujdesit rezidencial në kohën e numërimit, do të përjashtoheshin nga studimi pasi nuk ishte e mundur të përcaktohej me siguri nëse këta fëmijë ishin në një situatë rruge jashtë momentit të vëzhgimit, duke siguruar kështu një objektivitet të plotë.

Kreu III. Rezultatet e studimit

III.1 Shifrat

Ndërkohë që në disa rrethana mund të konsiderohet e rrezikshme të fokusohesh në shifra²⁷ dhe jo në faktorët e ndryshëm të rrezikut dhe abuzimet me të drejtat e fëmijëve që ndodhin për shkak të situatës së rrugës, shtysa e këtij studimi të gjerë ishte nevoja për shifra, e njohur nga UNICEF dhe Save the Children, për të informuar dhe planifikuar më mirë ndërhyrjet sociale. Zgjerimi i përkufizimit të fëmijëve në situatë rruge, së bashku me të dhënat cilësore, pritet të ndihmojë në hartimin dhe zbatimin më të mirë të ndërhyrjes në politikë-bërje, kuadrin ligjor dhe asaj praktike. Ndërkohë që më parë janë ndërmarrë disa përllogaritje mbi numrin e fëmijëve të lidhur me rrugën në Tiranë, gjithashtu mbështetur në rastet që shohin OJFtë kryesore të cilat punojnë këtu, kjo sigurisht mund të përmirësohet me mbledhjen e strukturuar të të dhënave dhe përfshirjen e aktorëve kyç. Ekzistojnë mangësi të mëdha në të dhënat zyrtare nga të gjithë institucionet përgjegjëse për punën me fëmijët në situatë rruge në Shqipëri.

Siç u përmend më parë, procesi i numërimit u krye në dy periudha të ndryshme kohore për të për të ofruar një vlerësim më të saktë të numrit të fëmijëve në situatë rruge. Faza e parë e Procesit të Numërimit u krye në verën e vitit 2013; Faza e dytë në vjeshtën e vitit 2013. Tabela 8 (më poshtë) tregon numrin e fëmijëve të identifikuar në të gjithë vendin (sipas qyteteve) gjatë fazës së parë të Procesit të Numërimit të fëmijëve në situatë rruge, gjithsej 2,014 fëmijë. Tabela 9 tregon numrin e fëmijëve të identifikuar në të gjithë vendin (sipas qarqeve) gjatë fazës së dytë të Procesit të Numërimit të fëmijëve në situatë rruge. Gjithsej numri i fëmijëve në situatë rruge në shkallë republike në të dy fazat ishte 2,527.

Tabela 8: Numri i fëmijëve në situatë rruge - Faza 1

Fëmijë në situatë rruge për qytet	Shpeshësia	Përqindja
Tiranë	636	31.5 %
Durrës	375	18.6 %
Vlorë	88	4.4 %
Shkodër	213	10.6 %
Elbasan	69	3.4 %
Pogradec	52	2.6 %
Sarandë	161	8.1 %
Dibër	217	10.7 %
Kavajë	203	10.1 %
Gjithsej	2,014	100 %

27 Sarah Thomas de Benitez, Raport mbi Gjendjen e Fëmijëve në Situata Rruge në Botë: Studim, Publikuar nga Great Britain, 2011, në fq. 5

Tabela 9: Numri i fëmijëve në Situatë Rruge - Faza 2

Fëmijë në situatë rruge për çdo Qark të Shqipërisë	Shpeshësia	Përqindja
Tiranë	757	30 %
Durrës	205	8.1 %
Vlorë	118	4.7 %
Fier	113	4.5 %
Shkodër	335	13.2 %
Lezhë	93	3.7 %
Elbasan	142	5.6 %
Korçë	149	5.9 %
Dibër	160	6.3 %
Kukës	5	0.2 %
Gjirokastrë	359	14.2 %
Berat	91	3.6 %
Gjithsej	2,527	100 %

Procesi i Numërimit në të dy fazat tregon se kryeqyteti i Shqipërisë ka numrin më të madh të fëmijëve në situatë rruge, pavarësisht periudhës së vitit, duke pasur pothuajse një të tretën e shifrës së përgjithshme. Ndryshimet në shifrat e qyteteve të tjera ndërmjet dy fazave kanë arsye më të vecanta të cilat do të shtjellohen më tej.


III.2 Të dhëna demografike

Shumica e fëmijëve në situatë rruge në Shqipëri nuk kanë arritur moshën 14 vjeçare, megjithëse ka një pjesë të konsiderueshme të adoleshentëve në situatë rruge të cilët janë të moshës 15-17 vjeç (28% - 564 e fëmijëve në fazën 1; 31% - 783 e fëmijëve në fazën 2). Për shumicën e tyre përvoja e rrugës nis rreth fëmijërisë së hershme. Intervista fillestare, numërimi dhe rezultatet e fokus-grupeve tregojnë se një numër i konsiderueshëm fëmijësh të moshës 0-5 vjeç (Faza 1- 11.66%, 235 fëmijë - Faza 2- 13.9%, 381 fëmijë) janë në rrugë të shoqëruar nga nënat e tyre gjatë lypjes.

III.2.1 Gjinia


Ndërmjet fëmijëve në situatë rruge në Shqipëri, numri i djemve është më shumë se dyfish i numrit të vajzave (70.1% - 1476 djem dhe 29.9% - 538 vajza nga 2014 fëmijë në Fazën 1; 74% - 1882 djem dhe 26% - 645 vajza nga 2527 fëmijë në Fazën 2) dhe tendenca rritet edhe më tek adoleshentët (10 deri në 18 vjeç). Tirana ka përqindjen më të lartë të vajzave nga numri i përgjithshëm (35.5% në Fazën 1) krahasuar me pjesën e vajzave në qytete të tjera (~23%); gjithsesi djemtë mbizotërojnë në situatën e rrugës në të gjithë vendin.

Gjinia e fëmijëve në situatë rruge sipas qyteteve | Faza 1



Grafiku 1. Gjinia e fëmijëve në situatë rruge sipas qyteteve | Faza 1

Gjinia e fëmijëve në situatë rruge sipas qyteteve | Faza 2



Grafiku 2. Gjinia e fëmijëve në situatë rruge sipas qyteteve | Faza 2

Për këtë tendencë, të konfirmuar gjatë grupeve të fokusit me fëmijët dhe anëtarët e komunitetit, ekziston një shpjegim i cili i ka rrënjët në diferencimin kulturor ndërmjet roleve të meshkujve dhe femrave në Shqipëri. Sipas këtyre roleve, vajzat priten të angazhohen në punët e shtëpisë më shumë se djemtë, veçanërisht në familjet ku kryefamiljarja është femër. Për djemtë, shpenzimi i kohës jashtë shtëpisë me bashkëmoshatarët e tyre nuk perceptohet si diçka negative, ndërkohë që për vajzat zakonisht nuk është e pranueshme që ato të shpenzojnë shumë kohë vetëm në rrugë. Ekziston rreziku që vajzat të kenë më pak gjasa për të përfituruar përkrahje pasi ato janë më pak të dukshme se sa djemtë në rrugë, por kanë gjasa të përballen me të njëjtat vështirësi.

Për më tepër, vajzat në pubertetin e hershëm (12-14 vjeç), koha kur fillon cikli menstrual, kanë më shumë gjasa të mbahen në shtëpi, gati për martesë. Virgjëria, si një "virtut" për vajzat përpara martesë, është një traditë e vjetër historike dhe kulturore për komunitetet Egjiptiane dhe Rome, siç u vu në pah edhe nga vetë anëtarët e komunitetit gjatë fokus grupeve dhe u konfirmua nga aktorët kyç.


Numri i vajzave në situatë rruge ulet ndërkohë që ato rriten, ku shumica e tyre janë të moshës ndërmjet 5 dhe 9 vjeç. Kjo konfirmon pjesërisht ndikimin e rritjes së përgjegjësive në shtëpi dhe rreziqeve "morale" të perceptuara ose faktike në rrugë, duke hequr më shumë vajza nga rrugët ndërkohë që ato rriten. Në fakt, aktorët kyç theksuan gjatë intervistave të thelluara se djemtë kanë

gjasa të shpenzojnë më shumë kohë sesa vajzat në rrugë, ka mundësi dhe për shkak të kuptimit tradicional ku mashkulli shqiptar pritet të jetë një mbështetje për veten dhe/ose familjen e tij, gjë që bën që djemtë më të rritur të kenë më shumë gjasa të kërkojnë strategji mbijetese jashtë shtëpisë.

III.2.2 Grupmoshat

Procesi i numërimit në të dy fazat tregon se rreth 66.5% (1680) e fëmijëve në situatë rruge në Shqipëri janë të moshës ndërmjet 4 dhe 14 vjeç, ku përqindja e mbetur shpërndahet ndërmjet foshnjave dhe të miturve (0 deri në 3 vjeç - rreth 4% ose 102 fëmijë) dhe adoleshentëve (15 deri në 17 vjeç – 29.5% ose 745 fëmijë).

Më shumë detaje mbi numrin e fëmijëve të numëruar (në të dy Fazat) në çdo qytet/rajon specifik të Shqipërisë mund të gjenden në Shtojcën E.





Grafiku 3. Grupmoshat e fëmijëve në situatë rruge | Fazat 1 dhe 2

Prania e foshnjave dhe të miturve në situatë rruge duhet parë në një këndvështrim tjetër, pasi këta fëmijë kaq të vegjël nuk kanë asnjë mundësi të ndikojnë në zgjedhjet e nënave të tyre për strategjitë e mbijetesës, si dhe nuk kanë aftësi për të zhvilluar të tyret. Si rezultat, fokusi duhet të jetë tek “nënat në situatë rruge me foshnjat e tyre” dhe jo vetëm mbi vetë fëmijët. Të dhënat e përfytyruara nga përvoja në terren sugjerojnë se në shumë raste, ne tashmë shohim një brez të tretë të fëmijëve në situatë rruge në Shqipëri – disa nga këto nëna të reja kanë përjetuar vetë një jetë të lidhur me rrugën.

Fëmijë duke lypur në rrugët e Tiranës, Nëntor 2013 (foto Gazmir Lame)







Grafiku 4. Grup moshat e fëmijëve në situatë rruge | Fazat 1 dhe 2

Intervistat fillestare pasqyruan një pamje të ngjashme të shpërndarjes gjinore ndërmjet fëmijëve në situatë rruge. Gjatë fazës së parë, nga 2014 fëmijë të numëruar, u intervistuan 442 fëmijë; 66% të cilëve janë djem (n=293) dhe 34% vajza (n=149). Gjatë fazës së dytë, nga 2527 fëmijë të numëruar, 71% ishin djem (n=241) dhe 29% vajza (n=99).

Intervista fillestare dhe ato të thelluara me fëmijët tregojnë se në moshën 6 vjeç, ka paksa më shumë vajza sesa djem në një situatë rruge në Shqipëri (20 vajza - 13 djem). Fëmijët e moshave 13 -14 vjeç (139 fëmijë nga 782) janë grupi që është numëruar më shpesh në situatë rruge nga intervistat fillestare. Prania e vajzave të moshës 11-17 vjeç në situatë rruge është më e ulët (343 djem – 114 vajza) dhe arsyet janë të përmendura më sipër.



Grafiku 5. Moshë e Fëmijëve | Djem | Intervista Fillestare | Fazat 1&2



Grafiku 6. Moshë e Fëmijëve | Vajza | Intervista Fillestare | Fazat 1&2



Fëmijët në situatë rruge ndërmjet moshës 0-1 vjeç gjenden kryesisht në Tiranë, duke formuar 7% të numrit total të fëmijëve në situatë rruge në këtë qytet. Në të gjitha qytetet, shumica e fëmijëve në situatë rruge është e moshave 5-14 vjeç. Adoleshentët e moshave nga 15 në 17 vjeç përbëjnë 3%-20% të fëmijëve në situatë rruge brenda Tiranës.

III.2.3 Përkatësia etnike

Në intervistat fillestare fëmijët deklaruan vetë se i përkasinin njërit nga tre grupeve të ndryshme të shoqërisë shqiptare. Ndërkohë që në të kaluarën fëmijët në situatë rruge janë kategorizuar nga të dhënat e projektit të bazuar në terren se i përkasin dy komuniteteve të vecanta, Romëve dhe Egjiptianëve,²⁸ ky studim zbuloi se ka edhe një numër të konsiderueshëm të fëmijëve nga shumica e popullsisë shqiptare²⁹ në situatë rruge. Në fakt, fëmijët nga shumica shqiptare përbëjnë ndërmjet një të katërtës (Faza 1) dhe një të tretës (Faza 2) të numrit të përgjithshëm të fëmijëve të numëruar.

28 Egjiptianët e Ballkanit (Jevgë, Egjiptianë apo Gjupci) janë pakica etnike të cilat flasin shqip (komunitete të njohura).
 29 Në këtë studim shumica shqiptare, Romët dhe Egjiptianët do të konsiderohen si grupe etnike megjithëse Romët konsiderohen si një minoritet gjuhësor (jo një minoritet kombëtar dhe Egjiptianët nuk njihen as një minoritet kombëtar as gjuhësor).

Për më tepër, megjithëse fëmijët në situatë rruge janë pjesë e këtyre tre komuniteteve kryesore të shoqërisë shqiptare, nga procesi i intervistave fillestare 74.3% (581 nga 782 fëmijë) e fëmijëve në situatë rruge u përgjigjën se ata i përkisnin komuniteteve Rome dhe Egjiptiane. Kjo theksohet gjithashtu fort edhe nga intervista e thelluara me aktorët kyç dhe të gjithë ekspertët përmendën se burimet kryesore të fëmijëve në situatë rruge janë nga këto dy komunitete.



Grafiku 7. Përkatësia etnike e fëmijëve në situatë rruge | Intervista Fillestare Fazat 1&2


Kur gjatë intervistave të thelluara aktorët kyç u ftuan të konsideronin nëse përmasat e komunitetit kishin një ndikim në numrin e fëmijëve të gjetur në situatë rruge, ata raportuan për përpjesëtime të ndryshme të komuniteteve në qytete të ndryshme. Në Tiranë nuk ka ndonjë ndryshim të rëndësishëm në përmasat e komuniteteve Rome apo Egjiptiane dhe kjo pasqyrohet në numrin e fëmijëve në situatë rruge, i cili është thujtë i barabartë. Duke qenë se në Tiranë Romët dhe Egjiptianët kanë prirjen të jetojnë në të njëjtat zona, ka mjaft familje të përziera Rome - Egjiptiane dhe aktorët kyç raportuan se disa fëmijë në situatë rruge kanë një origjinë të përzierë, megjithëse fëmijët përpiqen të identifikohen me një origjinë ose tjetrën.

Megjithatë, në Korçë komuniteti Egjiptian është më i madh se komuniteti Rom, prandaj fëmijët në situatë rruge janë kryesisht nga ky komunitet. Gjithashtu, bazuar në punën e tyre të përditshme

dhe përvojën profesionale, aktorët kyç deklaruan se në Elbasan dhe në Shkodër të dy komunitetet Egjiptiane dhe Rome jetojnë në gjendje të vështirë ekonomike dhe fëmijët e tyre janë në situatë rruge. Në Gjirokastrë dhe Sarandë, shumica e fëmijëve në situatë rruge janë gjithashtu nga komuniteti Egjiptian. Në të gjithë qytetet të gjithë aktorët kyç deklaruan se fëmijët në situatë rruge janë gjithashtu nga një pjesë e komunitetit të shumicës shqiptare.


Ndërkohë që në përgjithësi fëmijët në situatë rruge janë kryesisht djem, shpërndarja gjinore ndërmjet komuniteteve nuk është e barabartë. Nga komuniteti Rom ka më shumë vajza në situatë rruge krahasuar me dy të tjerët, dhe vajzat nga komuniteti i shumicës shqiptare janë në një përqindja relativisht të vogël.

Përkatësia etnike e fëmijëve në situatë rruge sipas gjinisë | Intervista fillestare | Fazat 1&2




Grafiku 8. Përkatësia etnike e fëmijëve në situatë rruge sipas gjinisë | Intervista fillestare Fazat 1&2

Përkatësia etnike e fëmijëve në situatë rruge sipas qyteteve | Faza 1



Grafiku 9. Përkatësia etnike e fëmijëve në situatë rruge sipas qyteteve | Faza 1




Grafiku 10. Përkatësia etnike e fëmijëve në situatë rruge sipas qyteteve | Faza 2

Fëmijët në situatë rruge janë të shpërndarë gjerësisht në nivel kombëtar; megjithatë shumica e tyre janë të përqendruar në qytete të ndryshme. Në Tiranë fëmijët në situatë rruge janë kryesisht nga komunitetet rome dhe egjiptiane. Ky fakt theksohet gjithashtu nga të gjithë aktorët kyç në intervistat e thelluara. Në Tiranë, fëmijët në situatë rruge gjenden në zonat e Kinostudios, Babrrusë, Bregut të Lumit, Qytetit të Nxënësve.

Në Durrës, shumica e fëmijëve në situatë rruge janë nga komuniteti rom. Familjet e fëmijëve në situatë rruge nga komuniteti i shumicës shqiptare kanë migruar gjatë periudhës 1995 – 2000 nga qytetet veriore në Shqipëri dhe janë të vendosur në zonën e Porto Romanos. Në Dibër, fëmijët në situatë rruge janë kryesisht nga komuniteti i shumicës shqiptare.


Në Kavajë, fëmijët në situatë rruge janë kryesisht nga komuniteti egjiptian, ndërkohë që në Fushë - Krujë ata janë kryesisht nga komuniteti Rom.

Përkatësia etnike e fëmijëve në situatë rruge sipas moshës | Intervista fillestare | Faza 1



Grafiku 11. Përkatësia etnike e fëmijëve në situatë rruge sipas moshës | Intervista fillestare Faza 1

Përkatësia etnike e fëmijëve në situatë rruge sipas moshës | Intervista fillestare | Faza 2



Grafiku 12. Përkatësia etnike e fëmijëve në situatë rruge sipas moshës | Intervista fillestare Faza 2

78% (114 fëmijë nga 146) të fëmijëve 6 vjeçarë në situatë rruge janë nga komuniteti Rom, ndërkohë që komuniteti i shumicës shqiptare ka kryesisht fëmijë të moshës nga 7 në 17 vjeç në situatë rruge, duke përbërë 28.4 % (207 nga 739 fëmijë).

Në përgjithësi shifrat e studimit konfirmuan se përqindja e fëmijëve në situatë rruge nga komunitetet e ndryshme nuk është në përspjetim të drejtë me përkatësinë e këtyre komuniteteve në popullsinë e përgjithëshme. Mbështetur në përgjigjet nga intervistat fillestare, një e katërta e fëmijëve të identifikuar i përkasinin shumicës shqiptare, ndërkohë që 74.3% (581 nga 782 fëmijë) i përkasinin


komuniteteve rome dhe egjiptiane. Këto to dhëna kanë një rëndësi të dyfishtë: së pari, numri i fëmijëve të shumicë shqiptare në situatë rruge është më i lartë sesa pritej dhe së dyti, duke qenë se minoritetet e tjera të grupit gjuhësor përbëjnë jo më shumë se 1% të popullsisë totale të Shqipërisë, ky studim konfirmon se shpeshësia e fëmijëve në situatë rruge nga këto grupe të minoriteteve etnike është mjaft e lartë në mënyrë të zhdrejtë. Aktorët kyç konfirmuan se fëmijët nga familjet në komunitetet më të privuara dhe mënjanuara kanë më shumë gjasa të jenë në situata rruge dhe duke qenë se shumë Romë i përkasin këtyre grupeve të pa-avantazuara, shumë prej fëmijëve të tyre janë në rrezik për të qenë në situata rruge.

III.3 Profilet e fëmijëve në situatë rruge

III.3.1 Aktivitetet e rrugës

Fëmijët në situatë rruge në Shqipëri identifikohen kryesisht si “fëmijë që punojnë”, ku të gjitha fazat e studimit tregojnë se aktivitetet kryesore në rrugë ishin lypja dhe larja e xhamave të makinës, të ndjekura nga shitja në semaforë, në bare/kafene apo në pika të caktuara në anë të rrugës, ose shitja e shërbimeve të tilla si parkimi, puna si hamall apo riciklimi.

Procesi i numërimit tregon se aktivitetet kryesore në rrugë të fëmijëve në situatë rruge janë:



Grafiku 13: Aktivitetet e fëmijëve në rrugë | Fazat e numërimit 1&2

Duke parë në veçanti rezultatet e fokus grupeve me fëmijë, doli në pah se fëmijët i njihnin dhe i kishin kryer në kohë të caktuar aktivitetet e ndryshme të rrugës. Ata përmendën në veçanti lypjen, larjen e xhamave të makinave, mbledhjen e materialeve të riciklueshme, tregtinë në rrugë dhe punët informale. Shumica e tyre në të gjitha qytetet dhe pa dallim moshe dhe gjinie deklaruan se e dinin se çfarë fitimesh mund të merreshin nga punë të caktuara dhe se në përgjithësi se si bëheshin këto punë. Një fëmijë deklaroi:


"Pra kur punoj, zakonisht dal vetëm dhe më pas i sjell paratë e fituara në shtëpi. Më pas prindërit më japin disa para nëse kanë, 20 lekë apo 50 lekë..."³⁰ (Djalë, Moshë 10, Korçë)

Proceset e Numërimit treguan një ndryshim shumë të madh ndërmjet numrit të fëmijëve të cilët lypin duke u përpjekur të "shesin" artikuj të imët (simbolikë) në rrugë (0.8% në Fazën 1 dhe 0.3% në Fazën 2) dhe ata që u gjendën duke lypur thjesht duke kërkuar para (34.6% në Fazën 1 dhe 20.7% në Fazën 2). Djemtë janë më të përfshirë sesa vajzat në lypje duke u përpjekur të shesin artikuj të imët (simbolike) në rrugë, ndërkohë që vajzat kryesisht thjesht lypin (61% i totalit të vajzave në situatë rruge). Fëmijët e moshës 2-9 vjeç janë kryesisht të përfshirë në lypjen normale, ndërkohë që lypja nëpërmjet shitjes është kryesisht një karakteristikë e fëmijëve të moshave 10-17 vjeç.

Fëmijët e angazhuar në lypje kanë më shumë gjasa të shfaqin shenja të traumave fizike sesa bashkëmoshatarët e tyre të cilët punojnë ose nuk janë të përfshirë në aktivitete të tjera të burimit të të ardhurave në rrugë.

Rast studimor: Familja në këtë rast përbëhet nga një nënë dhe nga 5 fëmijët e saj: djali i saj 14 vjeçar, vajza 12 vjeçare, vajza 10 vjeçare, vajza 3 vjeçare, djali 2 vjeçar dhe një vajzë më e madhe 16 vjeçare e cila është e 'martuar' dhe ka vetë një fëmijë. Babai i katër fëmijëve ka vdekur dhe babai i dy fëmijëve të tjerë është partneri i dytë i nënës. Ai është i papunë dhe nuk ka mundësi të kujdeset për fëmijët. Të ardhurat e vetme të familjes në vite kanë qenë nga lypja e fëmijëve dhe vjedhje të ndryshme të kryera nga fëmijët (të cilët janë dënuar dhe nën vëmendjen e policisë së shtetit). Familja është përballur me shumë probleme pasi fëmijët janë gjithmonë në rrezik trafikimi, neglizhenca dhe shfrytëzimi. Një qendër ditore e ka ndihmuar familjen që nga viti 2008, kur disa nga fëmijët filluan të lypnin në rrugët e Tiranës. Në atë kohë, fëmijët shpenzonin shumë kohë duke lypur dhe "puna" e tyre monitorohej nën tutelën e nënës dhe gjyshes së tyre, e në disa raste edhe nga partnerët e nënës së tyre. Kjo situatë zgjati për vite të tëra dhe kjo ishte arsyeja që qendra ditore e referoi këtë situatë në polici (seksioni e dhunës në familje). Që nga viti 2008 qendra i ka mbështetur fëmijët gjatë ditës nëpërmjet mbështetjes administrative, mjekësore dhe për nevojat themelore. (Fëmër, anëtare komuniteti, Tiranë)

Mbledhja e kanaçeve dhe hekurit është gjithashtu një aktivitet i shpeshtë i fëmijëve. Gjatë fokus grupeve, fëmijët në Tiranë, Durrës dhe Korçë raportuan se ata e bëjnë këtë punë të shoqëruar nga prindërit e tyre. Në shumicën e rasteve ata janë me babanë e tyre, me përjashtim të Durrësit, ku shumica e nënave me fëmijë punojnë së bashku duke ricikluar materiale.



Fëmijë duke larë xhamat e makinave në Tiranë, Shtator 2013 (foto Mersina Xhemajli)

Për shkak të zgjerimit të zonave gjeografike dhe bazuar mbi analizimin e rezultateve të Fazës 1, Faza e dytë e numërimit dhe intervistave fillestare nxori në pah një aktivitet të ri dhe mjaft të rëndësishëm, në të cilin përfshihen fëmijët në situatë rruge. Fëmijët u gjetën duke punuar në fshatin Lazarat pranë qytetit të Gjirokastrës në kultivimin e marijuanës. Nga diskutimet e fokus grupeve me fëmijët dhe anëtarët e komunitetit si dhe

nga intervistat fillestare, ata përmendën në mënyrë spontane faktin se shumë fëmijë që jetojnë në zona të ndryshme të Gjirokastrës punojnë në fshatin Lazarat, duke raportuar se përfitimet financiare janë më të larta krahasuar me aktivitetet e tjera të fëmijëve në situatë rruge. Ndërkohë që fëmijët u vëzhguan dhe raportuan në intervistat fillestare se punonin atje, asnjë nga fëmijët në fokus grupe

nuk e pranoi se punonte atje. Gjithsesi, kjo i dha një shtysë të rëndësishme përqindjes së fëmijëve të përfshirë në punë informale gjatë numërimit të Fazës 2 (Shih Grafikët 14 & 15).

Gjatë fokus grupeve u vu re se shumica e fëmijëve nuk ishin krenarë që punonin dhe ishin të ndërgjegjshëm se aktivitetet që ata bënin nuk perceptoheshin mirë nga pjesa tjetër e shoqërisë.


Një nga fëmijët deklaroi:

“Ne nuk duhet të punojmë në këtë moshë. Por familjet tona kanë nevojë ekonomike për ne. Atyre u nevojitet ndihmë. Kështu që duhet t’i ndihmojmë ata. Disa nga këta prindër mund të pinë ose të grinden dhe torturojnë fëmijët.” (Djalë, 12 vjeç, Tiranë)


Ndërkohë që nga Procesi i Numërimit rezultoi se 60% e vajzave dhe 24% e djemve lypin, gjatë fokus grupeve shumica e tyre refuzoi të pranonte se lypnin pasi ata e perceptojnë këtë aktivitet si aktivitetin më degradues, të turpshëm dhe çnderues krahasuar me aktivitetet e tjera të lidhura me rrugën. Fëmijët e moshës 10-17 vjeç të cilët aktualisht shesin mbledhjen e kanaçeve apo metalit, nuk e përmendin lypjen si një nga punët e tyre gjatë fëmijërisë së hershme.

Shumica e fëmijëve që lypin janë nga komunitetet Rome dhe Egjiptiane, ndërkohë që fëmijët e shumicës shqiptare janë të përfshirë në shitjen e artikujve të imët. Gjatë dy Fazave ka një diferencë të madhe ndërmjet shifrave për fëmijët e shumicës shqiptar të përfshirë në punë informale dhe shitjen e artikujve: shitja e artikujve - në Fazën 1 ishte 79.8% (624 fëmijë), ndërsa në Fazën 2 u bë 22.9% (179 fëmijë); puna informale - në Fazën 1 ishte 16.5% (129 fëmijë), në Fazën 2 u bë 73.4% (547 fëmijë). Kjo diferencë në shifra dhe në ndryshimin e aktivitetëve vjen si pasojë e ndikimit të stinës në këto lloj aktivitetesh në rrugë. Në zonat turistike në verë ka një kërkesë të lartë për disa artikuj nga turistët dhe meqenëse shkollat kanë pushimet verore, numri i fëmijëve të përfshirë në shitje rritet. Në tetor shkollat janë të hapura dhe nuk ka shumë turizëm, kështu që fëmijët janë më të përfshirë në punë informale.

Gjatë procesit të numërimit të fëmijëve të përfshirë në punë informale u identifikuan dy zona problematike: Miniera e Bulqizës dhe Gjirokastra, kultivimi i marijuanës në Lazarat. Intervistat e thelluara kanë të bëjnë me fëmijë të cilët punonin në minierën e Bulqizës, ku ata mbledhin metal dhe e shesin atë për shuma të vogla parash në mënyrë që të mbështesin veten dhe familjet e tyre.



Grafiku 14: Aktivitetet e rrugës sipas përkatësisë etnike | Intervista fillestare Faza 1



Grafiku 15: Aktivitetet e rrugës sipas përkatësisë etnike | Intervista fillestare Faza 2

Mbledhja dhe shitja e kanaçeve nga fëmijët konsiderohet si puna më e ndershme, për shkak të punës së madhe dhe shitjes së asaj çfarë ata kanë mundur të mbledhin. 42% e djemve janë të përfshirë në aktivitetet e shitjes dhe 9% në mbledhjen e kanaceve.

Adoleshentët, fëmijët e braktisur apo të neglizhuar dhe ata që janë larguar nga shtëpia janë ata më në rrezik për të siguruar jetesën nëpërmjet mjeteve të paligjshme. Ata angazhohen në aktivitete të paligjshme të tilla si transportimi i drogës, shitja apo transportimi i objekteve/materialeve të kontrabanduara dhe vjedhja. Fëmijët nuk parapëlqejnë të konfirmojnë përfshirjen e tyre në këto aktivitete të paligjshme dhe shpesh ata i referohen një personi të tretë në vend të vetes kur përshkruajnë këtë lloj fenomeni. Për më tepër statistikat zyrtare mungojnë. Sipas Seksionit për Mbrojtjen e të Miturve dhe Dhunës në Familje në Drejtorinë e Policisë në Tiranë, fëmijët e përfshirë në aktivitete të paligjshme janë kryesisht djem të moshës 8-13 vjeç, në shumicën e rasteve nga komuniteti rom dhe kryesisht të angazhuar në vjedhje.

Fëmijët deklaruan se prindërit e tyre i mësojnë se si të kryejnë aktivitete të cilat sjellin të ardhura në rrugë, megjithëse disa prej tyre, të cilët nuk u ndjenë rehat të diskutonin mbi prindërit e tyre, raportuan se kanë mësuar vetë apo nga shokët. Këto fëmijë ngrenë duart lart dhe lypin.

“Për shembull, nëna e tyre i detyroi të dilnin atje.” (Vajzë, 8 vjeç, Tiranë)

Të gjithë fëmijët në situatë rruge shpjeguan se të gjitha aktivitetet që ata bëjnë janë mjaftë të lodhshme, të rrezikshme për ta, motrat dhe vëllezërit e tyre dhe të pasigurta për shëndetin. Për më



Fëmijë duke punuar me riciklim në Tiranë, Shkurt 2014 (foto ARSIS)

tepër, fëmijët thanë se ata kanë hasur dhunë psikologjike nga njerëzit kur lypin apo shesin dhe disa përmendën edhe dhunën fizike.

Edhe pse shumica e tyre ndiejnë diskriminim nga pjesa tjetër e shoqërisë dhe kanë ndjenja negative si trishtimi dhe palumturia, të gjithë përmendën se ata punojnë pasi familja e tyre është në varfëri të skajshme. Të gjithë fëmijët thanë se të gjitha përfitimet nga aktivitetet e rrugës janë për familjen e tyre, duke u dhënë mundësi pjesëtarëve të familjes të ushqehen.

Më poshtë paraqitet një pasqyrë me llojet e aktiviteteve fitimprurëse të kryera nga shumica e fëmijëve në situatë rruge në vende të ndryshme,³¹ ku theksohen (Bold) ato veprimtari të cilat nga studimi ynë shfaqen si më të përhapurat për fëmijët në Shqipëri.

Tabela 10: Aktivitete të fëmijëve në situatë rruge

Instrumente loje	Shpërndarja e postës
Shitje lodrash fosforeshente	Akrimi si një person i paaftë për të lypur
Mbledhje e plastikës, kartonit dhe metaleve	Performancë teatri
Riciklimi	Shitja e artit të bërë vetë
Larja e makinave	Shitja e artikujve fetarë
Larja e dritareve	Shitja e kafshëve të vogla (pëllumba, lepuj)
Lypja	Shitja e luleve në/për varreza
Shitja e cigareve dhe artikujve të tjerë të imët	Vjedhja
Shpërndarja e broshurave	Tregtia e drogës
Shitja e farave të lulediellit, misrave	Ruajtja e makinave
Shitja e gazetave	Puna në fabrika
Parkimi i makinave	Puna në industrinë e turizmit
Shitja e qymyrit	Peshkimi
Transportimi i plehrave	Përkujdesja për vëllezër/motra
Puna seksuale	Punë shtëpiake
Puna në tregje	Puna në sheshin e plehrave
Kumari	Puna në ndërtim
Pastrimi i këpucëve	Puna në bujqësi e blektori
Të qenit kujdestar i të rinjve	Puna në cirk të improvizuar
Transportimi i mobilieve	Mbledhja e frutave në pyll

Kur krahasojmë llojet e aktiviteteve të rrugës ku janë të përfshirë fëmijët në Shqipëri me ato të vendeve të tjera, mund të vërehet se ata janë të vendosur më shumë në qytete. Përjashtim bëjnë disa fenomene të reja të zbuluara gjatë studimit të tilla si shitja e objekteve në anë të rrugëve kryesore kombëtare dhe përfshirja në kultivimin e drogës dhe prodhimin e substancave narkotike, aktivitete të cilat nuk gjenden në listën e mësipërme. Prirjet më të reja të vërejtura ishte reduktimi i fëmijëve në pastrimin e këpucëve dhe më shumë fëmijë të përfshirë në punë që përfshijnë parkimin dhe ruajtjen e makinave si dhe pranë minierave.

III.3.2 Situata dhe rrethanat familjare

Nga procesi i intervistës fillestare dhe diskutimet në fokus grupe rezultoi se 84% (657) e fëmijëve shqiptarë në situatë rruge të cilët kanë një "shtëpi" i kanë të dy prindërit dhe jetojnë me ata, 7% (55) e tyre jetojnë vetëm me një prind dhe 7% (55) me të afërmit, të cilët janë në më të shumtën e rasteve gjyshërit. Vetëm 2% (16 fëmijë) ishin vetëm.

Rezultatet e diskutimeve në fokus grupe dhe komentet e aktorëve kyç raportojnë se fëmijët në situatë rruge janë pjesë e familjeve të mëdha me motra dhe vëllezër; zakonisht me të paktën një nga gjyshërit që jetojnë me ta. Shkurorëzimet dhe rimartesa nuk është një fenomen i rrallë ndërmjet familjeve të fëmijëve në situatë rruge. Familjet me prindër të shkurorëzuar ose me njerëz/njerëzë kanë një ndikim të rëndësishëm në mirëqenien psikologjike të fëmijës.

31 Fundacja Teatru Ludowego, Raport mbi shkëmbimin në lëvizje të shkollave në Poloni, të Dhëna nga Punonjësit Socialë të Rrugës të platformës Evropiane, Krakov, Poloni, 2013

Fëmijët në situatë rruge duket se janë shumë të lidhur me familjen e tyre. Shumica e fëmijëve në situatë rruge i identifikon prindërit ose të afërmit e tjerë si kujdestarët e tyre parësor. Nënata janë shpesh kujdestaret kryesore (dhe shpesh të vetmet) në familjen e fëmijës. Gjatë diskutimeve në grup ata thanë se u pëlqente të rrinin në shtëpi me prindërit e tyre si dhe të shkonin në punë me ta. Djemtë zakonisht pëlqejnë të rrinë me babanë gjatë punës (mbledhja e kanaqeve dhe hekurit), ndërkohë që vajzat rrinë në shtëpi për të ndihmuar nënata e tyre me punët e shtëpisë.

Shumica e fëmijëve në situatë rruge në Shqipëri përmend një kombinim të dy deri në tre fakteve kryesore stresuese të familjes. Vështirësia ekonomike përfshirë varfërinë, papunësia, të qenit të pastrehë, borxhet apo uria janë problemet më mbizotëruese të identifikuara, të pasuara nga një ndryshim në formatin e familjes (vdekja apo mungesa e një prindi apo të dy prindërve dhe një divorc/rimartese e prindërve) dhe/ose alkoolizmin/dhunën në familje dhe problemet shëndetësore në familje. Ekzistojnë dy faktorë stresi të cilët gjithashtu mund të shtyjnë një fëmijë në rrugë: problemet ekonomike/prindër të papunë dhe mungesa e strehës.



Familje në situatë rruge në Tiranë, Verë 2013 (foto Mersina Xhemajli)

Problemët ekonomike janë më të dukshme për fëmijët në situatë rruge me familje të mëdha në të gjitha qytetet e Shqipërisë. Sipas fëmijëve, “varfëria në shtëpi” është vështirësia që përmendet më shpesh, ndjekur nga papunësia e prindërve dhe mungesa e një shtëpie. Të qenit i pastrehë nënkupton mospasjen e një vendi për të jetuar, jetesën në një banesë të papërshtatshme me ndryshime të shpeshta ose në vende të cilat nuk janë të përshtatshme për banesën e njerëzve (të tilla si shtëpi të improvizuara, shtëpi të cilat nuk kanë pajisjet bazë dhe vendbanimet e mbipopulluara).

Rast studimor: Arioni³² jeton në situatë rruge së bashku me vëllain e tij. Prindërit e tyre u divorcuan kur ata të dy ishin 8-9 vjeç. Pas divorcit ata jetuan me babanë dhe kushërinin e tyre pasi mamaja i braktisi. Ata ishin në një situatë të vështirë socio - ekonomike kur babai u martua përsëri dhe nuk ndiheshin rehat në familjen e tyre të re. Ata ndjekin qendrën ditore të ARSIS kur ishin të vegjël dhe tani që janë rritur thonë se nuk mund të jetojnë pa ARSIS. Djali më i vogël është një fëmijë shumë miqësor dhe përpigjet të ndihmojë të tjerët të cilët janë në nevojë si ai. Për vite të tëra ai fjeti në një kasolle pranë qendrës ditore. Ai e ndau kasollen me 5 djem të tjerë në situatë rruge. Tashmë ai punon ndërkohë që vëllai i tij qëndron gjithë ditën në qendër duke ndihmuar fëmijët të angazhohen në aktivitete të ndryshme (si lexim dhe shkrim). Ai u përpoq të kryente disa kurse profesionale (duke kaluar nga njëri tek tjetri), por për të është akoma e vështirë të gjejë veten. Ai nuk dëshiron të jetë i pavarur nga ARSIS. (Djalë, 18 vjeç, Tiranë)

Sipas aktorëve kyç të konsultuar, varfëria ekstreme ka një karakter afatgjatë në vend, shpesh e shoqëruar nga një sindromë e pafuqisë së mësuar e cila i bën anëtarët e rritur të familjes të paaftë për të kërkuar mënyra të cilat të sjellin ndryshim për situatën e tyre. Studimi në zyrë dhe informatorët

kyç vërejtën se si ata mbeten në një rreth vicioz, të paaftë për të nxjerrë veten dhe fëmijët e tyre nga situata e rrugës. Duke qenë se fëmijët pengohen për të ndjekur shkollën, e gjithë familja nuk bëhet pjesë e sistemit arsimor dhe vazhdon të hasë probleme socio - ekonomike, duke rrezikuar të mbetet përherë në varfëri e cila kalohet nga brezi në brez. Megjithëse puna e fëmijëve të tyre për të mbështetur familjen mund të përmirësojë gjendjen ekonomike, për shkak të paaftësisë për t'u integruar në rrjedhën kryesore të tregut të punës, familja mbetet gjithmonë e dobët nga ana ekonomike. Në familjet e përfshira në aktivitetet kriminale, pasoja më e keqe është se ato dukshëm krijojnë viktima të shfrytëzimit dhe abuzimit të cilat nuk mbështeten në asnjë mënyrë nga sistemi.


Alkoolizimi në familjet e fëmijëve në situatë rruge është shpesh i lidhur me praninë e babait. Gjatë diskutimeve të fokus grupeve, disa fëmijë raportuan se fenomeni i alkoolizimit prekte baballarët e tyre, por shumë pak prej tyre u shprehën se baballarët përdornin substanca narkotike. Duhan-pirja u përmend nga fëmijët si një zakon tipik i të gjithë anëtarëve të rritur të familjes dhe motrave e vëllezërve më të rritur, ku nënat tymosnin edhe kur ishin shtatzënë apo pranë fëmijëve të vegjël. Dhuna në familje shpesh përmendet në kontekstin e rimartesës së prindërve, duke evidentuar konfliktet ndërmjet njerkut/njerkës dhe fëmijëve. Alkoolizmi përmendet më shumë sesa dhuna në familje, por ka gjasa që kjo e fundit të mos raportohet mjaftueshëm nga fëmijët.

Rezultatet e fokus grupeve dhe intervistat e thelluara me aktorët kyç treguan se fëmijët në situatë rruge jetojnë në familje të mëdha, ku zakonisht janë prindërit, vëllezërit, motrat (dhe bashkëshortët e tyre kur ata janë të rinj), të cilët në shumicën e rasteve janë në mosha të ngjashme.

Ka shumë familje ku të paktën një nga gjyshërit jeton me familjen dhe për shembull në Gjirokastrë, fëmijët zakonisht qëndrojnë me gjyshërit e tyre kur prindërit emigrojnë në Greqi. Shumica e familjeve jetojnë në një shtëpi të përbërë nga një dhomë, kështu që të gjitha aktivitetet kryhen në një hapësirë, duke përfshirë marrëdhëniet seksuale ndërmjet të rriturve gjatë natës.

Pak fëmijë (7%) thanë se jetonin me xhaxhallarët/dajat, hallat/tezat, kushërinjtë apo të afërm më të largët, duke mos pasur asnjë kontakt me anëtarët e familjes së tyre të drejtpërdrejtë, të cilët në shumicën e rasteve nuk jetojnë në të njëjtin qytet me fëmijët ose kanë emigruar jashtë vendit.

Me kë qëndrojnë fëmijët në shtëpi | Intervista fillestare | Fazat 1&2



Grafiku 16: Me kë qëndrojnë fëmijët në shtëpi | Intervista fillestare Faza 1&2

Shkurorëzimi dhe rimartesa janë fenomene të shpeshta në familjet e fëmijëve në situatë rruge. Megjithatë, gjatë fokus grupeve, fëmijë të të gjitha moshave dhe pa dallim gjinie, nuk e përmendën

vetë divorcin apo rimartesën e prindërve. Fëmijë të tjerë raportuan mbi gjendjet familjare të miqve të tyre, duke përmendur se shkurorëzimi dhe rimartesa prekin shumë mirëqenien psikologjike, financiare dhe emocionale të fëmijëve.

Rast studimor: Samueli vjen nga një familje shumë e varfër. Ai ka lindur në Itali, ndërkohë që nëna e tij punonte dhe jetonte atje. Ai nuk e ka takuar kurrë babanë e tij dhe nuk di asgjë mbi të. Kur ishte 3 vjeç, ai erdhi në Shqipëri me nënën e tij. Më pas ai iu dorëzuar gjyshes së tij me të cilën ai jetoi për dy vjet ndërkohë që nëna u kthye në Itali. Mënyra e vetme e komunikimit me të ishte nëpërmjet telefonit. Gjatë kësaj kohe ai u shfrytëzua dhe u detyrua të lypte në rrugë. Ai jetoi në një shtëpi të vogël me shumë anëtarë. Ndërkohë që ai punonte në rrugë (në këtë kohë 6 vjeç), ai u identifikua nga punonjësit socialë si një fëmijë i shfrytëzuar nga familja e tij për punë. Kur nëna u kthye në Shqipëri, ai vijoi të punonte në rrugë, duke braktisur edhe shkollimin e tij. Në moshën 11 vjeçare, nëna e tij vendosi ta çonte në një Qendër Rezidenciale në Sarandë për ta hequr atë nga situata e rrugës. Aktualisht ai jeton në Sarandë dhe shkon në shkollë rregullisht. Ai po kryen një kurs vizatimi dhe përpiqet të integrohet në shoqëri. Megjithatë jeton në një Qendër Rezidenciale, ai është në kontakt të ngushtë me familjen e tij, veçanërisht me vëllezërit dhe motrat. Ëndrra e tij më e madhe është të njohë babanë e tij biologjik. (Djalë, 13 vjeç, Tiranë)

Kur u pyetën më në thellësi, fëmijët në situatë rruge raportuan se prindërit e tyre janë të shëndetshëm dhe zakonisht baballarët punojnë ndërkohë që nënat qëndrojnë në shtëpi. Gjithsesi nga përvoja në terren del se baballarët shpesh nuk punojnë dhe nënat janë në rrugë me fëmijët, gjë që përmendet në fakt veçanërisht nga fëmijët në qytetin e Durrësit gjatë një interviste të thelluar më ta.

Rast studimor: Lorena në moshën 14 vjeçare lindi fëmijën e saj; "Një fëmijë lindi një fëmijë". Kur lindi ajo tha se ishte shumë e ndërgjegjshme se çfarë e priste; besonte (si shumë vajza të tjera) se ky ishte fati i saj. Ajo u dashurua me një adoleshent tjetër të rritur i cili i u rrit në rrugë dhe kishte mjaft probleme ekonomike dhe sociale nga të qenit në burg shumë herë. Edhe nëse nuk do të ishin të dashuruar, ajo tha se në moshën e saj ajo duhet të ishte e martuar pasi kështu është zakoni rom. Veçanërisht vajzat kërkohet të martohen në moshën 12-13 vjeç. Ajo është e zgjuar dhe e bukur dhe e kupton situatën e saj. Familja e saj e di problemin dhe shpesh thotë: "më gjej një punë dhe unë nuk do të lyp nëpër rrugë". 'Burri' i saj dhe familja e tij e detyruan atë të lypë në Kosovë. Ajo jetoi në kushte të vështira dhe mungesa e kujdesit dhe stabilitetit rezultuan fatale për vajzën e saj, e cila vdiq. Ishte e vështirë të sillej trupi i vajzës së saj të vdekur në Shqipëri. Pengesat që rrethonin varrimin, dokumentacionin etj. ishin të shumta. Shumë shpejt pas vdekjes së vajzës së saj, burri e la dhe u fejuar me një vajzë tjetër. Ajo vazhdon të vuajë këtë ndarje dhe sjelljen e papranueshme të atij që tashmë është ish-'burri' i saj. Për të është e vështirë të harrojë burrin e saj të cilin e dashuroi që në moshën 11-12 vjeç, por kryesisht fëmijën e saj e cila vdiq. Ajo vazhdon jetën e saj të përditshme dhe sa herë që është e mundur, vazhdon të lypë dhe të punojë të gjithë ditën për të mbijetuar (Vajzë, 16 vjeç, Tiranë)

III.3.3 Faktorët kohë - vendndodhje

Shumica e fëmijëve në situatë rruge në Shqipëri (mes. 61.5%) qëndrojnë vetëm ose shoqërohen më fëmijë të tjerë në rrugë gjatë ditës. Ka gjithashtu fëmijë në situatë rruge (zakonisht foshnje dhe të mitur) të cilët shoqërohen nga një i rritur gjatë aktiviteteve ditore në rrugë. Të dyja fazat e numërimit të këtij studimi treguan se mesatarisht 66% e djemve janë zakonisht vetëm dhe/ose më fëmijë të tjerë, ndërkohë që vajzat shoqërohen nga të rriturit në 50% të rasteve.

Fëmijët në situatë rruge janë identifikuar se kryejnë aktivitetet të lidhura me rrugën në vendet në vijim: ndërmjet të tjerave, plazhet, zonat tregtare apo të pazarit, tregjet, ndërtesat dhe mjediset fetare, sheshet kryesore, kryqëzimet me semaforë, në vendbanimet rome, pikat kufitare, autostrada, rrugë kombëtare (segmente të rrugëve kombëtare), rrugë kombëtare pranë industrive të minierave, landfill-et (vendet e mbledhjes së plehrave). Gjatë Fazës 2, 359 fëmijë u identifikuan se punonin në Lazarat për

kultivimin e marijuanës.

Shumica e fëmijëve në situatë rruge e kalonin natën në shtëpi me prindërit. Gjatë diskutimeve të fokus grupeve, të gjithë fëmijët thanë se ata qëndronin në shtëpi me prindërit gjatë natës. Është e rëndësishme të kuptohet se koncepti i tyre i shtëpisë përfshinte dhe kasollet e improvizuara në rrugë, pa energji elektrike dhe ujë të rrjedhshëm.

Për të ilustruar më mirë faktorët kohë-vendndodhje, të dhënat e mbledhura nga intervistat fillestare të Fazës 1, janë ndarë sipas përkufizimeve të UNICEF:

Fëmijë "të" rrugës (4.3% - 19 fëmijë - intervista fillestare) janë ata fëmijë të cilët qëndrojnë në rrugë gjatë ditës dhe flenë në rrugë.

Kjo vjen për shkak të humbjes apo mungesës së prindërve, alkoolizmit në familje, dhunës në familje, shkurorëzimit dhe/ose rimartesës së prindërve.

Fëmijë "në" rrugë (79% - 347 fëmijë - intervista fillestare) ku shumica e tyre qëndrojnë në rrugë gjatë ditës dhe kthehen në shtëpitë e tyre apo qendrat e kujdesit rezidencial gjatë natës.

Fëmijët të familjeve në rrugë (16.7% - 73 fëmijë - intervista fillestare) jetojnë me familjet e tyre në rrugë.

Në dy fazat e numërimit rezultoi se mesatarisht 7% e numrit total të fëmijëve qëndrojnë jashtë pas orës 21:00. Shumica e tyre janë djem që jetojnë në Tiranë.

Rast studimor: Emilio ka kaluar fillimisht në situatë rruge në fillim të vitit 2010, duke lypur dhe duke i rënë daullës për para. Ai vjen nga një familje e cila nuk ka të ardhura të mjaftueshme për të përballuar shpenzimet e tyre mujore. Për këtë arsye ai u detyruar të vinte në Tiranë dhe të punonte për familjen e tij. Me gjithë moshën e tij të re, ai thotë se është i vetmi anëtar i familjes që punon. Ai nuk ka një vend ku të flejë dhe në shumicën e kohës ai fle në park. Ajo që vuri re ekipi i punës në rrugë ishte se djali lëviz ndërmjet vendeve të ndryshme në Tiranë. Ai lëviz gjithmonë nga Tirana në Elbasan dhe anasjelltas. Ai vuan nga lodhja e tepërt për shkak të punës natën vonë (parkimi i makinave në ish Bllokun, në qendër të Tiranës) dhe e kalon ditën kryesisht në gjendje letargjike dhe të dobët. Ai ka qenë një objekt dhunë në rrugë nga të rriturit dhe fëmijët, kjo për shkak gjithashtu të të qenit vetëm. Sot ai vazhdon të jetë në situatë rruge me vëllain e tij më të vogël në Durrës. Ata këndojnë dhe kërcëjnë në rrugë për të mundësuar të ardhura. (Djalë, 12 vjeç, Durrës)

Me kalimin e kohës në rrugë, lidhjet familjare apo me sistemin shkollor bëhen më të dobëta dhe ata kanë më shumë gjasa të kërkojnë mbështetje alternative, p.sh. nga shërbimet sociale. Ata kanë gjithashtu më shumë gjasa të krijojnë lidhje sociale me bashkëmoshatarët e tyre në situata të ngjashme jete.

III.3.4 Kushtet e rrugës dhe kushtet e jetesës

Gjatë fokus grupeve, fëmijët vizatuan shtëpitë e tyre apo vendet ku flenë - shumica e tyre në të gjitha qytetet thanë se kanë një shtëpi ku rrinë me familjen e tyre. Në të gjitha qytetet shtëpia është zakonisht një ndërtesë e thjeshtë me një ose maksimalisht dy dhoma, jo shumë e sigurtë në aspektin e sigurisë fizike, zakonisht e ftohtë dhe ku anëtarët e familjes zakonisht flenë në të njëjtën dhomë. Vendi zakonisht nuk ka energji elektrike apo ujë të pastër, duke qenë kështu një vend jo higjienik për fëmijët dhe familjen e tyre.

Disa fëmijë, kryesisht në Tiranë, thanë se ata nuk kanë një vend që mund të quhet shtëpi: 16.7% e fëmijëve të cilët morën pjesë në intervistat fillestare në Fazën e parë dhe 14.4% në Fazën e dytë thanë se ata jetojnë në rrugë. Këta fëmijë flenë në rrugë së bashku me familjen e tyre duke mos pasur një vendndodhje të qëndrueshme apo një vend ku të rrinë. Ndërkohë që vetëm 4.3% e fëmijëve në Fazën



Fëmijë duke lypur në rrugët e Tiranës, Nëntor 2013 (foto Gazmir Lame)

e parë e kalojnë natën jashtë vetëm ose me fëmijë të tjerë në situatë rruge.


Gjatë intervistave të thelluara në Sarandë, vetëm pak fëmijë përmendën se pasi kanë qenë për një kohë të gjatë në situatë rruge, ata janë vendosur në Qendrën e Kujdesit Rezidencial për Fëmijët në këtë qytet, edhe pse anëtarët e tjerë të familjes së tyre të origjinës janë të pranishëm në qytete të tjera. Në këto raste, familjet nuk kanë burime të ardhurash për të mbështetur dhe rritur fëmijët e tyre.

Intervistat fillestare gjithashtu treguan vendet ku fëmijët kalojnë natën:

Në Shqipëri ka mungesë strehëzash - ky shqetësim është raportuar nga aktorë të ndryshëm kyç (përfaqësues të IOM, FBSH/DN, BKTF, Tdh) dhe rezultojnë në një vështirësi reale për të gjetur vende të sigurt dhe të përshtatshme për fëmijët të cilët janë identifikuar dhe verifikuar se janë në një situatë me risk të lartë dhe në rrugë.³³ Shumica e aktorëve kyç përmendën se ARSIS ka të vetmen qendër "Shtëpia e Ngjyrave" për fëmijë në situata emergjente, ose që përballen me vështirësi të mëdha. Institucionet rezidenciale ekzistuese afatmesme dhe afatgjata nuk ofrojnë programe të përshtatshme për fëmijët në situatë rruge.



Fëmijë duke fjetur në Parkun Rinia, Tiranë Verë 2013 (foto Mersina Xhemajli)



Grafiku 17: Fëmijët në situatë rruge, vendet ku ata qëndrojnë | Intervista fillestare fazat 1&2

33 Për këtë subjekt është kryer një studim fizibiliteti i cili nuk është publikuar ende, i cili do të ofrojë një shërbim të mbrojtjes së fëmijës jashtë orëve të punës, Save the Children (2014)

III.3.5 Migrimi dhe lëvizshmëria

Rezultatet e fokus grupeve me anëtarë të komunitetit tregojnë se shumica ka migruar nga vende të tjera brenda vendit. Disa nga familjet me fëmijë në situatë rruge kanë ndryshuar vendin ku ata kanë lindur dhe janë rritur brenda 4-10 viteve të fundit. Disa nga fëmijët e këtyre familjeve nuk kishin lindur kur familja lëvizi ose ishin shumë të vegjël për të kujtuar lëvizjen. Tirana është destinacioni më tërheqës për shumicën e familjeve të cilët kanë fëmijë në situatë rruge. Në Shkodër, anëtarët e komunitetit thanë se ata kishin migruar nga Elbasani dhe Berati, ndërkohë që në Durrës, shumica e komunitetit me fëmijë në situatë rruge kanë migruar nga veriu i vendit (Dibra, Puka, Tropoja).

Në kundërshtim me besimin e gjerë se fëmijët në situatë rruge në Shqipëri migrojnë nga një qytet tek tjetri, shumica e fëmijëve kujton se kishte jetuar të gjithë jetën në të njëjtin qytet, ndërkohë që disa prej tyre mbanin mend se kishin lëvizur me familjet e tyre nga rajone të tilla si Tropoja, Kukësi, Shkodra, Fieri, Elbasani, Berati etj.

Rast studimor: Gjashtë vjet më parë Albi, vendosi të kërkojë mundësi të tjera për të ndihmuar nënën e tij. Ai lindi nga marrëdhënia e parë e nënës së tij me partnerin e saj të parë. Nga marrëdhënia e dytë e nënës së tij u shtuan dhe 4 fëmijë të tjerë. Ai jetoi gjithmonë me nënën dhe partnerin e saj me të cilin nëna ligjërisht nuk ka kurorë. Ai ishte gjithmonë i përfshirë në lypje. Gjatë përpjekjeve të bëra, nëna e tij dukej gjithmonë e pafuqishme për të ndryshuar gjendjen pasi si ajo ashtu dhe djali keqtrajtoheshin nga partneri i saj. Shpesh ai shkonte në Tiranë i vetëm për të lypur, pa njoftuar familjen e tij e më pas kthehej në shtëpi me të gjitha paratë e mbledhura. Pjesën më të madhe të kohës ai është i veshur keq, zbatuar dhe në një gjendje të keqe. Ai ishte shpesh i sëmurë dhe ndihej i pafuqishëm për të ndryshuar situatën e tij. Zakonisht puna e tij kqyrej nga familja e njerikut të tij. Ai e ka të vështirë të ekspozojë personat për të cilët punon, por deklaroi qartë se nuk dëshiron të punojë në rrugë (Djalë, 13 vjeç, Elbasan)

Në vitet e fundit shumë fëmijë të identifikuar në Gjirokastrë (të cilët kishin lindur në familje shqiptare emigrante në Greqi), janë kthyer në Shqipëri me familjet e tyre. Fëmijët e lindur në Greqi apo që kanë qenë atje që nga moshën e fëmijërisë së hershme kanë njohuri të kufizuar të gjuhës shqipe dhe ky fakt rrit vështirësitë që fëmijët hasin në integrimin në shoqërinë shqiptare dhe në aksesin e barabartë në shërbime, veçanërisht në arsim.

Nga të dhënat e mbledhura nga ofruesit e shërbimeve të cilët punojnë me fëmijë në situatë rruge dhe vendbanime rome dihet se 104 familje emigruan (në mënyrë të rregullt ose të çrregullt) për një periudhë kohore në Kosovë përgjatë vitit 2013. Familjet nisën të lëvizin për në Kosovë në fillim të pranverës (mars – prill) dhe u kthyen në mes të vjeshtës (tetor – nëntor). Anëtarët e familjes dhe veçanërisht fëmijët u përfshinë në aktivitete të cilat gjenerojnë të ardhura në rrugë të tilla si lypja, larja e makinave, mbledhja e materialeve të ricikluara ose performanca në rrugë me instrumente të ndryshme muzikore. Fëmijët të cilët migruan në Kosovë me familjet e tyre ose vetëm nuk kanë akses në asnjë shërbim themelor pasi ata nuk janë qytetarë të Kosovës. Për më tepër duke qenë se janë në lëvizje, ata nuk përfitojnë nga shërbimet themelore as kur kthehen në Shqipëri.



Fëmijë duke lypur tek xhamia Ethem Beu në qendër të Tiranës, Nëntor 2013 (foto: Gazmir Lame)

Sipas të dhënave të mbledhura nga intervistat fillestare, fokus grupet me anëtarë të komunitetit dhe

fëmijë, pyetësorët e mbyllur, intervistat e thelluara si dhe studimi në zyrë, shumica e familjeve Rome të cilat jetojnë në rrugë apo në kasolle në Tiranë dhe Durrës ose të cilët lëvizin rrotull, vijnë nga zonat në vijim: Driza, Levan, Zhupan në qarkun e Fierit; Otlak, Lapardha dhe qyteti i Beratit në qarkun e Beratit; Bilisht, Maliq, Pogradec dhe qyteti i Korçës në qarkun e Korçës; Fushe Kruja, Kënetë, Nishtulla në qarkun e Durrësit; Cërrik, Peqin, Paper dhe qyteti i Elbasanit në qarkun e Elbasanit; Thumane, Shëngjin, Laç dhe qyteti i Lezhës në qarkun e Lezhës; qyteti i Shkodrës dhe përreth në qarkun e Shkodrës dhe; Rrogozhinë, Kavajë, qyteti i Tiranës dhe rrethinat e kryeqytetit në qarkun e Tiranës.

III.3.6 Rrënjët e shkaqeve

Disa nga rrënjët e shkaqeve negative të pranuar nga aktorët e ndryshëm janë përshkruar më sipër dhe janë kryesisht të lidhura me varfërinë, mungesën e perspektivës së punësimit për prindërit, situatat e dhunshme apo abuzive në shtëpi, neglizhencën, diskriminimin, shfrytëzimin, mungesa e një apo të dy prindërve, mungesa e njohjes zyrtare (regjistrimi i lindjes), niveli i ulët i arsimit, mungesa e aksesit në arsimim, braktisja e shkollës, pabarazia gjinore, problemet e shëndetit fizik ose mendor, mungesa e alternativave për punësim formal apo mundësive të tjera (shih Pasqyrën 11 më poshtë).

III.3.6.1 Rrënjët e shkaqeve sipas aktorëve kryesorë

Në pyetësorin e mbyllur që iu nda aktorëve kryesorë, u paraqit një përzgjedhje e rrënjëve të shkaqeve që cojnë fëmijët në situatë rruge, mbështetur kjo në ekspertizën dhe përvojën e ofruesve të shërbimeve. Aktorëve iu kërkua të listojnë shkaqet rrënjësore sipas rëndësisë (shih në shtojcë formatin e pyetësorit të mbyllur) dhe Tabela 11 tregon rezultatet nga renditja e tyre. Gjithashtu ata u nxitën të ofrojnë rrënjë shkaqes të cilat nuk ishin listuar, por asnjë shkak shtesë nuk u dha.

Tabela 11: Rrënjët e shkaqeve të renditura nga aktorët

Rrënjët e shkaqeve të mbështetura në përgjigjet e aktorëve	Mesatarja
statusi administrativ	6.25
shëndeti (aftësitë mendore apo aftësitë e kufizuara fizike)	6.18
familjet në lëvizje	4.97
trafikimi/shfrytëzimi	4.87
arsimimi (ndjekja/mos-ndjekja në institucione arsimore)	4.30
dhuna/abuzimi/neglizhenca/diskriminimi	3.48
gjendja shoqërore e familjes (fëmijë pa kujdes prindëror)	2.80

III.3.6.2 Rrënjët e shkaqeve sipas përgjigjeve të fëmijëve

Për të kuptuar përse fëmijët ishin në situatë rruge, u bënë pyetje të natyrës “Kush vendosi se ti duhet të bëje këtë aktivitet? Si mësove ta bëje këtë punë?”. Lista e mëposhtme e shkaqeve kryesore që nxitën përfshirjen e tyre në aktivitetet e rrugës është bazuar në përgjigjet ndaj atyre pyetjeve:

- Cikli i pasjes së prindërve të cilët më parë kishin qenë vetë fëmijë në situatë rruge dhe pasojat e veprimeve të tyre si prindër, të tilla si neglizhenca, migrimi ose thjesht ekspozimi i fëmijëve të tyre ndaj aktiviteteve të rrugës;
- Shteti ose mungesa e një sistemi të funksional të mirëfilltë për kujdesin ndaj fëmijëve;
- Abuzimi fizik, seksual ose emocional i detyroi fëmijët të ‘arratisen’ nga shtëpia;
- Trysnia e bashkëmoshatarëve;
- Disa fëmijë përfshihen në aktivitetet e rrugës me nismën e tyre pasi duan të ndihmojnë familjet e tyre, por disa adoleshentë e shohin këtë si një mënyrë për t’u bërë të pavarur;
- Migrimi i familjes dhe/ose dinamikat e familjes (sëmundjet, vdekja e njërit apo të të dy prindërve).

Edhe pse në shumicën e rasteve janë shkaqet ekonomike ato që qëndrojnë pas përfshirjes së fëmijëve në situatë rruge, nga intervistat fillestare në Fazat 1 dhe 2, ishte interesant fakti se 22% (172) e fëmijëve thanë se ata hynë në një situatë rrugë me vullnetin e tyre, 19% (149) e fëmijëve mësuuan dhe u

prezantuan me aktivitetet e rrugës nga miqtë e tyre, 11% (86) e fëmijëve mësuan ose u prezantuan me aktivitetet e rrugës nga të rritur të tjerë, 7% (55) nuk u përgjigjën dhe (41% (320) e fëmijëve thanë se ata ishin në rrugë sepse familjet jetojnë në rrugë dhe sepse prindërit i detyrojnë fëmijët e tyre të punojnë në rrugë. Në studim, 96% e fëmijëve (750) deklaroi se "fitimi i të ardhurave për familjet e tyre" ishte arsyeja kryesore që ata ishin në rrugë, ndërkohë që vetëm 4% (32 fëmijë) deklaruan se ata i mbanin paratë për vete.

Pra studimi tregon se shumica e fëmijëve në situatë rruge në Shqipëri duhet të fitojnë para për të mbështetur veten dhe/ose familjet e tyre. Shumica e fëmijëve përdorin një ose dy strategji kryesore të burimit të të ardhurave. Ato më mbizotëruese janë lypja (veçanërisht ndërmjet fëmijëve më të vegjël dhe vajzave) dhe puna (të tilla si tregtia e vogël, shpërndarja e mallrave, mbledhja e xhamit apo hekurishteve dhe larja e makinave). Përfshirja e fëmijëve në këto aktivitete të gjenerimit të të ardhurave motivohet kryesisht nga vështirësia ekonomike e familjes, veçanërisht në rastin e fëmijëve të vegjël, të cilët nuk i kalojnë netët në rrugë. Veprimtaritë e burimit të të ardhurave shpeshherë shtojnë (ose mbështesin) të ardhurat familjare, ose i mundësojnë fëmijëve të mbajnë veten e tyre, duke ulur kështu shpenzimet familjare.

Lloji dhe shpeshësia e aktiviteteve të fëmijëve në rrugë shpesh ndikohen nga rrënjë shkaqesh të vecanta, por gjithashtu janë të lidhura me situatën e tyre individuale në jetë. Fëmijët të cilët lypin shpesh herë shoqërohen nga dikush, ndërkohë që fëmijët që punojnë janë zakonisht vetë. Ka gjithashtu raste të kërkimit në plehra dhe vjedhjeve, veçanërisht të dukshme për fëmijët të cilët aktualisht jetojnë në rrugë. Disa fëmijë në situatë rruge, (veçanërisht ata më të rriturit të cilët jetojnë pa familje, ata që nuk kanë një kujdestar parësor dhe jetojnë plotësisht në rrugë, ose ata të cilët janë larguar nga familjet e tyre), gjithashtu angazhohen në lypjen në rrugë apo punën në rrugë për të plotësuar nevojat e tyre të mbijetesës, pasi askush tjetër nuk mund t'i plotësojë këto nevoja për ta. Këta fëmijë zbatojnë më shumë strategji të burimit të të ardhurave sesa bashkëmoshatarët e tyre të cilët jetojnë me familjet e tyre dhe i shpenzojnë paratë pothuajse posacerisht për vete. Lypja zakonisht i pengon fëmijët në situatë rruge për të shkuar në shkollë dhe vetëm 20% (156 fëmijë) e fëmijëve që punojnë ende përpiqen të ndërthurin ndjekjen e shkollës me veprimtaritë e burimit të të ardhurave, ndërkohë që fëmijët të cilët nuk angazhohen në burimin e të ardhurave kanë normat më të larta të regjistrimit në shkollë (52%).

Arsyet/Shkaqet: Përqindjet

- 96 % (750) e fëmijëve përmendi se fitimi i të ardhurave ishte arsyeja kryesore e qenies në rrugë;
- 30% (234) thanë se ata nisën të punonin në rrugë të detyruar nga prindërit e tyre ;
- 4% (32) pohuan presionin e të rriturve;
- 21% (164) e fëmijëve nuk dinte të thoshte cila ishte arsyeja pse ata ishin në një situatë rruge.

Bazuar në shifrat e mësipërme është e mundur të dilet në përfundimin se mbi një e treta e fëmijëve ishin detyruar të kryenin aktivitete rruge, duke i bërë ata kështu viktime të mundshme të shfrytëzimit ose madje edhe trafikimit.

III.3.7 Faktorët e rreziqeve të lidhura me rrugën

Kur janë në rrugë dhe në kontakt me rrugët, fëmijët i nënshtrohen një sërë rreziqesh të lidhura nga njëra anë me vetë rrugën, por nga ana tjetër edhe me mungesën e mbikëqyrjes dhe shoqërimit nga të rritur të përshtatshëm. Nga studimi, faktorët e rrezikut të dalë në pah tregojnë dhunime të shëndetit fizik dhe mendor të fëmijës si dhe mundësinë për trafikimin dhe shfrytëzimin e fëmijëve dhe gjasave për kontakt me ligjin.


III.3.7.1 Shëndeti fizik dhe mendor

Shumica e fëmijëve deklaruan se kanë hasur probleme dhe rreziqe gjatë aktivitetit të tyre të rrugës. Të gjithë fëmijët raportuan se kryejnë punë shumë lodhëse dhe zakonisht ndihen të trishtuar dhe

të mërzitur që nuk janë në gjendje të shkojnë në shkollë, të qëndrojnë në shtëpi apo të luajnë me fëmijë të tjerë.

Gjatë aktivitetit të tyre të rrugës, kur shesin apo lypin për para, fëmijët janë viktimë të dhunës verbale dhe fizike nga personat e tjerë. Kjo raportohet kryesisht nga fëmijët në Tiranë ky lypja dhe aktivitetet e shitjes janë më të përhapurit tek fëmijët.

Rreziku për sëmundje u përmend nga fëmijët dhe anëtarët e komunitetit, të cilët punojnë në vende për riciklimin, veçanërisht kur mbledhin kanoçe, hekur ose materiale të tilla. Fëmijët në Durrës dhe Tiranë përmendën se shpesh punojnë në vende ku gjenden materiale riciklimi, çka do të thotë se ata ekspozohen ndaj substancave të rrezikshme si bakteret, viruset, kimikatet dhe lëndë të tjera helmuese nga mbetjet.



Grafiku 18: Fëmijët në situatë rruge vetëm kundrejt të shoqëruar | Fazat e numërimit 1&2

Djemtë janë zakonisht vetëm (41%, 772 djem), ndërsa vajzat shpesh të shoqëruara nga një i rritur (55%, 355 vajza).

Fëmijët nga moshat 5 deri në 14 vjeç (1410 fëmijë) janë kryesisht vetëm ose me fëmijë të tjerë, ndërsa adoleshentët (776 fëmijë) janë kryesisht vetëm. Nga diskutimet në grup, fëmijët në situatë rruge të moshës 5-14 vjeç thanë se ata ishin shpesh me motrat dhe vëllezërit e tyre gjatë aktiviteteve të rrugës.

Në përmbledhje, rreziqet dhe pasojat për fëmijët si individë janë të shumta dhe të ndryshme. Nga studimi dolën në pah rreziqet fizike si helmimi, zjarret për t’u ngrohur të cilat mund të dalin jashtë kontrollit dhe madje edhe vrasja nga persona të tjerë ndërkohë që ndodhen në rrugë. Dhuna në përgjithësi është e pandryshueshme, duke ecur paralelisht me strategjitë e mbijetesës dhe mund të jetë fizike, përfshirë atë seksuale dhe psikologjike. Ky abuzim i fëmijës rrethohet nga sjellje negative të personave rreth tyre dhe stigmatizimit, por gjithashtu me përjashtimin nga shërbimet, i cili është një lloj abuzimi social. Pasojat në personalitetin e fëmijës janë të rënda dhe mund të rezultojnë në zhvillimin e çrregullimeve të sjelljes dhe emocionale si dhe çrregullime të stresit post - traumatik (CSPT). Vetëvlerësimi i tyre është i ulët dhe informatorët kyç vërejnë se fëmijët kanë vështirësi të vërteta në lënien pas të kësaj përvoje dhe përshtatjen gjatë programeve të reintegrimit, duke u kthyer shpesh në rrugë.

III.3.7.2 Trafikimi dhe shfrytëzimi i fëmijëve

Gjatë intervistave fillestare në të dyja fazat, fëmijët rezultuan se ishin me të rritur të tjerë të cilët nuk ishin të afërmit e tyre. Rreziku i trafikimit të fëmijëve u përmend gjerësisht nga fëmijët dhe anëtarët

e komunitetit në të gjitha qytetet kur iu drejtuan pyetje të tilla si: “Me kë ke qenë/ose me kë je zakonisht kur e kryen këtë punë?” ose “Cilat janë disa nga rreziqet ndaj të cilave ekspozohen fëmijët apo përvojat negative të cilat mund të hasin ata për shkak të qenies në situatë rruge?”

Megjithëse asnjë nga anëtarët e komunitetit nuk raportoi ndonjë rast aktual të trafikimit të fëmijëve në komunitetet e tyre, një nga frazat e dëgjura më shpesh ishte se ata nuk i lejonin fëmijët e tyre të rrinin jashtë gjatë natës pasi është shumë e rrezikshme.

Gjithsesi, shumica e aktorëve kyç deklaruan se trafikimi i fëmijëve është aktualisht i pranishëm në Shqipëri, edhe pse ata refuzuan të përmendnin ndonjë rast specifik për arsye fshehtësie. Shumica e tyre raportoi se si djemtë dhe vajzat janë viktimë apo viktimë të mundshme të trafikimit dhe në shumicën e rasteve, trafikantët janë nga të afërmit e fëmijës.

Nga intervistat fillestare dhe të thelluara me fëmijët 30% (235 nga 782) e fëmijëve ishin detyruar nga prindërit e tyre të lypnin dhe 4% (32 nga 782) raportuan se ishin nxitur nga të rritur të tjerë për të marrë pjesë në veprimtari burimi të të ardhurave në rrugë. Ndërkohë që fëmijët rrallë raportuan se ishin shfrytëzuar, këta janë tregues të qartë të shfrytëzimit dhe rrezikut të trafikimit të hasur nga këta fëmijë.



Fëmijë duke lypur tek Unaza e Re në Tiranë
Tetor 2013 (foto ARSIS)

Gjatë procesit të numërimit, punonjësit socialë vërejtën se në disa raste nënat (të cilat në shumicën e rasteve janë vetë fëmijë) u gjendën në rrugë me fëmijët e tyre të vegjël, ka gjasa për të rritur mëshirën dhe simpatinë ndaj tyre ndërkohë që lypin para. Nga përvoja në terren, për të mbajtur fëmijët në gjumë ndonjëherë përdoren substanca ose droga, pra ata nuk kanë mundësi të protestojnë apo të krijojnë turbullira, dhe ata mund të lihen pa mbikëqyrje.

17 raste të fëmijëve në këtë gjendje janë dërguar në gjykatë, nga të cilat 13 raste janë marrë tashmë në kujdestari nga Shërbimi Social Shtetëror dhe janë vendosur në institucione rezidenciale.

Gjykatës i nevojiten nga 24 deri në 72 orë për të marrë një vendim për mbrojtjen e fëmijës në rast dhune dhe abuzimi dhe i nevojiten nga 3 muaj në deri më shumë se një vit për të lëshuar një vendim mbi kujdestarinë ligjore të fëmijëve.

Ofruesit e shërbimeve raportojnë raste të fëmijëve të moshës 0-1 vjeç të cilëve u është dhënë alkool së bashku me qumështin dhe disa fëmijëve të moshës 2-5 vjeç u janë dhënë pilula barnash, kryesisht valium, për t'i vënë ata në gjumë të thellë. Ndonjëherë përdoren produktet e naftës të tilla si acetoni dhe tretësit të cilat nëse thithen nëpërmjet hundës, kanë një efekt të menjëhershëm. Fëmijët e moshës 5 vjeç e sipër mund të tymosin cigare me marijuanë.³⁴

Abuzimi seksual dhe shfrytëzimi i fëmijëve nuk u raportua hapur nga aktorët kyç, me përjashtim të Drejtorit të Qendrës Kombëtare për Viktimat e Trafikimit në Linzë dhe ARSIS. Në të shkuarën, disa ofrues shërbimesh janë përpjekur të çojnë përpara ndjekjen e personave të përfshirë në shfrytëzimin seksual të fëmijëve të cilët nuk janë të afër, gjithsesi provat nuk u konsideruan të mjaftueshme për gjykimin.³⁵

Në intervistat e thelluara me përfaqësuesin e organizatës së ARSIS, u përmendën 29 raste të fëmijëve

34 Ky fenomen ishte gjithashtu subjekt i një hetimi gazetaresk i cili i shfaq në Gazeta Shqip, datë 19 shkurt 2014.

35 Terre des Hommes dhe Policia Shqiptare hetuan 8 raste të shfrytëzimit seksual të fëmijës në vitet 2008/2009.

në situatë rruge të referuar tek Zyra e Koordinatori Kombëtar për Anti - Trafikimin në Shqipëri gjatë viteve 2009-2013. Këta ishin të gjithë fëmijë viktimë të shfrytëzimit seksual në Shqipëri dhe Kosovë.

"...ka fëmijë që kanë një tutor ose jo. Ndonjëherë është një i rritur që mbledh paratë, ndonjëherë ata i menaxhojnë paratë vetë. Duke marrë në konsideratë rastet, shumica e tyre e shesin trupin pa një tutor. Jo shumë kohë më parë, në verë një fëmijë erdhi këtu dhe tha: unë jetoja në jetimore, tani jam jashtë në rrugë. Nuk dua të vjedh, jam shumë i madh për të lypur, është më mirë nëse shes trupin tim dhe kam para për të ngrënë në vend që të bëj diçka që mund të më çojë në polici. Në këtë mënyrë kam edhe një vend ku të fle natën sepse mund të fle me klientët" (Drejtor, OJQ, Tiranë)

Nga përvoja në terren dhe të dhënat anekdotike nga ofruesit e shërbimit, është e ditur se ky adoleshent ende shfrytëzohet në rrugë, edhe pse tani ai jeton me të atin. Ky rast është tregues i rreziqeve të abuzimeve seksuale dhe shfrytëzimeve të cilët fëmijët mund të hasin kur ata janë në situatë rruge dhe thekson nevojën për më shumë studime dhe ndërhyrje specifike për t'i mbrojtur këta fëmijë.

Në Shqipëri fitimi i parave nëpërmjet shërbimeve seksuale është një veprë penale, qoftë dhe kur personi është një fëmijë.³⁶ Kjo është një nga arsyet e shumta pse këto raste janë të vështira të dalin në pah dhe është e vështirë për fëmijët të marrin ndihmë.

Gjatë procesit të numërimit u identifikuan fëmijë të pashoqëruar në situatë rruge në Portin e Durrësit (31), Portin e Vlorës (19), Pikën e kalimit kufitar të Kapshticës me Greqinë (2) dhe pikën e kalimit kufitar të Kakavijës me Greqinë (5). Këto janë zona të kufizuara ndërmjet kufijve. Sipas Procedurave Standarde të Veprimit (PSV) për Viktimat e Trafikimit e Mundshme të Trafikimit, këta fëmijë duhet të ishin identifikuar si viktimë ose viktimë të mundshme të trafikimit dhe të ishin referuar tek Autoriteti Kombëtar Përgjegjës për Anti - Trafikimin³⁷ për mbështetje dhe hetim të mëtejshëm.

91 fëmijë shqiptarë në situatë rruge u identifikuan si të shfrytëzuar në rrugët e Kosovës gjatë punës në rrugë në korrik 2010.³⁸ Ata janë futur në Kosovë me familjet e tyre në mënyrë të ligjshme ose të paligjshme. Disa nga familjet kanë qenë në Greqi më parë, duke kryer aktivitete të ngjashme me ato në Kosovë apo Shqipëri. Si autoritetet e Kosovës, ashtu edhe ato të Greqisë vijojnë dëbimin e familjeve Rome dhe fëmijëve të pashoqëruar. Procesi i dëbimit nuk është në përputhje me konventat ndërkombëtare, traktatet dhe legjislacionin kombëtar, por tregon gjithashtu moszbatimin e marrëveshjeve të firmosura dypalëshe Shqipëri - Greqi 2008, Shqipëri - Kosovë 2012.

Trafikimi dhe shfrytëzimi i fëmijëve në situatë rruge nuk është aktualisht fokusi i ndërhyrjeve të veçanta. Megjithatë ofruesit e shërbimeve i referojnë rastet tek Autoriteti Përgjegjës Kombëtar kur zbulohen treguesit, duhet të bëhen më shumë kërkime për të kuptuar shtrirjen e fenomenit dhe për të ndërhyrë në mënyrën e përshtatshme për të mbrojtur fëmijët dhe përndjekur shfrytëzuesit.

III.3.7.3 Fëmijët në kontakt me ligjin

Në rrugë do të jesh ose viktimë, ose dëshmitar ose i dyshuar. Do të jesh patjetër një nga këta të tre (Drejtor, OJQ, Tiranë)

Shumica e fëmijëve në situatë rruge neglizhohen, abuzohen dhe diskriminohen. Disa prej tyre shfrytëzohen seksualisht nga të rriturit. Sipas legjislacionit shqiptar (kodi penal, kodi i familjes etj.) të gjitha këto janë të kundërligjshme. Pra fëmijët janë viktimë dhe gjithashtu dëshmitarë të krimeve të kryera ndaj tyre.

Sipas fëmijëve dhe punonjësve socialë dhe të dhënave nga OJF-të të cilat punojnë me ta, të qenit në rrugë e vë fëmijën në kontakt me një shumëllojshmëri krimesh rruge si dëshmitarë, ose përfshirje në krime të vogla. Fëmijët në situatë rruge përdoren për të shitur substanca narkotike, kryer grabitje të vogla, të bëhen tutorë për vëllezërit dhe motrat më të vogla apo fëmijë të tjerë për shkak të rrethanave të tyre dhe gjithashtu sepse sipas kodit penal, fëmijët nën moshën katërmëdhjetë vjeç nuk kanë asnjë përgjegjësi penale.

Gjithsesi, siç tregohet edhe nga studimi, ndërhyrja për mbrojtjen e këtyre fëmijëve në situatë rruge

36 Kodi Penal i Shqipërisë penalizon fitimin e parave nga shfrytëzimi seksual i të tjerëve, përfshirë fëmijët e moshës 14-18 vjeç. Përbën gjithashtu një akt kriminal çdo i rritur i cili kryen marrëdhënie seksuale me të mitur nën moshën 14 vjeç.

37 Këshilli i Ministrave Vendimi Nr. 258 mbi Procedurat Standarde Operative për Identifikimin dhe Referimin e Viktimave të Trafikimit dhe Viktimave të mundshme të Trafikimit 27.7.2011

38 Raport Vëzhgimi: Shfrytëzimi i Fëmijëve Shqiptarë në Situata Rruge në Kosovë - Projekti Mario, dhjetor 2010.

është e pakët ose nuk ekziston për shkak të mungesës së përgjigjes së sistemit e cila mund të punojë për parandalimin dhe për mbrojtjen e tyre. Për fat të keq, ashtu siç kanë vërejtur ofruesit e shërbimeve, kur një fëmijë është në konflikt me ligjin, sistemi vepron për të ndërhyrë kundër fëmijës.

Rast studimor: Bledi jeton në situatë rruge (ose ndonjëherë në shtëpinë e familjes së tij) dhe vjedh për të jetuar. Babai i tij është i papunë (i lindur me një paaftësi fizike), është i varur nga alkooli dhe kumari. Ai përfton përfitimet e shtetit për paaftësi. Sjellja e tij ndaj fëmijëve si dhe anëtarëve të tjerë të familjes është neglizhente dhe e dhunshme. Ai përdor të gjitha paratë për të luajtur kumar dhe vazhduar varësinë e tij nga alkooli në vend që të mbështesë nevojat e familjes. Nëna e tij është kryesisht e papunë dhe punon në mënyrë sporadike në sheshin e plehrave duke mbledhur kanoçe dhe hekurishte. Motra më e madhe është e martuar dhe është e vetmja që kujdeset për familjen dhe për fëmijët. Historia e vjedhjes nisi kur Bledi ishte nëntë vjeç, i mësuar nga një i rritur për të kryer vjedhje dhe vjedhje xhepush. Sipas Intervistës për Deklaratën e Policisë dhe takimet personale me këtë fëmijë, sjellja kriminale kryhet kryesisht nga ai vetë, pa fëmijë apo të rritur të tjerë. Vetëm në disa raste ai u zbulua se punonte në bashkëpunim me fëmijë të tjerë. Bledi vjedh kryesisht në shtëpi, vila apo hotele qofte dhe kur ka persona të tjerë brenda këtyre ndërtesave. Sendet kryesore të vjedhura janë elektronike (celularë, laptopë, aparate fotografikë etj.), stoli të çmuara ose para. Marrëdhëniet familjare janë të mira, me përjashtim të kunatit të tij i cili e ka rrahur brenda komisarariatit të policisë ndërkohë që po e dorëzonte atë në polici. Ai ishte akuzuar për rrëmbimin e një fëmije rreth dy javë më parë në Rrethin e Tiranës. Bledi ka jetuar për vite të tëra vetëm në situatë rruge, pa ndihmën e askujt, pasi ai nuk dëshironte të kthehej në shtëpi dhe të ndante fitimet e tij me familjen. (Djalë, 15 vjeç, Tiranë)

III.3.8 Arsimi dhe fëmijët në situatë rruge

Siç raportohet nga shumica e burimeve, pengesat për aksesin e fëmijëve në arsim janë shpesh të lidhura me paaftësinë e një familjeje për të përballuar kostot e drejtëpërdrejtë të shkollimit (si mjetet shkollore, veshmbathja, ushqimi apo pagesat informale të shkollimit) dhe koston e oportunitetit ku koha që fëmija shpenzon në shkollë nënkupton se fëmija ka më pak kohë për aktivitetet të cilat mund të shihen si një përparësi për mbijetesën e familjes. Në veçanti, aktorët kyç vërejtën se shumë fëmijë nuk kanë shkuar kurrë në shkollë për shkak të mungesës së dokumenteve (çertifikata lindjeje, forma të regjistrimit) të nevojshme për regjistrim apo për shkak të mosmiratimit të prindërve të tyre.

Rast studimor: Klajdi vjen nga një familje e madhe me shumë anëtarë. Anëtarët e familjes së tij janë nëna e tij, partneri i nënës së tij (të cilin ai e quan baba ndoense nuk është babai i tij biologjik), motra në e vogël dhe vëllai i vogël. Ai ka gjithashtu dy persona të tjerë të familjes: një motër dhe një vëlla të cilët jetojnë në një qendër të kujdesit rezidencial. Jeta e tij është çdo ditë e lidhur me rrugën dhe me vendin ku ata jetojnë, e cila është një kasolle në rrugë. Prindërit e tij janë të papunë dhe nuk kanë asnjë lloj mbështetjeje nga qeveria. Ai ka punuar që në moshën 2 vjeçare. Fillimisht ai shfrytëzohej nga nënë a tij dhe më pas fitoi aftësitë për të bërë çdo gjë për veten dhe familjen e tij. Ai punon për t'u kujdesur për vëllain dhe motrën më të vogël. Ai mendon se është i zoti për të bërë para pasi ka aftësi të mira komunikimi. Ai është regjistruar shumë herë në shkollë por nuk e ndjek rregullisht. Fakti që familja e tij lëviz nga një vend në tjetrin ndikon në mundësinë e tij për të shkuar rregullisht në shkollë. (Djalë, 11 vjeç, Tiranë)

Megjithëse statistikatat zyrtare shtetërore raportojnë se norma bruto e regjistrimit në shkollë është 103%, braktisja e shkollës mbetet një sfidë për shoqërinë shqiptare.³⁹ Për fëmijët në situatë rruge arsimi është një proces shumë i vështirë. Familjet zakonisht pranojnë t'i regjistrojnë fëmijët në shkollë dhe i mbështesin ata për të marrë pjesë në fillim të vitit shkollor. Më pas, për shkak



*Grua e pastrehë,
në Tiranë Verë 2013
(foto Mersina Xhemajli)*



Fëmijë që lyp duke mbajtur një fëmijë më të vogël në krahë, Lprakë, Tiranë Shkurt 2014 (foto Gazmir Lame)

të vështirësive ekonomike fëmijët cohen të punojnë gjatë orareve të shkollës. Punonjësit socialë/psikologët e shkollës dhe përfaqësuesit e drejtorive arsimore raportojnë se vajzat zakonisht e braktisin shkollën kur arrijnë moshën 12 vjeç për shkak të botëkuptimit se në këtë moshë vajzat nga komunitetet egjiptiane dhe rome duhet të fillojnë të përgatiten për martesë.

Shumica e aktorëve kyç raportuan se sistemi arsimor nuk është aspak i zhduqur dhe në shumë raste është një

sistem diskriminues: "...pra praktikisht ligji dhe institucionet u thonë atyre: shfrytëzoni fëmijët në mënyrë që të nxirni paratë për librat. Ti nuk mund të futesh në shkollë sepse je më ngjyrë, nuk je larë dhe të mungon kjo apo ajo certifikatë ...". (OJF aktore kyçe, Tiranë)

Në Gjirokastrë, Pogradec dhe Korçë janë krijuar shkolla vetëm me fëmijë prej komuniteteve rome dhe egjiptiane. Në Korçë raportohet se fëmijët e braktisin shkollën pasi ata nuk mund të ndjekin një shkollë nëse nuk quhet "shkollë për fëmijët Romë" duke qenë se drejtorët e shkollave refuzojnë t'i fusin këta fëmijë në shkollat e tyre. Ky është një segregim i qartë i shërbimeve dhe thyen disa nga konventat ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti shqiptar.

E njëjta situatë raportohet edhe në Tiranë, ku drejtorët e shkollave refuzojnë të përfshijnë fëmijët në situatë rruge në klasat e tyre duke deklaruar se: "ne kemi një shkollë elitare... ne nuk mund të kemi një nga këta fëmijët ...". (OJF aktore kyçe, Tiranë)

Sistemit arsimor i mungon gjithashtu stafi akademik profesional, për shembull një psikolog fëmijësh në çdo shkollë, sikundër kërkohet nga ligji. Aktorët kyç në Gjirokastrë, Elbasan dhe Tiranë përmendën kapacitetin e ulët të punonjësve socialë/psikologëve; në Tiranë ka vetëm një psikolog funksional për dy ose tre shkolla. Fëmijët mund të përfitonin nga këshillimi i synuar si dhe ndërveprimi me njësitë e mbrojtjes së fëmijës (NjMF) ku këta psikologë do të lehtësonin këtë lidhje.

Në Gjirokastrë pozicioni i psikologut ka qenë bosh për një periudhë të gjatë kohe dhe fëmijët nuk marrin mbështetje psikologjike në shkollat e tyre.

Cilësia e ulët e arsimit, humbja e interesit në shkollim, perceptimi i vështirësive të të mësuarit dhe përvojat e mëparshme negative në shkollë janë arsyt kryesore të përmendura për braktisjen e shkollës. Arsytet e tjera përfshijnë humbjen ose mungesën e prindërve dhe sëmundjet në familje.

Aktorët kyç përmendën gjithashtu braktisjen e heshtur të disa nxënësve, të cilët ulen në fund të klasës. Këta janë kryesisht fëmijë të cilët vijnë nga familje të varfra rome apo egjiptiane, përfshirë fëmijët me aftësi të ndryshme nga të tjerët apo për arsye të tjera, të cilët praktikisht harrohen atje për shkak të mungesës së dëshirës së mësuesit profesionist për t'i mbështetur dhe integruar këta fëmijë.

"...Pas tre muajve në shkollë, një fëmijë thotë se ai nuk u bën kurrë detyrat e shtëpisë pasi mësuesja nuk i kontrollon kurrë ato. Ajo kontrollon detyrat e të gjithë të tjerëve, por jo të tij. Kjo është shkolla sot ...". (OJF aktore kyçe, Tiranë)

Ekzistojnë tregues që mësuesit në arsimin parashkollor shpesh janë diskriminues ndaj fëmijëve në situatë rruge; sjellja e tyre është e rëndësishme për të mbështetur këta fëmijë të vazhdojnë shkollimin.


Shkolla mund të jetë një faktor i fuqishëm mbrojtës për fëmijët në situatë rruge. Gjatë fokus-grupeve të gjithë fëmijët e përmendën shkollën si faktorin më të rëndësishëm në ndihmën dhe përgatitjen e tyre për të ardhmen. Për shkak të rezultateve pozitive të ndjekjes të shkollës - reduktimi i mundësisë për të kaluar natën rrugëve, njohuri mjaft më të mëdha, përdorimi i shërbimeve shoqërore dhe ndihma ndaj fëmijëve për të identifikuar aspiratat e tyre të vlefshme për të ardhmen – shumë përpjekje po ndërmerren, dhe po vazhdojnë të zbatohen, për të përmirësuar aksesin dhe vazhdimësinë në ndjekjen e shkollës. Sidoqoftë shkolla mund të jetë gjithashtu një faktor i cili kontribuon në ndjesinë e izolimit të një fëmije pasi problemet e përballimit nga ana financiare, përshtatja dhe shoqërimi në mjediset e shkollës mund të detyrojnë një fëmijë të braktisë shkollën dhe të zgjedhë rrugën.

III.3.9 Shkollimi dhe “puna”


Arsimi është thelbësor për të ndihmuar fëmijët në fitimin e aftësive themelore dhe atyre të jetës, për të rritur fitimin e aftësive në të ardhmen. Arsimi në Shqipëri është i detyrueshëm për moshën nga gjashtë deri në katërmbëdhjetë vjeç. Megjithatë regjistrimi i neto parashkollorëve është 47%,⁴⁰ ligji i arsimit nuk i detyron fëmijët e moshave 3-6 vjeç dhe fëmijët e moshave 15-18 vjeç të ndjekin përkatësisht arsimin parashkollor dhe atë të mesëm. Ministria e Arsimit, partnerët e edukimit dhe aktorët kyç kanë bërë përpjekje të rëndësishme për të përmirësuar ofrimin e arsimit në Shqipëri. Statistikat tregojnë se norma e regjistrimit është 94% për arsimin fillor dhe 74% në arsimin e mesëm dhe ka fëmijë të paregjistruar në shkollë (4.6%) në Shqipëri.⁴¹

Ministria ka krijuar një mekanizëm për të rimbursuar blerjen e teksteve mësimore për fëmijët Romë të cilët shkojnë në shkollë. Në nivel politike, edhe pse regjistrimi në arsimin fillor është i detyrueshëm, nuk ka zgjidhje të qëndrueshme për të monitoruar ndjekjen e fëmijëve dhe për të lehtësuar procesin për këto familje, ndërkohë që OJF dhe NJMF të ndryshme po punojnë së bashku për të zvogëluar braktisjen e shkollës nëpërmjet ofrimit të mjeteve shkollore dhe mbështetjes së regjistrimit të fëmijëve në shkollë.

Nga informacioni i mbledhur në drejtëpërdrejtë apo tërthorazi nga studimi rezulton se fëmijët në situatë rruge janë të prirur ta braktisin shkollën në faza të ndryshme gjatë arsimimit të tyre, zakonisht gjatë shkollës fillore. Djemtë e braktisin shkollën në klasën e 3të ose të 4rt, ndërsa vajzat e braktisin atë në klasën e 5të ose 6të, kur janë mjaftueshëm të rritura për të qëndruar në shtëpi.



Grafiku 19: Ndjekja e shkollës sipas moshës | Intervista Fillestare Faza 1



Grafiku 20: Ndjekja e shkollës sipas moshës | Intervista Fillestare Faza 2

40 UNESCO EFA Raport i Monitorimit Global 2008, Studimi Innocenti

41 UNESCO EFA Raport i Monitorimit Global 2008, Studimi Innocenti

Rezultatet e intervistave fillestare nxorën në pah se shumica e fëmijëve në situatë rruge në Shqipëri 83.8% (655 fëmijë) janë në moshën e arsimit të detyrueshëm (deri në 15 vjeç). Gjatë të dy fazave, rreth 62% (485) e fëmijë në situatë rruge nuk ishin aktualisht të regjistruar ose ishin të regjistruar por në fakt nuk e ndiqnin shkollën. Ka një ndryshim domethënës ndërmjet statistikave zyrtare dhe rezultateve të studimit.

Rreth 38% (297) e të gjithë fëmijëve të anketuar janë të regjistruar në shkollë dhe e ndjekin atë, 21% (167) nuk kanë qenë asnjëherë në shkollë dhe 41% (320) e fëmijëve e kanë braktisur atë. Këto norma të larta tregojnë shkallën e problemit të fëmijëve në situatë rruge të cilët nuk përfitojnë nga e drejta për arsim.

Nga fokus grupet me anëtarët e komunitetit rezultoi se familjet nuk e shohin arsimin si një strategji mjaftueshëm të shpejtë për t'i ndihmuar ata të dalin nga qarku i varfërisë dhe shpesh ata nuk kanë mjetet për të ndjekur arsimin, prandaj burimi i të ardhurave shndërrohet në përparësi.

III.3.10 Të dhënat mbi shëndetin

Shumica e fëmijëve në situatë rruge nuk jeton në vende me higjienën e duhur. Aktivitetet e rrugës i bëjnë fëmijët më të cenueshëm ndaj disa problemeve shëndetësore. Nga procesi i vëzhgimit dhe gjatë fokus grupeve mund të shihej se fëmijët nuk ishin të pastër, me flokë dhe fytyra të pista dhe kishin mbathur rroba dhe këpucë të papërshtatshme.

Rezultatet e studimit tregojnë se shumica e fëmijëve në situatë rruge janë vaksinuar gjatë periudhës së fëmijërisë, megjithatë shumica e anëtarëve të komunitetit deklaroi se shumë pak prej tyre kanë një librezë shëndetësore. Mungesa e librezave shëndetësore krijon vështirësi të mëdha për fëmijët të cilët nuk mund të përfitojnë nga vizitat mjekësore falas dhe mbështetjen nga spitalet. Ata kanë një akses shumë të kufizuar ose aspak akses në shërbimet e kujdesit shëndetësor publik për shkak të migrimit të brendshëm, papunësisë, diskriminimit, niveleve të ulëta të arsimimit etj.

Shumica e pjesëtarëve të familjes nga komunitetet e konsultuara tha se procesi i marrjes së certifikatave të sigurimit shoqëror ishte shumë i kushtueshëm për gjendjen e tyre ekonomike. Nga ana tjetër aktorët të cilët punojnë ngushtë me këto familje deklaruan se vështirësitë në këtë proces janë të lidhura me mungesën e të gjithë dokumentacionit të familjes si certifikatat e lindjes dhe certifikatat e regjistrimit në Bashkitë të vecanta në të gjithë vendin. Megjithatë të gjitha familjet përmendën se ato hasnin probleme dhe vështirësi në plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm për fëmijët e tyre për shkak të procedurave të rrepta dhe të gjata burokratike.

Anëtarët e komunitetit deklaruan e doktorët e të gjitha niveleve të sistemit veprojnë në një mënyrë shumë ekskluzive duke refuzuar të ndihmojnë disa fëmijë në situatë rruge me probleme shëndetësore.

"[unë] e kam fjalën sillen ndryshe nëse është një tjetër grua, e bardhë, pasi të gjithë këtu janë racistë. Në këtë rast, nëse një grua e bardhë e merr atë nga rruga dhe e çon në spital, ata mund të kujdesen për të. Por nëse fëmija shkon vetëm, me këmbët apo duart e gjakosur, ata do t'i thonë: Hajde hajde, kjo është çka ti bën çdo ditë në rrugë" (Femër, anëtare komuniteti, Tiranë).

Ky fenomen përmendet gjithashtu nga disa aktorë kyç të cilët punojnë me fëmijët në situatë rruge. Ata vërejnë se sjelljet diskriminuese të doktorëve shpesh mund të ndikojnë në shëndetin e këtyre fëmijëve.

III.3.11 Qasja në/dhe përdorimi i shërbimeve sociale

Fëmijët në situatë rruge në Shqipëri kanë pak informacion mbi shërbimet sociale dhe përdorimin e tyre. Të gjitha burimet e përfshira në studim nënvizuan se Tirana ka shkallën më të lartë të fëmijëve të cilët kanë informacion mbi shërbimet sociale të cilat mund t'i mbështesin ata. Shërbimet sociale të përmendura nga shumica e fëmijëve dhe anëtarëve të komunitetit janë kryesisht të lidhura me ofrimin e ushqimeve, dhe veshjeve nga organizata të ndryshme dhe mbështetja për arsimin e fëmijëve. Kjo mund të jetë për shkak të faktit se shumica e shërbimeve sociale janë të vendosura në kryeqytet dhe më pak në qytetet e tjera të Shqipërisë.

28% e fëmijëve në situatë rruge raportoi se burimi kryesor i ndihmës kur kjo është e nevojshme ishin prindërit, ndërsa të afërmit dhe miqtë u përmendën në 11% të rasteve. Më pak se një e katërta e tyre nuk kanë dëgjuar kurrë për ndonjë shërbim social apo përdorur atë. Vetëm 22% e fëmijëve të intervistuar përmendën se merrnin ndihmë nga shërbimet sociale dhe raportuan se rrallë janë ndihmuar nga më shumë se një shërbim social. Në këtë rast ata e kishin fjalën për OJF - të.

Megjithëse një nga objektivat kryesorë të punës në rrugë, shërbimeve dhe programimit së arritjes ka qenë reduktimi i orëve që fëmijët shpenzojnë në rrugë për të përmirësuar jetën e tyre, ata nuk duket se janë të interesuar të lënë një pjesë të parave që ata mund të fitojnë gjatë kohës që marrin pjesë në këto programe dhe shërbime.

Aktualisht shërbimet publike sociale janë të lidhura vetëm me të ashtuquajturën 'ndihmë ekonomike' që familjet përfitojnë nëpërmjet politikës të kujdesit social shoqëror. Kjo përkrahje nuk ka qenë dhe aq ndihmuese për familjet për shkak se paratë e ofruara nga ky shërbim janë pak në krahasim me numrin e madh të anëtarëve të familjes të cilët mund të kenë nevojë për të dhe gjendjen e përgjithshme ekonomike në vend. Për më tepër për shkak të dokumenteve ligjore nga vendet ku jetojnë këto familje, ndërkohë që ato e kanë regjistrimin civil diku tjetër, shumë prej tyre nuk përfitojnë nga kjo asistencë, dhe janë kështu familje pa asnjë të ardhur të mundshme mujore nga mbështetja sociale.

Gjatë viteve familjet nga komunitetet rome dhe egjiptiane patën mundësinë t'i përfitonin librat dhe mjetet e tjera shkollore falas, falë një politike specifike të hartuar nga qeveria për këto komunitete. Megjithatë, procesi dështoi në qëllimin e tij fillestar pasi vuri kushtin që familjet duhet t'i blejnë librat fillimisht e më pas do të rimbursohen nga shteti. Mungesa e të ardhura në shumicën e familjeve vazhdon ta bëjë këtë proces të pasuksesshëm, duke prekur në këtë rast ndjekjen e shkollës nga fëmijët.



Baba që lyp duke mbajtur fëmijën e tij në krahë tek "ish-Ekspozita" Tiranë Nëntor 2013 (foto Gazmir Lame)

Shumica e fëmijëve në situatë rruge (nëpërmjet intervistave fillestare dhe fokus grupeve) dhe shumica e aktorëve kyç në (nëpërmjet pyetësorëve të mbyllur) përmendën se për fëmijët në situatë rruge ekzistonin këto shërbime: Qendra ditore dhe qendra 'Shtëpia e Ngjyrave' të manaxhuara nga ARSIS, qendra e Fëmijët të Botës dhe të Shqipërisë - Të Drejtat e Njeriut (FBSH/DN), Qendra Drop - in për fëmijë në situatë rrugë,⁴² - Save the Children, qendrat që manaxhohen nga Shoqata Kombëtare për Edukimin për Jetë (SHKEJ), Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijës etj. NjMF - të njihen më shumë prej vetë aktorëve kyç ku janë ngritur prej më shumë kohe dhe janë më veprues, gjithsesi fëmijët njohin më mirë shërbimet e OJF-ve si ofrues të drejtpërdrejtë të shërbimit.

Shërbimet sociale përdoren nga të gjithë fëmijët në situatë rruge në Shqipëri pasi ato kanë qenë në një situatë krize për një kohë të gjatë për shkak se parandalimit dhe ndërhyrjes së hershme u jepet pak rëndësi.

Rast studimor: Alda u zbulua gjatë punës në terren për identifikimin e fëmijëve të cilët punonin dhe jetonin në situata rruge. Ajo ishte në një gjendje shumë të keqe fizike, zbatuar dhe nuk reagoonte shumë. Vajza është shfrytëzuar në rrugë që në moshën 8 vjeçare. Ajo i tha punonjësve sociale se kishte ikur nga shtëpia në vitin 2010 pasi situata familjare ishte bërë e padurueshme për të. Ata jetonin në një shtëpi të vogël dhe në kushte shumë të vështira ekonomike. Prindërit ishin të shkurorëzuar dhe babai, i cili kishte përfituar kujdestarinë, ishte i papunë dhe i alkoolizuar. Situata e vështirë në familjen e saj kishte qenë shtysa kryesore pas

vendimit të saj për t'u larguar nga shtëpia dhe të jetonte në situatë rruge. Gjatë asaj kohe ajo kishte lypur, shitur drogë etj. Ajo është vendosur në strehë të ndryshme disa herë, por i kishte braktisur të gjitha. Ajo është akoma në situatë rruge duke punuar, por e braktisur nga familja e saj dhe jeton me një tjetër mashkull të rritur i cili "kujdeset" për të. (Vajzë, 15 vjeç, Tiranë)

Shërbimet sociale duket se kanë natyrë reaktive - fëmijët kërkojnë shërbime kur ata kanë nevojë të zëvendësojnë mungesën e elementëve të tjerë mbrojtës dhe jo anasjelltas.



Familje duke lypur, në Parkun Rinia, Tiranë Nëntor 2013
(foto Gazmir Lame)

Kur u pyetën për ndërhyrjet e shërbimeve sociale, fëmijët thanë se ishin më të interesuar të rrinin me familjet e tyre, sesa të vendoseshin në qendra të kujdesit rezidencial ku liria e tyre është e kufizuar dhe ata gjenden larg familjes.

Fëmijët në situatë rruge mesatarisht raportojnë rrallë se janë ndihmuar nga më shumë se një shërbim social në jetën e tyre. Ata të cilët janë ndihmuar, përmendin shpesh shërbime sociale të cilat ofrojnë opsione të mbijetesës afatshkurtër. Shumica e tyre kanë përdorur qendrat e kujdesit ditor ndërsa vetëm pak fëmijë kanë përdorur strehëzat/jetimoret.

Shërbimet e përdorura nga fëmijët në situatë rruge nuk ndikojnë shumë në përmirësimin e situatës së jetës së tyre (p.sh. shkollimi, kohëzgjatja e qëndrimit në rrugë, vështirësia familjare apo niveli i alfabetizimit). Aktorët kyç pranojnë se arsyet e papërshtatshmërisë dhe pamjaftueshmërisë së kësaj mbështetjeje janë se fëmijët në situatë rruge në Shqipëri janë më të prirur të përqendrohen në problemet e dukshme të grupeve të fëmijëve, sesa të adresojnë në mënyrë individuale rrënjët e shkaqeve të krizës familjare.

Stereotipet dhe paragjykimet mbi fëmijët në situatë rruge ekzistojnë edhe në rrjetin e shërbimeve sociale, ku mbështetja u jepet shumë pak fëmijëve të migruar apo atyre që lypin.

Shërbimet sociale për fëmijët në situatë rruge në Shqipëri nuk janë planifikuar në një mënyrë të bashkërenduar apo strategjike dhe shpesh nuk shihen si një pjesë përbërëse e sistemit të mbrojtjes sociale në tërësi. Si pasojë shërbimet ofrojnë një ndihmë mjaft kaotike dhe të fragmentuar e cila thjesht prek sipërfaqen e problemit pa ofruar zgjidhje të qëndrueshme për fëmijët dhe familjet e tyre.

III.3.12 Përvojat e perceptuara, dëshirat për të ardhmen, dhe aspiratat e fëmijëve

Fëmijët në situatë rruge aspirojnë të kenë një të ardhme më të mirë duke motivuar njëkohësisht edhe të tjerët, veçanërisht ata të cilët punojnë me ta nëpërmjet shumë aftësive që kanë fituar në rrugë. Edhe pse shumë prej fëmijëve e dinë se ky nuk është vendi ku duhet të ishin, që kjo i heq mundësitë për të pasur një mjedis të shëndetshëm, ata ende e shohin rrugën plot me mundësi

dhe jo vetëm probleme. Ndër të tjera ata shohin mundësi veçanërisht për burimin e të ardhurave, mëvetësinë dhe shoqërizimin. Ia vlen të përmendet se nëpërmjet mbijetesës dhe betejave të përditshme, këta fëmijë kanë fituar shumë aftësi dhe kompetenca që shumica e fëmijëve dhe të rinjve duhet të kenë nëpërmjet mbijetesës dhe luftimit nëpër betejat e përditëshme. Ata kanë mësuar se si të mbijetojnë dhe të sjellin risi në mënyrat e burimit të të ardhurave. Ata janë të ditur për jetën në rrugë.

Ata janë:

- Paraveprues - Krijues: Ata janë shpikës të mëdhenj dhe krijojnë vazhdimisht mënyra të reja për të krijuar të ardhura.
- Inteligjentë
- Rezistentë
- Pozitivë: kur studimi dhe programet provojnë të zgjidhin të gjitha pjesët negative të situatës së një fëmijë, ata mund të fokusohen thjeshtë dhe shpesh në anët pozitive të jetës së tyre. Ndonjëherë ata mund të shprehin trishtim për situatën e tyre, por në vend që të shohin vetëm problemet, ata kërkojnë. Duke marrë në parasysh se studimet e tjera mbi fëmijët në situatë rruge nxorën në pah aspektet pozitive të fëmijëve si (fitimi dhe manaxhimi i parave, mësimi i përgjegjësive, pavarësia, zhvillimi i talenteve të reja, puna në grupe etj.), ky studim i përdori ato si pika për të hapur diskutimin me fëmijët mbi çfarë prisnin ata nga e ardhmja.
- Zhdërvjelltësi dhe lehtësisht të përshtatshëm: ata dinë se si të përshtaten me situatat, kushtet dhe rrethanat.
- Të bashkuar: fëmijët në situatë rruge mund të luftojnë ndërmjet tyre, por në situatat kur ata sulmohen, ata janë një grup i bashkuar. Fuqia e këtij bashkimi është shumë e dukshme me të gjithë diversitetin që i rrethon ata.

Ndërkohë që fëmijët në situatë rruge nuk kanë burime të jashtme⁴³ (për t'i ndihmuar ata në të tashmen dhe për një të ardhme më të mirë), ata janë plot me burime të brendshme.

Dëshirat kryesore të fëmijëve për të ardhmen janë të lidhura me procesin e arsimit - të gjithë shfaqën dëshirën për të mbaruar shkollën me nota të mira. Perceptimi kryesor i fëmijëve për të ardhmen kishte të bënte me procesin shkollor dhe ata janë të ndërgjegjshëm për rëndësinë e shkollës për një jetë më të mirë.

Djemtë e moshës 5-12 vjeç deklaruar se ata dëshironin të bëheshin policë për të shpëtuar fëmijët e tjerë nga rruga, ndërsa vajzat dëshironin të bëheshin mësuese ose balerina.

Fëmijët më të mëdhenj (12-17 vjeç) dëshirojnë të mbarojnë shkollën dhe të kenë një punë të ndershme dhe të paguar mirë për të mbështetur familjen e tyre. Vajzat kanë ëndrra më shumë të lidhura me romancën, martesën dhe dashurinë - ato duan të martohen dhe të kenë shtëpinë e tyre.

Adoleshentët duket se janë më skeptikë kur mendojnë për të ardhmen e tyre duke qenë se gjendja financiare e familjes së tyre nuk mund t'i lejojë të përfundojnë shkollën dhe ata do të shpenzojnë më shumë kohë në punë gjatë ditës.

Tabela e mëposhtme ofron një përmbledhje të disa pasojave të punës në rrugë të cilët dolën në pah nga diskutimet me fëmijët:

43 http://www.unodc.org/pdf/youthnet/who_street_children_module3.PDF Organizata Botërore e Shëndetësisë, Puna me Fëmijët e Rrugës: Moduli 3, Kuptimi i Përdorimit të Substancave tek Fëmijët e Rrugës (4.6)

Tabela 12: Pasojat pozitive dhe negative të të qenit në situatë rruge

Pozitive	Negative
Qejf	Rrezik (i përzënies)
Ndihen dhe janë të dobishëm	Konkurrencë me dyqanet/fëmijë të tjerë
Mësimi i përgjegjësive	Shumë rreziqe
Aftësit negociimi	Plagosje
Zhvillim i talenteve	Shfrytëzim
Fitim i parave (në mënyrë të shpejtë)	Probleme shëndetësore
Zhvillim i aftësive të lidhura me jetën në rrugë	Stres
Krijim i partneriteteve	Zhvillim i dobët
Risitë	Rreziqe me ligjin
Fokus në 1 detyrë (menaxhim të vetes)	Mos ndjekja e shkollës
Menaxhim i parave	Pa fëmijëri normale (pa lojëra etj.)
Teknika shitje	Stigmatizim
Disa punë janë më të sigurta	Të mos qenit në shtëpi natën
Lidership (biznes)	Varësi
Vetëvlerësim i lartë	Agresivitet
Dëshirë për t'u rritur	Mungesë e aftësive administrative
Burim i madh informacioni	Përrjashtim
Të mësuarit e njohurive specifike	Vetëvlerësim i ulët, palëvizshmëri e mësuar
Zhvillim i kujtesës, komunikimit, aftësive sociale, manipulimit	Bërja pjesë në botën kriminale
Më i fortë se bashkëmoshatarët	Vetë - përrjashtim
Etikë pune	
Bashkëpunim, punë në ekip	
Pavarësi	
Merren me sistemin - shmangin kostot	
Aftësi aktrimi	
Besnikëri	

Për të pasur një programim më efikas, ndërhyrjet duhet të jenë të drejtuara ndaj aftësive dhe pikëpamjeve të fëmijëve në situatë rruge, për shembull aktivitetet e pjesëmarrjes së fëmijës për hartimin e projekteve. Programimi duhet të jetë më i barazpeshuar ndërmjet analizës dhe nxitjes së potencialit të fëmijëve për të ndryshuar situatën e tyre duke lejuar që të dëgjohet opinioni i tyre dhe t'u realizohen ëndrrat.

Kapitulli IV. Konkluzione dhe Rekomandime

Favorizimi i parandalimit dhe reintegrimit të fëmijëve duke zhvilluar strategji të reja dhe mekanizma mbështetës, si dhe përmirësimi i ofrimit të shërbimit me qëllim:

Megjithëse institucionet shtetërore janë përpjekur për të përmirësuar efikasitetin e sistemit të mbrojtjes sociale dhe cilësinë e shërbimeve sociale për grupet vulnerable, këto përpjekje nuk kanë arritur të gjitha sektorët, përfshirë fëmijët në situatë rruge. Studimi tregon se grupet e pa-avantazhuara si fëmijët në situatë rruge kanë më pak akses në shërbimet e nevojshme dhe vazhdojnë të jenë jashtë kufijve të shoqërisë. Përparimet shoqërore - ekonomike në Shqipëri nuk janë marrë siç duhet me shkaqet themelore të cilat i çojnë fëmijët në situatë rruge. Për më tepër, rrënjët e shkaqeve ndikohen nga mungesa e njohurisë (që ky studim po përpiket të plotësojë), dhe shqetësimet strukturore të dukshme nga mungesa e bashkërendimit ndërmjet niveleve qendrore, rajonale dhe vendore, së bashku me OJF-të si dhe nevojën për një ndarje të qartë dhe përkufizim të detyrave dhe përgjegjësi të organeve përkatëse dhe ofruesve të shërbimit.

Përpjekjet e qeverisë për të adresuar fenomenin e fëmijëve shihen në vecanti duke zhvilluar një plan veprimi kombëtar i cili adreson problemet e fëmijëve në situatë rruge dhe në mënyrë më të përgjithshme në reformën e shërbimit të kujdesit social e cila synon të sigurojë se mbrojtja sociale punon duke përfshirë anëtarët më të pambrojtur të shoqërisë. Kjo reformë duhet të paraqesë menaxhimin e rastit si një instrument të kërkuar për të gjithë shërbimet sociale, dhe të ofrojë një paketë të plotë të shërbimeve sociale në çdo rajon specifik, duke favorizuar kështu decentralizmin. Për më tepër, MMSR po punon për të finalizuar një strategji mbi mbrojtjen dhe përfshirjen sociale, një reformë të ndihmës ekonomike, dhe gjithashtu rishikimin e disa ligjeve dhe mekanizmave të cilat ndikojnë në mbrojtjen e fëmijës. Gjatë zhvillimit të këtyre instrumenteve, qeverisë i kërkohet të mbajë parasysh zgjidhje të qëndrueshme për integrimin dhe reintegrimin efektiv të fëmijëve në situatë rruge.

Në termat e burimeve financiare, megjithëse përgjigjja zyrtare është se burimet për shërbimet sociale janë të përshtatshme, ka gjasa që të nevojiten më shumë fonde për të trajtuar varfërinë dhe përjashtimin social, veçanërisht nëpërmjet reformave të propozuara.

Si rezultat i studimit të literaturës dhe ekspertizës së disponueshme dhe siç u përmend në intervistat e thelluara me përfaqësuesit e MMSR - së, në bazë të një analize gjithëpërfshirëse të praktikave më të mira të ndërhyrjes për fëmijët të cilët jetojnë dhe punojnë në rrugë, ndërhyrjet u kategorizuan në tre grupe:⁴⁴

1. Ndërhyrjet parësore të parandalimit. Duke synuar fëmijët të cilët jetojnë në varfëri absolute por nuk e kanë nisur jetën e rrugës, qëllimi është të zvogëlohet ndikimi i faktorëve të "shtytjes" dhe "tërheqjes" duke përmirësuar kushtet në shtëpi dhe duke u fokusuar në zhvillimin e komunitetit.

2. Ndërhyrje dytësore të parandalimit. Këto synojnë fëmijët të cilët i janë futur jetës së rrugës dhe të cilët janë në kontakt të rregullt me familjet e tyre. Qëllimi është që jeta e rrugës të bëhet një nga fazat që fëmija kalon në mënyrë të sigurtë drejt rritjes. Praktikave të tanishme më të mira paraqesin një numër përfaqësues të cilat plotësojnë njëra tjetrën. Këto qasje përfshijnë zhvillimin e mikro - sipërmarrjeve për të rritur mundësinë e fëmijët të cilët jetojnë dhe punojnë në rrugë për të siguruar të ardhura të ligjshme në rrugë; ofrimin e edukimit mbi shëndetin dhe rreziqet të cilat hasin fëmijët që jetojnë dhe punojnë në rrugë, të rritet ndërgjegjësimi mbi rreziqet e shumta të jetës në rrugë; dhe ofrimi i plotësimin të nevojave jetësore si ushqimi, streha dhe një vend sigurie nëpërmjet qendrave të tipit drop-in dhe programeve në terren.

3. Ndërhyrjet tretësore të parandalimit. Këto ndërhyrje synojnë fëmijët në rrugës dhe ata të braktisur të cilët kanë pak ose aspak kontakte familjare. Praktikave më të mira të tanishme në këtë fushë janë përkujdesi rezidencial ose reaftësues.

Nëse ndërhyrja nuk mbulon të gjitha bazat dhe shqetësimet strukturore të mirëqenies sociale, pasojat

⁴⁴ Dybicz, P. (2005). 'Ndërhyrjet për fëmijët të cilët jetojnë dhe punojnë në rrugë: Një analizë e praktikave më të mira aktuale'. Puna Sociale Ndërkombëtare Vol. 48 (6): 763-771

janë të rënda. Autoritetet u ftuan në tre tryezat teknike me aktorët kyç dhe veçanërisht ata që morën pjesë në Tiranë, diskutuan mbi pasojat mbi tërë shoqërinë për shkak të fëmijëve në situatë rruge në përpjekje për t'i mëshuar rëndësisë së ndërhyrjeve në kohë nga ana e institucioneve-përgjegjëse.. Nga kjo rezultoi se shoqëria nuk mund të përballojë koston dhe impaktin e një brezi pa fëmijëri, të drejtat e të cilëve dhunohen. Fëmijët në situatë rruge dhe familjet e tyre kanë nevojë për ndihmë të vazhdueshme të shërbimeve sociale, e cila aktualisht është e paqëndrueshme. Për më tepër, fëmijët janë në rrezik të përjashtimit social dhe mënjanimin nga shoqëria, duke rritur kështu vulnerabilitetin e tyre ndaj shfrytëzimit dhe abuzimit.

Në fund, kur fëmijët shfrytëzohen dhe përjashtohen, kjo prek nivelin arsimor dhe si pasojë, nivelin socio - kulturor të një shoqërie apo një vendi, dhe në rastin më të keq mund të ndodhë rritja e krimit, bile mund të sjellë dhe zhvillimin e krimit të organizuar. Këto pasoja nuk duhen anashkaluar apo marrë lehtë dhe shpresohet se ato mund të shërbejnë si tregues për përgjegjësinë që kanë autoritetet ndaj fëmijëve në situatë rruge dhe shoqërisë në tërësi.

Prandaj, ky studim mbështet një numër rekomandimesh dhe përgjegjësish të cilat shfaqen në të gjitha nivelet:

IV.1 Niveli qeveritar

Mbrojtja – rekomandimet strukturore dhe operative

- Në bazë të rezultateve fillestare të këtij studimi të cilat u ndanë me aktorët kryesorë, u bë e qartë se është e nevojshme për të përcaktuar siç duhet rolet dhe mekanizmat e zbatimit të protokolleve të mbrojtjes së fëmijës, duhet të shkohet përtej legjislacionit. Për këtë po hartohen udhëzime të qarta procedurale për punën me fëmijët në situatë rruge dhe ato duhet të vijojnë me përmirësimin e koordinimit dhe ndërhyrjes efektive nga organet përkatëse dhe ofruesit e shërbimeve, duke theksuar më shumë rolin dhe përgjegjësitë e zyrave rajonale të Shërbimit Social Shtetëror (SHSSH) dhe këshillave Rajonale (NjDF duke përfshirë shërbimet sociale të qeverisë vendore dhe NjMF - të). Qeveria duhet të sigurojë zbatim të menjëhershëm të reformës për të mbështetur zbatimin e këtyre udhëzimeve dhe zbatuar standardet për të ndihmuar fëmijët në situatë rruge në kohën e duhur.
- Gjatë studimit aktorët kyç jo - institucionalë theksuan nevojën për një buxhet shtesë për programe të ndërhyrjes më efektive për fëmijët në situatë rruge në mënyrë që të adresohet magnituda e fenomenit. Ripërcaktimii fondeve dhe rritja e buxhetit në të gjitha nivelet është e nevojshme për ofrimin e shërbimeve të parandalimit; në veçanti, Qeveria duhet të sigurojë fonde shtesë nga agjencitë dhe donatorët ndërkombëtarë për të hartuar zgjidhje më të qëndrueshme për fëmijët në situatë rruge në Shqipëri deri në kohën kur burimet e mjaftueshme janë të disponueshme brenda buxhetit të shtetit.
- Ky studim është studimi i parë kombëtar në llojin e vet dhe duhet të merret e përdoret si një bazë për shifrat dhe karakteristikat e fëmijëve në situatë rruge për mbledhje dhe analiza të mëtejshme të të dhënave. Kjo është e domosdoshme për të koordinuar dhe përmirësuar të dhënat në lidhje me fëmijët në situatë rruge dhe kalibruar politikat dhe ndërhyrjet e ardhshme. Për shkak të rëndësisë institucionale, në veçanti MMSR - ja (Departamenti i Statistikave), Ministria e Brendshme, Ministria e Arsimit dhe Ministria e Drejtësisë duhet të punojnë së bashku për të rishikuar dhe rifuqizuar Vendimin Nr. 267, 2012, të Këshillit të Ministrave me treguesit e përshtatshëm të dalë nga ky studim, të pranuar dhe përshtatur ndërmjet të gjithë organeve qeveritare për të krijuar në bazë koherente të dhënash mbi fëmijët në situatë rruge.
- Punonjësit e intervistuar të kujdesit për fëmijët e rrugës në Shqipëri ndajnë të njëjtin mendim se financimi i dobët i programeve dhe mungesa e koordinimit ndërmjet aktorëve kryesorë ka punuar kundër ndërhyrjes së suksesshme të programit. Bërësit e politikave duhet të jenë të ndërgjegjshëm dhe të kujdesshëm ndaj fëmijëve të cilët nuk janë pjesë e stereotipeve tipikë të fëmijëve në situatë rruge, sepse ata mund të përjashtohen lehtësisht. Këta përfshijnë fëmijët në konflikt me ligjin, fëmijët e përfshirë në shfrytëzim seksual, fëmijë të cilët janë larguar nga institucionet rezidenciale, fëmijët të cilët janë tregtarë rrugësh duke shitur shërbime si parkimi, mbajtja e valixheve (hamall) etj.
- Studimi theksoi gjithashtu fusha të cilat kanë nevojë për studime të mëtejshme dhe që kanë një

rëndësi kombëtare mbi fenomenet më pak të njohura e të cilat ndërthuren me problemin e fëmijëve në situatë rruge, në veçanti shfrytëzimi dhe trafikimi i brendshëm. Duhet të investohet më shumë për studimet në mënyrë që fushat kritike për fëmijët në situatë rruge të adresohen në mënyrën e duhur, me raporte jo vetëm statistikore por edhe cilësore të institucioneve kyçe që punojnë me fëmijë, në mënyrë që të favorizohet planifikimi strategjik dhe mjetet e përshtatshme për të luftuar këtë fenomen.

- Informacioni i studimit mbi fëmijët në situatë rruge në risk trafikimi dhe shfrytëzimi nxori në pah mangësitë në zbatimin e marrëveshjes dypalëshe për veprimet ndërkombëtare mbi anti trafikimin dhe PSV-të përkatëse. Për më tepër, Mekanizmi Kombëtar i Referimit për Anti - Trafikimin duhet të fuqizohet, të përfshijë në mënyrë efektive të gjithë fëmijët në rrezik dhe të sjellë zyrtarisht të gjitha agjencitë nën strukturën e Autoritetit të ri Përgjegjës për MKRnë (roli dhe përgjegjësitë e të cilit tanimë po rishikohen).
- Nga studimi doli në pah se fëmijëve përsëri u mungojnë faktorët kryesorë sigures për mbrojtjen e tyre të tilla si arsimi, strehimi, shërbimet e shëndetësisë dhe shërbimet e emergjencës. Aktorët kyç duhet të kenë përgjegjësinë ligjore për mbrojtjen e fëmijës duke siguruar që ka një përputhje ndërmjet ligjeve të hartuara për bashkëpunimin ndërmjet disa agjencive dhe të fuqizojnë këto faktorë mbrojtës për fëmijët në situatë rruge dhe familjet e tyre, së bashku me grupet e tjera vulnerable.
- Nëpërmjet fokus grupeve me fëmijë dhe komunitete studimi tregoi se si shërbimet ekzistuese sociale nuk janë të disponueshme apo nuk arrijnë të shtrihen deri tek fëmijët në situatë rruge dhe familjet e tyre në shumë qytete, rrethe dhe bashki. Sot për sot rastet e mbrojtjes së fëmijës ka më shumë gjasa të referohen në polici sesa në zyrat e SHSSH-së apo NjMF-ve, bile dhe në rastet kur fëmijët nuk janë të përfshirë në vepra penale. Tryezat teknike në Tiranë, Fier dhe Shkodër theksuan se strukturat ekzistuese të tilla si NjMF, NjDF etj. duhet të fuqizohen për të ofruar shërbimet e nevojshme në përputhje me interesin më të lartë të fëmijëve dhe për të pasur procedura më efektive referimin në sistemin e mirëqenies. Për shkak të mungesës së strehimit të duhur në raste emergjence, fëmijët mund të institucionalizohen në qendrat e kujdesit rezidencial për një periudhë të përkohshme dhe të papërshtatshme pasi ato nuk kanë burime të mjaftueshme njerëzore dhe financiare për të vlerësuar rastet. Kjo është në përputhje me kriteret e MMSR - së për një format të gjatë plani individual, i cili është i pavolitshëm gjatë emergjencave. Referimet e duhura në përputhje me protokollin e mbrojtjes së fëmijës nuk bëhen dhe për këtë arsye shumë fëmijë gjenden përsëri në situatë rruge. Përveç përcaktimit të një buxheti të përshtatshëm për të lejuar akses në shërbimet sociale në të gjithë vendin, qeveria duhet të adresojë procedurat burokratike dhe teknike të cilat mund të pengojnë procesin e mbrojtjes nëpërmjet ndërhyrjes legjislative ose rregullatore.
- Shërbimet për fëmijët në situatë rruge duhet të koordinohen më mirë dhe për të ofruar më mirë shërbimet në përgjigje të të drejtave të tyre, nevojitet transparencë e të dhënëve për këta fëmijë. Aktorët kyç theksuan se shërbimet sociale për fëmijët në situatë rruge në Shqipëri nuk janë planifikuar në një mënyrë të koordinuar apo strategjike, dhe shpesh nuk shihen si një pjesë përbërëse e sistemit të përgjithshëm të mbrojtjes sociale. Rezultati është ofrimi i një ndihme mjaft kaotike dhe të fragmentuar e cila thjesht prek sipërfaqen e problemit pa ofruar zgjidhje të qëndrueshme për fëmijët dhe familjet e tyre.

Mbrojta dhe Parandalimi

- Një nga çështjet kyçe të nxjerra në pah nga ofruesit e shërbimeve dhe aktorët kyç në këtë studim është se për të siguruar një mbrojtje dhe parandalim efektiv, është e rëndësishme që të gjitha strategjitë dhe ndërhyrjet të drejtohen drejt fëmijëve dhe familjeve të tyre për të siguruar ofrimin e duhur të shërbimeve. Politikat duhet të jenë të lidhura ngushtë me mbështetjen e familjeve të tyre si dhe promovimin dhe mbrojtjen e fëmijëve nëpërmjet burimeve financiare dhe organizacionale. Politikat parandaluese dhe mbrojtëse duhet të synojnë të ndihmojnë fëmijën si një individ të përfitojë nga programe të ndryshme së bashku me familjen e tij.
- Shërbimet për fëmijët në situatë rruge duhet të jepen nga profesionistë me ekspertizën specifike. Puna sociale e rrugës duhet të jetë një profesion i pranuar dhe Institucionet e Arsimit Tretësor duhet të pasurojnë kurrikulën e tyre me punën e rrugës dhe kurse mbi fëmijët dhe familjet në situatë rruge.

- Fëmijët në situatë rruge kanë jetuar një stil individual jete dhe kanë një sërë aftësish të cilat i ndihmojnë për të mbijetuar në rrugë. Mbështetja e tyre e rregullt me ndërhyrje të tilla si ofrimi i ushqimit në rrugë apo strehëzat për natën (me përjashtim të shërbimeve shëndetësore në rrugë) nuk do t'i fuqizojë dhe mbështesë ata në të ardhmen. Rekomandohet që çdo rast të konsiderohet si unik i mbështetur rast pas rasti dhe kur është e mundur, fëmijët të përfshihen në programimin e mëtejshëm për ndërhyrje.
- Qeveria duhet të zbulojë rrugë të qëndrueshme për të ruajtur kapacitetin e mbledhur me anë të programeve të trajnimit, veçanërisht gjatë tranzicionit politik i cili çon në ndryshimin e stafit.

Parandalimi

- Programet shtetërorë duhet të zhvillojnë zgjidhje efektive për të mbuluar problemet e fëmijëve në situatë rruge që janë të lidhura me shkaqet rrënjësore - kryesisht varfëria. Ligji mbi ndihmën ekonomike dhe shërbimet sociale duhet të rishikohet dhe duhet të përcaktohen tregues për ndihmën sociale dhe mbështetjen sociale të cilat identifikojnë dhe arrijnë tek ata fëmijë dhe familjet e tyre të cilat janë në nevojë.
- Programet e zhvillimit të fëmijës dhe familjes duhet të promovohen për të zgjidhur varfërinë, prishjen e familjes dhe përjashtimin social në mënyrën e duhur nëpërmjet repërcaktimit të burimeve në punësim, mirëqenie, skemat e trajnimit, mikro-kreditë etj.
- Qeveria duhet të adresojë dhe qase problemin e papunësisë së të rriturve për familjet e fëmijëve në situatë rruge nëpërmjet politikave të shtetit për ata të cilët janë të aftë, pra që nuk punojnë për arsye të ndryshme dhe mbështetjes financiare për ato familje të cilat nuk janë të afta të punojnë. Përfitimet sociale të tilla si arsimit, kujdesi shëndetësor, transferimi i kushtëzuar e parave etj. duhet të përshtaten për nevojat e këtyre familjeve për t'i ndihmuar ata të lulëzojnë dhe jo thjeshtë të mbijetojnë.
- Shërbimet duhet të jenë të përshtatshme për moshën dhe të ofrojnë mënyra të ndryshme për të qasur dhe mbështetur fëmijët e vegjël dhe të mëdhenj duke marrë në konsideratë kohën dhe përvojën e tyre në rrugë dhe lidhjen e tyre me familjet.
- Mungesa e dokumentacionit është një nga arsyet kryesore pse familjet nuk mund të përfitojnë nga shërbime sociale dhe t'i përdorin ato. Shteti duhet të thjeshtëzojë procesin e marrjes së këtyre dokumenteve dhe t'a bëjë atë falas. Sistemi i Regjistrimit Civil në Shqipëri duhet të ndryshohet për të lehtësuar rastet e familjeve të paregjistruar në zonën e tyre për të regjistruar lindjet, pajisur me çertifikata lindjeje, vendbanimi si dhe të aksesojë të gjithë dokumentacionin të cilët qytetarët janë të detyruar të kenë.
- Reformimi dhe kultivimi i trajtimit me respekt të fëmijëve në situatë rruge në politikat rregullatore të lidhura me stigmatizimin dhe ofrimin e shërbimit nga shërbimet institucionale, përfshirë trajnimin dhe zbatimin e sanksioneve në të gjitha nivelet
- Reformimin i politikave dhe sjelljeve në drejtësinë e të miturve duhet të përfshijë trajnim për stafin dhe vendosjen e ndëshkimeve kundër atyre individëve të cilët i mohojnë fëmijëve të drejtat e tyre. Paraburgimi duhet të jetë një masë e fundit për krimet më të rënda dhe dënimi për kohën më të shkurtër të mundshme.

Rekomandime të drejtpërdrejta nga aktorët kyç që kontribuan në studim

- Institucionet rezidenciale duhet të shihen si opsioni i fundit në zinxhirin e ndërhyrjeve. Është e rëndësishme të punohet për parandalimin dhe fuqizimin e sistemeve të cilat janë të lidhura ngushtë me jetët e fëmijëve dhe me rrënjët e shkaqeve të cilat i çojnë ata të përfshihen në situata të rrugës. Ndhima nëpërmjet kujdesit rezidencial duhet t'u ofrohet gjithashtu fëmijëve të moshave 16-18 vjeç

të cilët kanë humbur kujdesin prindëror dhe që kanë vështirësi të përdorin shërbimet.

- Institucionet rezidenciale duhet të përgatiten për profilet e reja të fëmijëve që vendosen në ambientet e tyre, të tillë si fëmijë të larguar nga shtëpia dhe jetimë socialë, për t'ju ofruar shërbime të reja dhe për të rritur burimet njerëzore.
- Për rastet emergjente procedurat duhet të lehtësohen nga Shërbimi Social Shtetëror në mënyrë që të hiqen pengesat për vendosjen e fëmijëve në institucionet shtetërore rezidenciale (si nevoja për një urdhër gjykatë, mungesa e dokumentacionit etj.), për të krijuar mekanizmin e "Kujdestarisë Administrative" dhe miratuar zyrtarisht statusin e punonjësit social që mundëson ndërhyrjen e menjëhershme.
- Kur është e përshtatshme, në vend të strehëzave me kosto të lartë, shteti duhet të hartojë opsione të përkujdesjes së emergjencës për fëmijët të cilët për një arsye apo tjetrën nuk kanë kujdes prindëror, apo nuk lejohen të jetojnë me prindërit apo familjen e tyre. Rekomandohen struktura si si prindërimi alternativ, shtëpi të vogla për fëmijët më të parritur dhe shtëpi të mbikqyura për fëmijët më të rritur.

IV. 2 Niveli arsimor

- Nëpërmjet ligjit, shteti duhet të përcaktojë përgjegjësitë e shkollave për zgjidhjen e problemit arsimor të fëmijëve në situatë rruge. Opsionet përkatëse arsimore të përdorura nga OJF - të gjatë punës me fëmijët në situatë rruge duhet të përshtaten dhe të bëhen pjesë e praktikës arsimore shtetërore.
- Qeveria mund të krijojë një fond shtesë arsimor për shkollat dhe qendrat e trajnimit profesional shtetëror për të lehtësuar ndjekjen (dhe jo vetëm regjistrimin) dhe reduktuar braktisjen e shkollës nga ana e fëmijëve në situatë rruge. Një status i veçantë çertifikimi mund të jepet për opsionet e tjera arsimore të tilla si qendrat ditore dhe qendrat drop-in për fëmijët në situatë rruge.
- Arsimi i detyrueshëm duhet të jetë i aksesueshëm për të gjithë fëmijët në situatë rruge. Ministria e Arsimit duhet të hartojë masa të cilat sigurojnë pjesëmarrjen e fëmijëve dhe reduktojnë pengesat e tilla si: mungesa e dokumenteve për regjistrim, mungesa e mjeteve të transportit, mungesa e materialeve shkollore, cilësia e dobët e arsimit etj. në të njëjtën kohë, stafi duhet të trajtohet për t'i bërë klasat sa më të përfshira të jetë mundur dhe shkollat duhet të ofrojnë klasa alfabetizimi për të gjitha moshat, duke favorizuar kështu futjen e fëmijëve në nivelin e përshtatshëm të klasave.
- Studimi tregon se një nga pengesat më të mëdha për regjistrimin e fëmijëve në shkollë është mungesa e dokumentacionit (përveç arsyeve ekonomike, cilësisë së dobët të arsimit dhe mungesën e vetëvlerësimit të fëmijëve). Ministria e Arsimit duhet të adresojë këtë nevojë dhe të krijojë alternativa, duke treguar vëmendje që këta fëmijë të mos përjashtohen nga arsimi fillestar pavarësisht moshës së tyre apo mungesës së dokumentacionit.
- Shërbimet për fëmijët e rrugës duhet të jenë të personalizuara sipas përvojave, realiteteve dhe perceptimeve të tyre. Shkollat kanë një rol madhor në identifikimin dhe raportimin e fëmijëve në situatë rruge tek punonjësit socialë dhe psikologët.

IV.3 Autoritetet vendore

- Autoriteti vendor është faktori kyç në përmirësimin e sistemit të mbrojtjes së fëmijës për të mbështetur fëmijët në situatë rruge. Mbledhja e të dhënave është e varfër dhe autoritetet vendore kanë nevojë të krijojnë një sistem të ri për mbledhjen e të dhënave për të mbështetur bazën e të dhënave kombëtare e cila mund të dallojë më mirë ndërmjet fëmijëve në situatë rruge dhe grupeve të tjera të pa-avantazhuara.

- Shërbimet sociale vendore funksionale janë themelore dhe duhet të përfshihen në mënyrë paravepruese në:
 - Identifikimin dhe referimin e fëmijëve në situatë rruge;
 - Vlerësimin e situatës dhe zhvillimin e komuniteteve,
 - Ofrimin e shërbimeve të përshtatshme sociale;
 - Ofrimin e planeve të mbrojtjes së fëmijës dhe familjes;
 - Shërbimin si një pikë qendrore për referimin dhe përgjigjen e koordinuar;
 - Koordinimin e shërbimeve të ndryshme dhe shpërndarjen e shërbimeve sociale që plotësojnë nevojat e fëmijëve në nivel kombëtar;
 - Monitorimin e standardeve të kujdesit.
- Tryezat teknike të cilat përfshinë edhe autoritetet vendore gjatë studimit theksuan nevojën për fuqizim dhe krijim kapacitësh për të përmirësuar ndërhyrjet e tyre. Kjo mund të përmirësohet nëpërmjet përpjekjeve të përqendruara për të krijuar një organ me ekspertizë të bazuar në politikat dhe literaturën e praktikave të mira, si dhe konsultimin me OJF-të mbi përvojat e tyre të ndërhyrjes për fëmijët.
- NjMF-të janë thelbësore në nivel vendor, por studimi tregoi se ato nuk janë ende funksionale në të gjitha fushat. Përveç fuqizimit dhe krijimit të kapaciteteve, NjMFtë duhet të marrin rolin drejtues të parashikuar nga ligji për mbrojtjen e fëmijëve në nivel vendor dhe të luajë një rol veprues në menaxhimin e rasteve, gjithashtu duke drejtuar dhe fuqizuar tryezat teknike të –shumë agjensive.
- Aktorët vendorë duhet të rrisin ndërgjegjësimin vendor për fëmijët në situatë rruge për të rritur një qasje pozitive për mbrojtjen e fëmijëve.
- Aktorët vendorë duhet të krijojnë një rrjet dhe lidhje të qëndrueshme me aktorët e tjerë për të ndërgjegjësuar fëmijët mbi aksesin në shërbimet vendore, veçanërisht për ata fëmijët të cilët nuk aksesojnë vetë. Një numër i besueshëm telefoni duhet të vihet në dispozicion të fëmijët si një kontakt i parë për fëmijët të cilët nuk kanë qasje tek shërbimet sociale, nëse ka burime të vlefshme në nivel lokal Linja Kombëtare e këshillimit për fëmijë 116 111 duhet të fuqizohet dhe mbështetet nga qeveria.
- Shërbimet e bazuara në komunitet dhe shërbimet e llojeve të tjera duhet të jenë më gjithëpërfshirëse dhe më të aksesueshme për të shmangur segregimin, stigmatizimin dhe diskriminimin e fëmijëve në situatë rruge. Aktorët kyç pranojnë se shërbimet për fëmijët në situatë rruge në Shqipëri janë të prirur të fokusohen më shumë në problemet e dukshme të grupeve të fëmijëve sesa të adresojnë në mënyrë individuale rrënjët e shkaqeve të një krize familjare. Stereotipet dhe paragjykimet për fëmijët në situatë rruge ekzistojnë edhe brenda rrjetit të shërbimeve sociale ku mbështetja u jepet vetëm pak fëmijëve të migruar apo që lypin.

IV.4 Donatorë/Programe

- Fondet dhe programet janë të kufizuara në kohë dhe kjo është një arsye pse është e rëndësishme që nëpërmjet programeve të përbashkëta të ndërtohet një rrjet ndërmjet institucioneve shtetërore dhe OJQ - ve. Këto programe nuk duhet të kufizohen tek ndihma themelore, por duhet të përfshijnë aktivitete të orientuar drejt zhvillimit nëpërmjet integritit në familje, shkollë dhe tregun e punës.
- Programet duhet të investojnë kohë dhe përvojë shumëdisiplinore në vlerësimin e situatës individuale të çdo pjesëmarrësi dhe në hartimin e planeve të personalizuara të jetës dhe shërbimeve. Qasja e programit duhet të jetë sipas moshës, përvojës personale të fëmijëve dhe duhet të jetë e kufizuar në kohë në mënyrë që të shihet ndikimi i menjëhershëm. Programet duhet të përfshijnë elemente parandalimi, ndërhyrjeje të hershme (veçanërisht në rastet e fëmijëve të cilat janë nëna) dhe strategji afatgjata.
- Programet duhet të krijojnë gjithashtu burime pozitive - aftësi dhe sfond kulturor - të fëmijëve të përfshirë për të rritur vetëvlerësimin e tyre dhe mundësitë për një jetë të suksesshme të pavarur.

- Një ndarje më e mirë e roleve dhe modeleve të bashkëpunimit institucional ndërmjet OJF-ve dhe sektorit publik është e nevojshme për të promovuar në mënyrën e përshtatshme zhvillimin pozitiv të fëmijëve në situatë rruge. Përvoja e disa programeve sugjeron se OJF-ve të mund të tejkalojnë izolimin e tyre dhe të rrisin ndikimin nëpërmjet ofruesve të tjerë shtetërorë dhe jo shtetërorë të shërbimeve në nivel vendor.
- Qasjet e programeve nevojiten për të ndihmuar fëmijët të fuqizojnë lidhjet e tyre me familjen, shkollën dhe komunitetin. Duhet të hartohen programe të cilat fokusohen në të gjithë familjen, duke përfshirë motrat e vëllezërit në situatë rruge për të kapërcyer shkaqet dhe problemet rrënjësore.
- Programet të cilat synojnë të mbështesin fëmijët me histori abuzimi me substancat duhet të përfshijnë ekspertizën profesionale për të trajtuar efektet e menjëhershme dhe afatgjata të abuzimit me substanca në jetët e tyre.
- Programet të cilat synojnë të mbështesin fëmijët që braktisin shkollën, duhet të synojnë në parandalimin e hershëm kur kjo është e mundur. Këto programe duhet të jenë të çertifikuara dhe të kenë një program specifik për fëmijët të cilët nuk janë në shkollë apo për fëmijët të cilët mund të regjistrohen përsëri në sistemin zyrtar.

Referenca:

1. Alba Jasini dhe Sabina Tahsimi, Fenomeni i fëmijëve në Lëvizje në sipas Opinionit të Fëmijëve - Koalicioni BKTF - Bashkë për Kujdesin Tërësor të Fëmijëve në Kuadër të Zbatimit të Projektit MARIO 2011
2. Alma Maksutaj & Altin Hazizaj, Puna e Fëmijëve dhe Fëmijët e Rrugës në Shqipëri- Një studim në shfrytëzimin ekonomik dhe punën e detyruar të fëmijëve në Shqipëri, nëntor 2005, K DFA, Tiranë 2005
3. Bashkëpunimi Austriak për Zhvillim dhe UNICEF (2009): Vlerësimi i ndërhyrjes së Njësisve për Mbrojtjen e Fëmijës në kuadrin e reformës së sistemit të mirëqenies sociale dhe proceseve të decentralizimit për shërbimet sociale në Shqipëri, shtator 2009
4. Catherine Panter Brick, "Fëmijët e Rrugës, të Drejtat e Njeriut dhe Shëndeti Publik" në Fëmijë, të Rinj dhe Mjedise Volumi 13 Nr.1 Departamenti i Antropologjisë, Publikim i Universitetit Durham, 2003
5. Komiteti mbi të Drejtat e Fëmijës, Vëzhgime Përmbyllëse - Shqipëri KDF/C/ALB/CO//2-4, Kombet e Bashkuara, 2012
6. Konsorciumi për Fëmijët e Rrugës, Fëmijët e Rrugës: Një Rishikim i Literaturës mbi Hartëzimin dhe Hapësirat 2000 deri në 2010, Versioni Përfundimtar, 2011
7. Këshilli i Ministrave (21 mars 2012): Plani i Veprimeve për Adresimin e Rekomandimeve të Opinionit të Komisionit Evropian për Shqipërinë, 2012
8. Dr. Zosa De Sas Kropiwnicki, Procesi i Studimit: Një Udhëzues për studimin e përqendruar tek fëmija për parandalimin e trafikimit, korrik 2007.
9. Dybicz, P. (2005). 'Ndërhyrjet për Fëmijët të Cilët Jetojnë dhe Punojnë në Rrugë: Një analizë e praktikave aktuale më të mira. Puna Sociale Ndërkombëtare Vol. 48 (6):763-771
10. Komisioni Evropian, Raport Ecurie për Shqipërinë, 2012
11. INSTAT: Fëmijë që Punojnë në Republikën e Shqipërisë, rezultatet e Punës Kombëtare të Fëmijëve në Shqipëri 2010, publikuar nga Organizata Botërore e Punës dhe Instituti i Statistikave (INSTAT) të Republikës së Shqipërisë, korrik 2012
12. Guida ndërkombëtare mbi metodologjinë e punë në rrugë në të gjithë botën - Dynamo International 2008
13. IPEC & ISB, Fëmijë që Punojnë në Rrugë në Shqipëri në Tiranë, Shkodër, Vlorë, Një Studim i Vlerësimit të Shpejtë, Organizata Botërore e Punës, 2002
14. Judith Ennew dhe Jill Swart-Kruger. "Hyrje: Shtëpitë, Vendet dhe Hapësirat në Ndërtimin e Fëmijëve dhe të Rinjve të Rrugës." Fëmijë, të Rinj dhe Mjedise 13 (1), Pranverë 2003
15. Katarzyna Wargan, Larry Dershem, Mos më Quaj Fëmijë Rruge - Vlerësimi dhe Karakteristikat e Fëmijëve Urbanë të Rrugës në Gjeorgji, Save the Children dhe UNICEF, 2009
16. Ministria e Arsimit dhe Shkencave, Strategjia Kombëtare për Arsimin 2004-2015 (publikuar në 2005)
17. Ministria e Arsimit dhe Shkencave, Strategjia Kombëtare për Trajnimin dhe Arsimin Profesional dhe Të mësuarit gjatë të Gjithë Jetës 2013-2020 (publikuar në 2012)
18. Ministria e Brendshme, Strategjia Kombëtare për Luftën Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore 2008-2010 duke përfshirë Strategjinë Kombëtare për Luftën Kundër Trafikimit të

